

si i kompanisë sonë matet me rritjen konstante
e tanë i cili sa vjenë e shtohet gjithashtu e p
ritja e besimit të klienteve tanë gjë që na m
itetit të ofertave tona dhe detyrimeve që da

Përmbajtja

Mesazhi nga bordi i drejtorëve	1
Mesazhi nga menaxhmenti ekzekutiv	3
Stuktura organizative	7
Vizioni	8
Misioni	8
Vlerat tona	8
Mjedisi Makroekonomik	9
Spektori bankar	9
Pozicionimi i Bankës Ekonomike në vitin 2023 në tregun bankar të Kosovës	10
Pjesëmarrja në kredi	11
Pjesëmarrja në depozita	13
Pasqyra e pozicionit financiar	15
Banka Ekonomike Sha - Pasqyrat individuale	81
Grupi Bankar Banka Ekonomike - Pasqyrat e konsoliduara financiare	138
Kompania e Sigurimeve Siguria - Pasqyrat individuale	209
Performanca e Bankës Ekonomike	18
Asetet e Bankës	18
Portofoli kreditor	19
Depozitat	21
Zhvillimi i biznesit	24
Portofoli kreditor	26
Klientët korporatë	27
Klientët e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme	28
Klientët individualë	29
Kanalet e distribuimit dhe rrjeti i degëve	30
Kanalet alternative të shërbimit ndaj klientit - Qendra e thirrjeve	32
Lizingu	33
Njësia për zhvillim të bancassurance	33
Zhvillimi produkteve	34
Menaxhimi i rrezikut	37
Menaxhimi i rrezikut kreditor	38
Rreziku operacional	39
Rreziku i likuditetit	40
Rreziku i tregut	40
Procesi i vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit	40
Rreziku i TI-së	41
Operacionet dhe pagesat	41
Transferet kombëtare	41
Transferet ndërkombëtare	42
Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare	43

Kartelat Bankare	44
Teknologjia e Informacionit	45
Menaxhimi dhe trajnimi i personelit	47
Pajtueshmëria e përgjithshme	49
Përgjegjësia sociale e korporatës	49
Kompania e Sigurimeve Siguria	67
Mesazhi nga menaxhmenti ekzekutiv	69
Performanca e KS Siguria	72
Departamenti shitjes dhe marrjes në sigurim	75
Departamenti i sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve	76
Departamenti i sigurimit të pronave dhe garancioneve	76
Departamenti i sigurimeve kasko	77
Departamenti i sigurimit të autopërgjegjësise	77
Departamenti dëmeve	77
Marketingu	78



Enomille



MESAZHI NGA BORDI I DREJTORËVE

Të nderuar klientë të çmuar, staf të përkushtuar dhe aksionarë të nderuar,

Me një ndjenjë të veçantë krenarie dhe duke ju falënderuar thellësisht, ju njoftojmë se viti që lamë pas shënoi një kapitull të ri dhe të paharrueshëm në Bankën Ekonomike. Viti 2023 ka qenë jo vetëm më i frytshmi në historinë tonë, por edhe një vit testimi dhe dëshmimi të qëndrueshmërisë dhe adaptueshmërisë sonë ndaj sfidave ekonomike. Ne jemi mirënjohës që kemi një ekip që tejkalon pritshmëritë me përkushtimin dhe pasionin e tyre për sukses.

Angazhimi ynë nuk ka qenë kurrë më intensiv se në vitin 2023. Në një kohë kur ekonomia globale dhe tregjet financiare kanë pasur sfidat e tyre, Banka Ekonomike ka ruajtur qëndrueshmërinë e saj drejt inovacionit dhe rritjes. Shërbimet e jashtëzakonshme dhe produktet financiare revolucionare që kemi zhvilluar janë pasqyruar në performancën tonë dhe në forcimin e marrëdhënieve me klientët dhe partnerët tanë – kjo ka qenë një demonstrim i besimit të palëkundur që ata kanë tek ne.

Në vitin që shkoi, investimet e mëdha që kemi bërë në teknologjinë e informacionit dhe infrastrukturë nuk janë thjesht përmirësime – ato janë trampolinë për inovacion dhe ndryshim. Këto investime kanë siguruar që Banka Ekonomike të pozicionohet jo vetëm si një lojtar i rëndësishëm në industrinë bankare, por edhe si një lider vizionar që formëson të ardhmen e sektorit financiar.

Investimi në “KS Siguria” ishte një nga momentet më të rëndësishme të vitit 2023. Ky partneritet strategjik ka shtruar rrugën për një model të ri të bashkëpunimit ndërmjet bankës dhe “KS Siguria”, duke sjellë një ofertë më të gjerë dhe më të integruar të shërbimeve për klientët tanë. Ky ka qenë një veprim i guximshëm që tregon se ne jemi gati të marrim hapa të mëdhenj për të zgjeruar horizontet tona dhe për të ofruar një vlerë të pakrahasueshme.

Ndërsa shënojmë arritjet tona, dëshirojmë të theksojmë angazhimin e vazhdueshëm të secilit nga ju – klientë, partnerë, punonjës dhe aksionarë – që keni qenë dhe do të vazhdoni të jeni thelbësorë në rrugëtimin tonë. Në vitet në vijim, me këmbëngulje dhe përkushtim të vazhduar, ne synojmë të mbërrijmë majat e reja të suksesit, duke ndërtuar një të ardhme më të ndritur për të gjithë.

Me një vizion të qartë dhe një mision të përcaktuar, ne presim me padurim të shkruajmë kapitujt e ardhshëm të kësaj historie. Ju faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi të jashtëzakonshëm dhe për kontributin tuaj të çmuar që është jetik për dinamizmin dhe rritjen tonë të vazhdueshme.

Me respektin më të lartë dhe mirënjohjen më të thellë,

Valon Lluka

Kryesues i Bordit të Drejtorëve



Shpend Luzha

Kryeshef Ekzekutiv



Hamide Pacolli Gashi

Zv. Kryeshefe Ekzekutive



Arijan Haxhibeqiri

Zv. Kryeshef Ekzekutiv

MESAZHI NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV

Të nderuar klientë, bashkëpunëtorë dhe aksionarë të Bankës Ekonomike,

Me kënaqësi ju paraqesim raportin tonë vjetor për vitin 2023. Ky raport shënon vitin më të suksesshëm për ne, përplot me arritje të rëndësishme në nivel të institucionit. Në vitin 2023, ekipi ynë është përballur me sfida të reja dhe ka punuar me përkushtim për të përmbushur qëllimet dhe detyrat tona në një mjedis ekonomik të ndryshueshëm dhe sfidues. Kemi qenë të përkushtuar në vazhdimësinë e shërbimeve tona kualitative ndaj klientëve dhe bashkëpunëtorëve tanë, duke u përpjekur gjithmonë për të rritur standardet e cilësisë dhe inovacionit në industri.

Përkushtimi ynë i vazhdueshëm për kualitet dhe rritje gjatë vitit 2023 jep efekt në rezultatet pozitive që kemi arritur. Portofolin kreditor e kemi rritur për 60 milionë euro, që është një rritje prej mbi 15 përqind, një tregues i qëndrueshmërisë, lojalitetit të klientëve tanë dhe përkushtimit tonë për mbështetjen e zhvillimit ekonomik. Në të njëjtën kohë, ka pasur rritje të të hyrave të interesit në total 30.7 milionë, duke rritur pjesëmarrjen në total të të hyrave të interesit të tregut në 9.49 përqind. Depozitat gjithashtu pësuan një rritje të ndjeshme, prej 32 milionë euro. Kjo rritje prej 6.3 përqind në krahasim me vitin e kaluar dëshmon besimin e rritur të klientëve në bankën tonë dhe në shërbimet që ofrojmë.

Në vitin 2023, kemi vazhduar të investojmë në aftësimin e punonjësve tanë përmes trajnimeve të specializuara. Kjo është një pjesë e strategjisë sonë për të siguruar se stafi ynë është i pajisur me njohuri të fundit dhe aftësi të nevojshme për të përmbushur synimet tona dhe për të ofruar shërbime për klientët tanë. Një nga arritjet më të rëndësishme të Bankës në fushën e zhvillimit të produkteve është lansimi i pagesave elektronike përmes terminaleve POS. Kjo platformë e avancuar përmban teknologjinë më të fundit në treg, duke ofruar një përvojë të jashtëzakonshme për bizneset gjatë realizimit të pagesave, me një nivel të lartë të efikasitetit. Ky zhvillim paraqet një hap të rëndësishëm përpara në përmirësimin e infrastrukturës së pagesave elektronike dhe përforcimin e marrëdhënieve me klientët e Bankës.

Në fushën e bankingut digjital, kemi investuar në përmirësimin e shërbimeve për procesimin e pagave të biznesit, duke i bërë ato më të lehta dhe efikase për klientët tanë.

Duke e kuptuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë për të përgatitur zgjidhje të shpejta dhe të sigurta për klientët e biznesit, ne kemi zhvilluar një produkt të ri të kartelës së depozitës. Kjo zgjidhje e avancuar përforcon qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e menaxhimit të parave.

Angazhimi ynë në përmirësimin e shërbimeve dhe ofertave për klientë ka sjellë një rritje të të hyrave tona nga komisioni për 10 përqind, poashtu një tregues i vlerësimit pozitiv të klientëve për shërbimet tona. Kjo ka ndihmuar në rritjen e fitimeve tona për më shumë se 17 përqind, duke arritur një fitim prej 12.9 milionë euro para tatimit.


Gjatë vitit 2023, rëndësi të veçantë pati edhe përgjegjësia sociale, kështu që Banka jonë u angazhua aktivisht në mbështetjen e klubeve sportive në të gjithë territorin e Kosovës, duke filluar nga sportet si futbollit, basketbollit deri tek alpinizmi, volejbollit, hendbollit, golfi, xhudo, artet marciale, skijimi, tenisi, pingpongu dhe shigjetaria. Në të njëjtën kohë, ne kemi mbështetur edhe shumë iniciativa në fusha të tjera si kultura, shëndetësia, arsimiti, kategoritë e margjinalizuara dhe çdo iniciativë që ka ndikim të drejtpërdrejt në zhvillimin dhe mirëqenien shoqërore. Në fund, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë më të thellë për kontributin e çmuar të të gjitha palëve të përfshira gjatë vitit të kaluar. Përkushtimi dhe përpjekjet e punonjësve tanë, besimi dhe mbështetja e klientëve dhe aksionarëve tanë, si dhe përkrahja e vazhdueshme nga Bordi i Drejtorëve dhe institucionet publike, janë thelbësore për arritjet tona të suksesshme. Duke ecur përpara, ne vazhdojmë të përkushtohemi për të ofruar një përvojë të jashtëzakonshme për klientët tanë dhe për të ndihmuar në ngritje të qëndrueshme që është me përfitim për të gjitha palët e interesit.

Në emër të Menaxhmentit Ekzekutiv,


Shpend Luzha

Kryeshef Ekzekutiv


RAPORTI I MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT






ASETET (NË MILIONË EUR)




DEPOZITAT (NË MILIONË EUR)



KREDITË JOPERFORMUESE (KJP)**KREDITË (NË MILIONË EUR)****FITIMI PARA TATIMIT (NË MILIONË EUR)**

Ura e Rugovës - Pejë

STRUKTURA ORGANIZATIVE E BANKËS



Kulla e Isa Boletinit - Mitrovicë

VIZIONI

Të jemi një nga ofruesit më të mirë dhe më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Kosovë.

MISIONI

- Të jemi partneri më i mirë financiar i klientëve tanë, për të arritur rritje dhe qëndrueshmëri ekonomike.
- Të jemi në qendër të kërkesave dhe shërbimeve financiare të klientëve individualë, bizneseve, korporatave dhe klientëve institucionalë.
- Të mbështesim dhe rrestohemi në të gjitha aktivitetet që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.
- Qëllimi ynë parësor është të fitojmë dhe të ruajmë besimin e publikut si dhe t'u përmbahemi standardeve më të larta etike.
- Të arrijmë të ofrojmë mbështetje financiare, siguri dhe optimizëm tek klientët tanë.

VLERAT TONA

- Në pikëpamjen afatgjatë, ne investojmë në njerëz, produkte dhe teknologji.
- Ne vazhdimisht përpiqemi të përmirësojmë performancën tonë deri në përpikëri.

MJEDISI MAKROEKONOMIK

Në vitin 2023, Kosova vazhdoi të përjetonte një rritje ekonomike të qëndrueshme, e cila u ndikua nga shumë faktorë. Investimet në infrastrukturë dhe sektorët kyçë si teknologjia dhe prodhimi tërësor kontribuan në këtë zhvillim. Në të njëjtën kohë, shteti përfundoi shkallën e inflacionit dhe kontrollimin e deficitit buxhetor për të ruajtur stabilitetin ekonomik. Megjithatë, tregu i punës mbeti një sfidë, megjithë përpjekjet për të zgjidhur këtë çështje përmes iniciativave për zhvillimin e sektorëve të punësimit.

Në aspektin e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kosova vazhdoi të angazhohej në procesin e integritimit evropian dhe të forconte lidhjet ekonomike me partnerët ndërkombëtarë. Investimet e vazhdueshme në infrastrukturë u bënë për të përmirësuar lidhjet tregtare dhe për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomisë së vendit.

Kështu, gjatë vitit 2023, Kosova përjetoj një periudhë të konsolidimit të stabilitetit ekonomik, me përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur objektivat e zhvillimit dhe integrimin evropian, ndërsa sfidat e tregut të punës dhe menaxhimit të shpenzimeve publike mbetën prioritet për të ardhmen.

SEKTORI BANKAR

Sektori bankar në Kosovë përjetoj një vit të rëndësishëm në 2023, duke u përqendruar në përmirësimin e shërbimeve dhe pritshmëritë e klientëve në një mjedis ekonomik të ndryshueshëm. Bankat komerciale dhe institucionet financiare vazhduan të ofronin gamën e tyre të shërbimeve, duke përfshirë kredi, llogaritë e kursimit dhe shërbimet dixhitale, si përgjigje ndaj kërkesave të rritura të klientëve për një eksperiencë më të përshtatshme dhe të përshtatshme në bankë.

Rritja e aktivitetit ekonomik shtoi nevojën për financim të ri për bizneset dhe individët, duke sjellë një rritje në kërkesën për kredi dhe shërbime të tjera financiare. Bankat përballuan sfida të ndryshme, duke përfshirë rreziqet e sigurisë informative dhe rrezikun nga kreditë e keqenxjerra, por punuan vazhdimisht për të përmbushur standardet e sigurisë dhe për të mbrojtur interesat e klientëve.

Në të njëjtën kohë, sektori bankar u përpoq të përshtatej me ndryshimet në politikat dhe rregulloret financiare, duke u fokusuar në përmirësimin e transparencës dhe qëndrueshmërisë së tyre. Me përqendrimin e tyre në inovacion dhe ofrimin e shërbimeve të larmishme dhe të përshtatshme, bankat në Kosovë u përpoqën të mbeteshin partnerë të besueshëm për klientët e tyre, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe financiar të vendit.

POZICIONIMI I BANKËS EKONOMIKE NË VITIN 2023 NË TREGUN BANKAR TË KOSOVËS

Banka Ekonomike vazhdoi të konsolidojë pozicionin e saj në tregun bankar të Kosovës gjatë vitit 2023. Ndikimi i saj në rritjen e tregut bankar ka qenë i ndjeshëm, duke kontribuar në rritjen e aseteve në të gjitha segmentet.

Rritja e tregut bankar në të gjitha asetet me 12.17 përqind ka reflektuar ndryshimet pozitive në ekonominë e vendit, duke përfshirë kontributin e Bankës Ekonomike, e cila ka shënuar një rritje prej 7.97 përqind në të gjitha asetet e saj. Kjo performancë e lartë tregon për aftësinë e Bankës për t'i përmbushur kërkesat e një tregu të ndryshëm dhe për të përshtatur ofertën tonë në përputhje me nevojat e klientëve.

Në numra realë, në fund të vitit 2023, pasuritë/asetet e përgjithshme të Bankës Ekonomike u rritën në 608 milionë euro, krahasuar me 563 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2022. Kjo rritje e konsiderueshme tregon për një menaxhim të suksesshëm të portofolit dhe një përgjigje efektive ndaj kërkesave të tregut dhe klientëve.

Banka Ekonomike vazhdon të jetë një partner i besueshëm për klientët e saj dhe një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës financiare të Kosovës. Duke qenë në krye të inovacionit dhe të shërbimeve të cilësisë së lartë, ne mbetemi të përkushtuar për t'i përmbushur qëllimet tona strategjike dhe për të kontribuar në rritjen e stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të vendit tonë në të ardhmen.

FIGURA 1. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 dhjetor 2023:




FIGURA 2. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në rritjen e përgjithshme të aseteve të tregut, 31 dhjetor 2023;



PJESËMARRJA NË KREDI

Banka Ekonomike ka vazhduar të konsolidojë pozicionin e saj në tregun bankar të Kosovës gjatë vitit 2023, duke shënuar një pjesëmarrje të rëndësishme në totalin e kredive të tregut.

Më 31 dhjetor 2023, pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në totalin e kredive në treg qëndronte në 9.22 përqind, duke treguar një kontribut të konsiderueshëm në sektorin bankar të vendit. Kjo pjesëmarrje tregon për besimin dhe zgjedhjen e klientëve për t'i besuar Bankës Ekonomike për nevojat e tyre financiare.

Gjatë vitit 2023, Banka jonë ka shënuar një rritje prej 15.25 përqind në kredite e ofruara, duke shkuar përtej rritjes së përgjithshme të tregut, e cila ka qenë 13.02 përqind. Kjo performancë e lartë tregon për besueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve tona, duke ndikuar në zgjedhjen e klientëve për të marrë kredi dhe shërbime financiare nga Banka Ekonomike.

Në vijim të kësaj rrugë të suksesshme, ne mbetemi të përkushtuar për t'i përmbushur nevojat dhe pritjet e klientëve tanë dhe për të kontribuar në rritjen e stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik të vendit tonë në të ardhmen.

Ujëvara e Trepçës - Mitrovicë

FIGURA 3. Rritja e Bankës Ekonomike në kreditë e përgjithshme në raport me tregun, 31 dhjetor 2023;




FIGURA 4. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumnin e kredive në raport me tregun, 31 dhjetor 2023;





Liçeni i Mitrovicës - Mitrovicë

PJESËMARRJA NË DEPOZITA

Banka Ekonomike vazhdoi të afirmohet si një aktor kryesor në tregun bankar të Kosovës gjatë vitit 2023, duke shënuar një pjesëmarrje të rëndësishme në totalin e depozitave të tregut.

Më 31 dhjetor 2023, pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në totalin e depozitave në treg ishte 8.84 përqind e sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë. Gjatë vitit 2023, Banka jonë ka shënuar një shifër që tregon për besimin dhe zgjedhjen e klientëve për t'i vendosur depozitat e tyre në Bankën Ekonomike. Kjo pjesëmarrje e lartë tregon për besueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve tona financiare.

Gjatë vitit 2023, Banka jonë shënoi një rritje prej 6.29 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë. Gjatë vitit 2023, Banka jonë ka shënuar një rritje në depozitat e pranuar, një performancë e rëndësishme që ndikon në rritjen e besimit të klientëve tanë. Krahasuar me rritjen e përgjithshme të tregut, e cila ishte 10.74 përqind të sektorit të përgjithshëm bankar në Kosovë.

FIGURA 5. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në depozita në raport me tregun, 31 dhjetor 2023;




FIGURA 6. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në volumet e depozitave në raport me tregun, 31 dhjetor 2023;




PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

EURO '000

Pasuritë	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Paraja e gatshme dhe në banka	54,299	32,388
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	74,360	95,201
Kreditë për klientët	441,298	379,892
Investime në letra me vlerë	10,605	28,225
Investimet në degë	7,358	6,058
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	13,604	13,979
Pasuritë e paprekshme	3,860	4,794
Pasuri të tjera	2,547	2,529
Gjithsej pasuritë	607,931	563,066
Detyrimet		
Depozitat nga klientët	537,067	505,342
Detyrime ndaj bankave	1,487	93
Detyrimi i tatimit në fitim	88	210
Detyrime të tjera	3,802	3,549
Detyrimi i shtyer tatimor	600	604
Gjithsej detyrimet	543,044	509,798
Ekuiteti dhe rezervat		
Kapitali aksionar	29,422	29,422
Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera	4,746	4,853
Fitime të mbajtura	30,719	18,993
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat	64,887	53,268
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat	607,931	563,066

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës në 16 Prill 2024 dhe nënshkruar në emër të tyre nga:



 Zt. Shpend Luzha
 Kryeshef Ekzekutiv



 Zt. Berat Isa
 Zyrtar Kryesor Financiar

EURO '000

Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse

Pasuritë	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	30,746	24,579
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	(5,450)	(3,251)
Të ardhurat neto nga interesi	25,296	21,328
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	4,776	4,358
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	(1,201)	(914)
Të ardhurat neto tarifa dhe komisioni	3,575	3,444
Të ardhurat e tjera operative	606	497
Të ardhurat	29,477	25,269
Shpenzimet e personelit	(5,067)	(4,548)
Zhvlersimi dhe amortizimi	(3,004)	(2,380)
Shpenzime të tjera	(8,936)	(6,613)
(Lirimi) ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në instrumentet financiare	1,380	(705)
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të prekshme	(942)	-
Gjithsej shpenzimet operative	(16,569)	(14,246)
Fitimi para tatimit	12,908	11,023
Tatimi në fitim	(1,182)	(1,003)
Fitimi neto për vitin	11,726	10,020
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse		
Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje		
Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi		
Efekt i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës	18	18
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	(125)	41
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	(107)	59
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	11,619	10,079



Biblioteka Kombëtare - Prishtinë

PERFORMANCA E BANKËS EKONOMIKE

Banka Ekonomike vazhdoi të paraqesë rezultate të shkëlqyera në vitin 2023, duke ndjekur traditën e rritjes dhe përmbushjen e kërkesave të klientëve, si dhe duke punuar me përkushtim për t'i arritur qëllimet e saj në performancën financiare.

Me përkushtimin tonë të vazhdueshëm për t'i përmbushur standardet e larta të shërbimeve bankare dhe për të ofruar zgjidhje inovative, Banka jonë ka shënuar një progres të ndjeshëm në shumicën e treguesve financiarë për vitin 2023. Kjo është konfirmuar nga fitimi para tatimit në vlerë prej 12.91 milionë euro, një arritje që tregon për aftësinë tonë për të menaxhuar efikasitetin dhe për të rritur qëndrueshmërinë financiare.

Të hyrat neto nga interesi kanë shënuar një rritje prej 18.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar, duke treguar për një performancë të përmbushur në sektorin e financave. Në të njëjtën kohë, Banka arriti të rritë të ardhurat nga tarifatat dhe komisionet, duke mbyllur vitin 2023 me 3.6 milionë euro të hyra në këtë sektor. Kjo rritje dëshmon për një strategji të suksesshme të tërheqjes së klientëve të rinj dhe për një orientim efikas të shërbimeve të Bankës sonë.

Banka jonë mbetet e përkushtuar ndaj realizimit të qëllimeve strategjike afatgjata, duke siguruar një performancë të qëndrueshme dhe duke kryer operacionet me sukses në një mjedis vazhdimisht konkurrues. Me një qasje të përkushtuar ndaj përmirësimit të shërbimeve dhe ofrimit të zgjidhjeve inovative, ne jemi të përgatitur për t'i përmbushur nevojat e klientëve tanë dhe për të arritur suksese të reja në vitin që vjen.


ASETET E BANKËS

Përkushtimi i palodhur ndaj vlerave, arritjes së qëllimeve të performancës dhe angazhimi i vazhdueshëm drejt zgjerimit të rrjetit dhe infrastrukturës së Bankës ka sjellë një rritje të ndjeshme të asetëve të Bankës për të pestin vit me radhë.

Banka jonë ka arritur një performancë të shkëlqyer në vitin 2023, ku asetet e saj janë rritur në një shifër prej 608 milionë euro, krahasuar me 563 milionë euro asetë në vitin 2022. Kjo rritje e ndjeshme tregon për një menaxhim të suksesshëm të asetëve dhe për një strategji të qëndrueshme të zhvillimit të Bankës sonë.

Përmes përkushtimit tonë të vazhdueshëm ndaj përmirësimit të shërbimeve dhe përshtatjes së tyre me nevojat e klientëve, ne kemi arritur të rrisim asetet tona në një ritëm të qëndrueshëm. Kjo tregon për besimin e klientëve tanë në cilësinë e shërbimeve tona dhe për aftësinë tonë për t'i përmbushur nevojat e tyre financiare në mënyrë efikase dhe të përshtatshme.

FIGURA 7: Asetet e Bankës Ekonomike, 2019-2023;



Të gjitha shifrat janë në '000 Eur.

PORTOFOLI KREDITOR

Menaxhimi i përshtatshëm i portofolit dhe mbikëqyrja e kujdesshme e rrezikut kanë ndikuar që edhe në vitin 2023 të vazhdojë trendi i rritjes në sektorin e kredive. Si rezultat, Banka jonë ka shënuar një rritje të ndjeshme në portofolin e kredive, duke përfshirë segmentet e sektorit privat dhe atij të biznesit.


Gjatë vitit 2023, portofoli i kredive është rritur në një shifër prej 452 milionë euro, krahasuar me 392 milionë euro në vitin e kaluar. Kjo rritje substanciale tregon për një performancë të vazhdueshme dhe për aftësinë e Bankës Ekonomike për të ofruar zgjidhje të përshtatshme kredie

Muzeu Kombëtar i Kosovës - Prishtinë

për klientët e saj në të gjithë sektorët.

Banka Ekonomike ka vazhduar të promovojë në mënyrë aktive produktet e saj më të mira të kredihënies, duke përdorur fushatat e marketingut për të nxitur përdorueshmërinë dhe për të ofruar zgjidhje financiare të përshtatshme për klientët tanë. Ky angazhim i vazhdueshëm për të ofruar produkte inovative dhe për të përmbushur nevojat e klientëve ka qenë një faktor kryesor në rritjen e portofolit të kredive dhe në qëndrueshmërinë e performancës së Bankës Ekonomike në tregun bankar të Kosovës.

FIGURA 8: Portofoli i kredive, 2019-2023;




Të gjitha shifrat janë në '000 Eur.

DEPOZITAT

Rritja e vazhdueshme e depozitave është një indikator i fuqishëm për besimin e klientëve ndaj shërbimeve të Bankës Ekonomike. Viti 2023 ka vazhduar trendin pozitiv me një rritje të depozitave, tregues i mëtejshëm për suksesin dhe besueshmërinë e Bankës sonë.

Depozitat e Bankës Ekonomike për vitin 2023 arritën një shifër prej 537 milionë euro, në krahasim me 505 milionë euro të vitit paraprak. Kjo rritje tregon për një përmirësim të vazhdueshëm të besimit të klientëve në cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve tona financiare.


FIGURA 9: Depozitat e klientëve, 2019-2023;



Të gjitha shifrat janë në '000 Eur.

Gollaku - Prishtinë

FIGURA 10. Të hyrat nga interesi, 2019-2023;



Euro '000	2019	2020	2021	2022	2023
Të hyrat nga interesi	15,847	17,966	21,513	24,577	30,746
Kostot e depozitave	2,415	2,640	2,783	3,188	5,450
Të hyrat NETO nga interesi	13,432	15,326	18,730	21,388	25,295
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat	2,162	2,030	2,467	3,444	3,575

Të gjitha shifrat janë në '000 Eur.

SHPENZIMET OPERATIVE

FIGURA 11. Shpenzimet operative



Euro '000	2019	2020	2021	2022	2023
Shpenzimet administrative	3,767	4,463	5,083	5,314	7,292
Shpenzimet e personelit	3,274	3,466	3,888	4,546	5,064
Shpenzimet e zhvlerësimit	1,827	2,277	2,367	2,611	3,055
Gjithsej shpenzimet operative	8,868	10,206	11,338	12,471	15,410

Të gjitha shifrat janë në '000 Eur.

Gjatë vitit 2023, Banka Ekonomike ka vazhduar t'u kushtojë rëndësi të veçantë investimeve në degë dhe infrastrukturë, si dhe në zhvillimin dhe trajnimin e personelit.

Rishikimi i shpenzimeve operative ka qenë një prioritet i rëndësishëm edhe gjatë këtij viti. Kjo ka përfshirë rritjen e efijencës dhe efektivitetit në të gjitha nivelet e Bankës, duke përbushur gjithmonë standardet ligjore dhe rregullat e vendosura, si dhe duke përfillur kërkesat dhe nevojat e klientëve tanë.

Brod - Dragash

Përqasja jonë e qëndrueshme ndaj menaxhimit të shpenzimeve operative ka siguruar që Banka të mbetet e qëndrueshme në një mjedis të ndryshueshëm tregtar. Kjo përgjegjshmëri e vazhdueshme ndaj përdorimit të efektiv të burimeve është një nga faktorët kryesorë të suksesit tonë në sigurimin e një performace të qëndrueshme dhe të përmbushjes së synimeve tona strategjike.

ZHVILLIMI I BIZNESIT

Banka ka vazhduar të përmbushë misionin e saj me përkushtim, duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit dhe zgjerimit të vazhdueshëm të departamenteve të saj, të cilat kanë përgjegjësi për rritjen e aktivitetit të biznesit.

Në vitin 2023, ne vazhduam të jemi mbështetës të fuqishëm të komunitetit biznesor në Kosovë, duke e konsideruar atë si një forcë kryesore për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë. Një konfirmim i qasjes sonë strategjike ndaj bizneseve është edhe përqendrimi i strukturës së portofolit kreditor të bankës, ku bizneset kanë një pjesëmarrje prej 66.6 përqind në portofolin kreditor, krahasuar me tregun ku pjesëmarrja e portofolit të Biznesit në total portofolin kreditor është 61.3 përqind, duke treguar qëndrueshmërinë dhe besimin në këtë sektor. Përveç përkushtimit ndaj bizneseve, ne i kushtojmë vëmendje të veçantë edhe nevojave të klientëve individualë. Duke pasur parasysh këtë, gjatë vitit 2023 kemi vazhduar të hapim degë të reja dhe kemi investuar në përmirësimin e infrastrukturës së shërbimeve tona, duke siguruar që të gjithë klientët tanë të kenë qasje të lehtë dhe të përshtatshme në shërbimet tona.

Përveç kësaj, kemi bërë përpjekje të vazhdueshme për të përmbushur nevojat e klientëve tanë, duke ofruar produkte dhe shërbime inovative dhe të personalizuar. Kjo përfshin zhvillimin e platformave të pagesave elektronike dhe zgjerimin e gamës së produkteve financiare për të përmbushur nevojat e një numri gjithnjë e më të madh të klientëve tanë.

Duke punuar ngushtë me të gjitha departamentet e Bankës për të zhvilluar biznesin, ne kemi arritur të jemi një partner i besueshëm dhe strategjik për klientët tanë, duke ofruar jo vetëm produkte dhe shërbime financiare të kualitetit të lartë, por edhe mbështetje dhe këshillim të specializuar për nevojat e tyre financiare.

Raporti vjetor i bankës për vitin aktual përmban një analizë të thellë të kontributit të departamentit të korporatës në portofolin e bankës. Në fakt, departamenti i korporatës ka një pjesëmarrje të rëndësishme në portofolin e kredive, duke kontribuar me 29.58 përqind. Në të njëjtën kohë, në nivelin e depozitave, departamenti ka një pjesëmarrje prej 21.58 përqind, ku një pjesë e rëndësishme, rreth 33 përqind, përbëhet nga depozitat rrjedhëse të klientëve. Vlen të theksohet se proceset kyçe brenda departamentit janë rishikuar dhe rishkruar për të përmirësuar efikasitetin e punës, ndërsa lansimi i produktit të terminaleve POS, është shoqëruar me rezultate shumë të mira.

Bazuar në rëndësinë e segmentit të Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në kuptimin e gjenerimit të punësimit dhe krijimit të vlerave të reja, Banka jonë, gjatë vitit 2023, demonstroi besim në kapacitete të bizneseve dhe mirëmbajti kreditimin e tyre, gjithmonë duke ofruar shërbim sa më të mirë për këtë grup të klientëve. Kjo iniciativë e fokusuar rezultoi e suksesshme pasi efektet ishin pozitive. Në këtë mënyrë segmenti shënoi rritje prej 16.6 milionë euro duke arritur kështu në portofol kreditor prej 124.2 milionë euro. Po ashtu në këtë pjesë ka luajtur rol edhe fondi garantes si instrument për rritje të qasjes në kapital për bizneset si dhe tejkalimi i kufizimeve për klientët, të cilët kishin vështirësi për sigurimin e kolateralit. Duke parë nevojat dhe kërkesat e tregut si dhe potencialin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Banka Ekonomike në vazhdimësi është përpjekur që t'u përgjigjet këtyre kërkesave në mënyrën më adekuate. Edhe nga aspekti i kualitetit të portfolios kemi qëndruar mjaftë mirë, duke mbajtur nivelin e kredive jo performuese brenda parametrave të pranueshëm, gjë që dëshmon qasjen profesionale në aspektin e mirëmbajtjes së portofolit. Krahas aktivitetit në kredidhënie, segmenti ka qenë i fokusuar edhe në shitje të tërthortë duke ofruar qasje të integruar ndaj nevojave të klientëve me produkte dhe shërbime tjera.

Rritja e bazës së klientelës në segmentin e individëve dhe përdorimi i produkteve elektronike janë dy qëllime të rëndësishme për bankën tonë. Viti 2023 është karakterizuar me zgjerimin e bazës së klientëve të rinj, duke ndikuar po ashtu në rritjen e depozitave dhe kredive. Duke përdorur një kombinim të strategjive të orientuara drejt klientit dhe inovacionit në teknologji, kemi arritur të rrisim numrin e klientëve të rinj në segmentin individual. Përmirësimi i përvojës së klientit nëpërmjet platformave elektronike ka ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e shfrytëzimit të produkteve dhe shërbimeve tona online. Përmes kampanjave të marketingut, të cilat janë fokusuar në përfitimet dhe lehtësitë e përdorimit të produkteve elektronike, kemi arritur të rrisim ndjeshëm ndërgjegjësimin dhe përdorimin e tyre nga ana e klientëve tanë. Kjo strategji e orientuar drejt tregut ka sjellë sukses në rritjen e bazës së klientëve dhe në përshpejtimin e rritjes së shfrytëzimit të produkteve elektronike.

Gjatë vitit 2023, Banka ka vazhduar të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve me produktin e Lizingut, ndërkohë që ka zgjeruar gamën e produkteve në dispozicion për të përmirësuar aktivitetin ekonomik në vend.



Liçeni i Ujmanit - Mitrovicë

Gjatë vitit 2023, Banka ka vazhduar të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve me produktin e Lizingut, ndërkohë që ka zgjeruar gamën e produkteve në dispozicion për të përmirësuar aktivitetin ekonomik në vend.

Rritja në kërkesën për produktin e Lizingut në trendin e vitit 2023 dëshmon një potencial të madh, dhe Banka vazhdon të angazhohet për të rritur kapacitetet e saj për të qëndruar pranë klientëve dhe për të zhvilluar produktin e Lizingut në mënyra inovative dhe efektive.

Gjatë këtij viti, Banka ka zhvilluar dhe lansuar fushata të reja të marketingut për të promovuar produktet dhe shërbimet tona, ndërsa ka fuqizuar brendin e saj si Banka me kapital 100 përqind vendor. Në një përpjekje për të rritur prezencën dhe për të përmirësuar përvojën e klientëve në botën digjitale, Banka ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të digjitalizuar shërbimet dhe për të rritur angazhimin në rrjetet sociale. Këta hapa kanë qenë të rëndësishme për të qëndruar në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe për të siguruar një përvojë sa më të përshtatshme për klientët tanë.

PORTOFOLI KREDITOR

Banka Ekonomike ka shënuar një performancë të jashtëzakonshme në portofolin kreditor gjatë vitit 2023, si rezultat i strategjisë sonë të përpunuar me kujdes dhe angazhimit tonë për t'i përbushur nevojat dhe kërkesat e klientëve tanë në të gjitha segmentet e biznesit.

Në vitin 2023, kemi vazhduar të shënojmë një rritje të qëndrueshme në portofolin kreditor, duke shtuar vlerën e tij nga 391 milionë euro, sa ishte në vitin 2022, në 450 milionë euro. Kjo rritje e madhe është rezultat i një strategjie të qëndrueshme të ofrimit të produkteve kreditore në të gjitha segmentet e tregut. Ky diversifikim i portofolit ka siguruar stabilitetin dhe rritjen e qëndrueshme të Bankës sonë në tregun e kredisë.

Me një qasje të përkushtuar ndaj nevojave të klientëve tanë dhe një angazhim të vazhdueshëm për të përmirësuar ofertën tonë kreditore, ne jemi të gatshëm për të vazhduar rrugën e suksesit në vitin 2024 dhe për të konsoliduar pozicionin tonë si një nga liderët në tregun e kredisë.

Segmenti	Ekspozimi kreditor 2022 '000	Përqindja e participimit në vitin 2022	Ekspozimi kreditor 2023 ' 000	Përqindja e participimit në vitin 2023
NVM	103,618	26,45%	124,242	27,58%
Lizing	25,800	6,58%	32,107	7,13%
Korporatë	136,570	34,86%	151,978	33,73%
Individë	125,812	32,11%	142,213	31,57%
Total	391,800	100.00%	450,540	100.00%

KLIENTËT KORPORATË

Në vitin 2023, Departamenti i Korporatës është përballur me një sërë zhvillimesh të rëndësishme, të cilat shënojnë angazhimin tonë për t'i arritur qëllimet tona dhe për të siguruar një shërbim të shkëlqyer për klientët tanë. Gjatë këtij viti kemi shënuar një rritje të kredive neto për 18.36 milionë euro. Për fat të mirë, klientët institucionalë vazhdojnë të mbajnë një përqindje prej 80 përqind të vlerës së totalit të depozitave të Departamentit.

Gjithashtu, jemi të lumtur të njoftojmë për progresin tonë në menaxhimin e kredive joperformuese. Përqindja e tyre është zvogëluar nga 2.35 përqind, sa ishte në fund të vitit të kaluar, në 2.17 përqind në fund të vitit 2023. Kjo është një dëshmi e qartë për një përmirësim të qëndrueshëm në menaxhimin e portofolit të kredive, dhe na inkurajon të vazhdojmë me të njëjtin përkushtim për të arritur standarde të larta të performancës.

Një aspekt tjetër kyç i vitit 2023 ka qenë implementimi i projektit të terminalëve POS, të cilët kanë kontribuar në një qarkullim të konsiderueshëm prej rreth 4 milionë euro. Ky sukses shfaq angazhimin e madh të ekipit tonë për inovacion dhe për zgjerimin e gamës së shërbimeve tona.

Përfundimisht, me këto zhvillime pozitive dhe sfidat e përballuara, jemi të vendosur që të vazhdojmë të përmirësojmë efikasitetin tonë dhe të ofrojmë shërbime cilësore për të gjithë klientët tanë në vitin 2024.

KLIENTËT E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Në vitin 2023, Banka jonë ka vazhduar të shfaqë besim të vazhdueshëm në potencialin e bizneseve në segmentin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Duke u kuptuar rëndësinë e këtij segmenti për ekonominë dhe për zhvillimin e komunitetit të biznesit, Banka jonë ka thelluar dhe zgjeruar përkushtimin e saj në kreditimin e këtij grupi klientësh, duke siguruar një gamë të gjerë të shërbimeve dhe mbështetjes për ta.

Në këtë kontekst, Banka jonë ka zbatuar një sërë iniciativash për të rritur suksesin e bizneseve në segmentin e NVM. Nëpërmjet ofrimit të produkteve të financimit, shitjes së tërthor dhe shërbimeve të personalizuar, ne kemi mbështetur bizneset në çdo hap të tyre të zhvillimit. Kjo iniciativë e fokusuar rezultoi të jetë e suksesshme pasi që efektet ishin pozitive. Në këtë mënyrë, segmenti shënoi një rritje prej 16.6 milionë euro, apo 15.5 përqind, duke arritur kështu në portofolin kreditor 124.2 milionë euro. Po ashtu, në këtë pjesë ka luajtur rol edhe fondi garantues (KCGF) si instrument për rritje të qasjes në financa për bizneset si dhe tejkalimi i kufizimeve për klientët të cilët kishin vështirësi për sigurimin e kolateralit.

Duke parë nevojat dhe kërkesat e tregut si dhe potencialin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, Banka Ekonomike në vazhdimësi është përpjekur që t'u përgjigjet këtyre kërkesave në mënyrën më adekuate.

Edhe nga aspekti i kualitetit të portofolit kemi qëndruar mjaftë mirë, duke mbajtur nivelin e kredive joperformuese brenda parametrave të pranueshëm, gjë që dëshmon qasjen profesionale në aspektin e mirëmbajtjes së portofolit. Krahas aktivitetit në kredi dhënie, segmenti ka qenë i fokusuar edhe në shitje të tërthortë duke ofruar një qasje të integruar ndaj nevojave të klientëve me produkte dhe shërbime tjera.

Në përfundim, sukcesi i segmentit të NVM-ve për vitin 2023 dëshmon përkushtimin tonë ndaj zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të kushteve për qasje në financa për bizneset lokale. Me një qasje të vazhdueshme për t'i përmbushur nevojat dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve tona, ne synojmë të vazhdojmë të jemi një partner i besueshëm dhe një zgjedhje e preferuar për bizneset në vend.

Liçeni i Batllavës - Besianë

KLIENTËT INDIVIDUALË

Edhe gjatë vitit 2023, Banka Ekonomike ka vazhduar zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të pozicionit të saj, si një ndër institucionet financiare më të rëndësishme në tregun kosovar.

Strategjia jonë kryesore e klientëve individualë përfshinte rritjen e veprimtarisë bankare të klientëve ekzistues, krijimin e marrëdhënieve afatgjata dhe rekrutimin e klientëve të rinj, veçanërisht nga grupmoshat e reja, duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimit ndaj tyre. Pikë kryesore e strategjisë së Bankës është ofrimi shërbimeve dhe produkteve të reja, zhvillimi i produkteve ekzistuese, produkte të përshtatura plotësisht me kërkesat e tyre.

Transformimi digjital dhe investimi në platformën digjitale vazhduan të ishin fokusi kryesor për të përforcuar pozicionin e Bankës në tregun kosovar.

Në punojmë në vazhdimësi që Banka të jetë vendi ideal për ofrimin e shërbimeve, ku klientët ndjehen të mirëpritur dhe komod gjatë menaxhimit të financave të tyre, duke punuar me përkushtim drejt përmbushjes së nevojave dhe kërkesave të klientëve tanë. Përgjatë vitit 2023, Departamenti për Individë ka ecur jashtëzakonisht mirë, duke arritur rezultate të kënaqshme financiare, duke raportuar performancë pozitive në indikatorët kryesorë: kredi dhe depozita.

Bashkëpunimi i ngushtë me rrjetin e degëve dhe nëndegëve rriti portofolin, duke ofruar produkte të Kredive Konsumatore dhe Hipotekare, dhe transformoi procesin e kredidhënies në një proces të thjeshtë dhe fleksibël. Portofoli i kredive individuale rezultoi me një rritje prej 14 përqind, apo shprehur në vlerë prej rreth 18 milionë euro.

Në vitin 2023, Departamenti për Individë arriti një sukses të rëndësishëm duke menaxhuar një rritje të qëndrueshme të depozitave. Portofoli i depozitave ka pasur rritje prej rreth 56 milionë euro, apo 19 përqind. Ecuria pozitive ka ndikuar në realizimin e strategjisë dhe objektivave të Bankës për vitin 2023, duke ruajtur gjithashtu nivelin e lartë të likuiditetit.

Liçeni i Zembrës - Bjeshkët e nemuna

Kontributi kryesor në realizimin e objektivave ka qenë nga ofrimi i produkteve dhe shërbimeve të përshtatshme për klientët individual. Këto rezultate pasqyrojnë angazhimin tonë të vazhdueshëm për të ofruar shërbime bankare cilësore dhe të sigurta.


Strategjitë efektive dhe fokusi në depozita të individëve, ofrimin e produkteve kreditore për klientët fizikë si dhe shërbimet e personalizuara do të mbeten përbërësit kryesorë në vazhdimin e punës dhe përkushtimit edhe në vitet në vijim.

KANALET E DISTRIBUIMIT DHE RRJETI I DEGËVE

Banka Ekonomike operon me një rrjet të gjerë të degëve dhe nëndegëve, duke u mundësuar klientëve qasje më të lehtë dhe më të shpejtë në kryerjen e shërbimeve bankare. Ndërsa teknologjia dhe digjitalizimi i operacioneve biznesore janë kritikë në kohën e sotme, afërsia me klientët mbetet e rëndësishme. Banka ka vazhduar të angazhohet për të qenë gjithmonë pranë klientëve, duke hapur dy degë të reja gjatë vitit 2023, duke zgjeruar rrjetin në 32 degë të shpërndara në 7 degë kryesore dhe 25 nëndegë.

Raporti i përgjithshëm i bankave tregon se Banka Ekonomike renditet edhe këtë vit si e treta në tregun bankar të Kosovës, duke e vërtetuar përkushtimin dhe angazhimin e Bankës për të qenë sa më afër klientëve. Gjatë vitit 2023, në pajtueshmëri me standardet bashkëkohore, janë rinovuar degët me qëllim të ofrimit të rehatisë gjatë marrjes së shërbimeve sa më të shpejta dhe më të lehta për klientët. Në aspektin e përmirësimit të infrastrukturës së rrjetit të degëve dhe hapësirave vetëshërbyese, është zhvendosur nëndega në Fushë-Kosovë dhe nëndega në Istog. Po ashtu, janë hapur dy nëndegë të reja, një në lagjen "Pejton" të qytetit të Prishtinës dhe një në qendrën tregtare 'Prishtina Mall', duke siguruar një vendndodhje të privilegjuar dhe të lehtësisht të qasshme për klientët. Ky hap është një shenjë e qartë e angazhimit të Bankës Ekonomike për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe për të ofruar shërbime të kualitetit të lartë në një mjedis modern dhe të përshtatshëm për tregun bankar.

FIGURA 12. Pjesëmarrja e Bankës Ekonomike në numrin e degëve në tregun bankar;



Banka Ekonomike ka një pjesëmarrje prej 11 përqind në tregun bankar për sa i përket numrit të bankomateve. Në një kohë kur teknologjia dhe jeta është dinamike, Banka Ekonomike ka kushtëzuar si prioritet kryesor shërbimet që mund t'u ofrojë klientëve në çdo kohë, përmes bankomateve, duke u bërë zgjedhja e preferuar për kryerjen e transaksioneve në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt. Për sa i përket tërheqjeve në bankomat në krahasim me vitin e kaluar, kemi regjistruar një rritje prej 19.75 përqind në numër dhe 16.26 përqind në transaksione.

Në aspektin e deponimeve në bankomat, kemi shënuar një rritje prej 50.22 përqind në volum dhe 36.14 përqind në numër të transaksioneve, ndërsa për blerjet në POS në krahasim me vitin e kaluar kemi regjistruar një rritje prej 55.53 përqind në volum dhe 73.71 përqind në numër të transaksioneve. Numri total i bankomateve në treg është 53.

POS TERMINALET

Përveç bankomateve, nga mesi i vitit 2023, Banka Ekonomike ka hyrë në treg edhe me POS terminale të teknologjisë së fundit (Android, e para në treg), duke arritur të vendosë rreth 1000 POS terminale në treg deri në fund të vitit.

Për të plotësuar ofrimin e shërbimeve cilësore për klientët, Banka jonë ka një ekip të përkushtuar në çdo degë, që siguron që çdo shërbim të ofrohet në mënyrë të duhur dhe çdo kërkesë e klientëve të trajtohet me kujdes dhe efikasitet.

KANALET ALTERNATIVE TË SHËRBIMIT NDAJ KLIENTIT - QENDRA E THIRRJEVE

Qendra e thirrjeve është një nga kanalet kryesore të komunikimit me klientët për Bankën Ekonomike. Përveç thirrjeve telefonike, qendra e thirrjeve ofron edhe shërbimin e email-it për t'i trajtuar kërkesat dhe nevojat e klientëve në një kohë sa më efektive dhe praktike të mundshme. Me një qasje 24/7, ky kanal komunikimi është në dispozicion 24/7 dhe luan një rol të rëndësishëm në rritjen e ofrimit të shërbimeve dhe plotësimin e kërkesave të klientëve, duke ndihmuar në përmirësimin e eksperiencës së tyre me Bankën.

Si rezultat i rëndësisë së qendrës së thirrjeve në ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë, Banka Ekonomike ka vazhduar të investojë në përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e saj. Zhvendosja e zyrës dhe përmirësimi i infrastrukturës gjatë vitit 2023 kanë siguruar një ambient më të përshtatshëm për punën dhe mbështetjen ndaj klientëve. Gjatë këtij viti, përmes qendrës së thirrjeve, Banka ka menaxhuar me sukses mbi 37 mijë kërkesa nga klientët dhe ka ofruar udhëzime këshilluese rreth produkteve dhe ofertave të saj.

Qëllimi dhe fokusi i Bankës për vitin 2023 ishte ofrimi i shërbimeve profesionale dhe vazhdimi me fuqizimin dhe ngritjen cilësore të këtij shërbimi, me qëllim të krijimit dhe rritjes së besueshmërisë së klientëve dhe mbajtjes së marrëdhënieve afatgjata me klientët.

Përvoja dhe arritjet e vitit 2023 në qendrën e thirrjeve tregojnë përkushtimin e Bankës Ekonomike në ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë dhe në përmirësimin e marrëdhënieve me klientët. Duke vazhduar të investojmë në zhvillimin dhe përmirësimin e këtij kanali të komunikimit, ne synojmë të vazhdojmë të ofrojmë një përvojë të shkëlqyer për klientët tanë dhe të mbelemi një zgjedhje e preferuar për nevojat e tyre financiare.

LIZINGU

Edhe gjatë vitit 2023, ne vazhduam të punojmë për të konsoliduar shërbimin tonë të lizingut. Është e rëndësishme të theksohet se departamenti i lizingut pas zgjerimit të gamës së produkteve, së cilës i është shtuar edhe lizingu për patundshmëri, produkt i ri i cili ka rezultuar pozitivisht në rritjen e trendit të kërkesës për financim me lizing dhe ka rezultuar të jetë me potencial të madh.

Lizingu në vitin 2023 ka pasur rritje në krahasim me vitin paraprak, me vlerën e disbursimeve në 24.4 përqind më shumë. Vlen të ceket se klientët NVM dhe klientët individualë kanë pasur rritje në krahasim me vitin paraprak, pra klientët NVM kanë rritje prej 45.8 përqind kurse klientët individualë kanë rritje prej 100 përqind. Portofolio aktive në volum për vitin 2023 është 32.1 milionë euro, klientët korporatë 10.5 milionë euro, klientët NVM 19.5 milionë euro dhe pjesa tjetër apo klientët individualë me vlerën afër 2.1 milionë euro.

Ky sukses është arritur duke gjeneruar klientë të ri, të cilët kanë krijuar besimin tek ne në plotësimin e nevojave të tyre financiare, me zgjerim dhe konsolidim në gamën e produkteve, duke zgjeruar bashkëpunimin me partnerët tanë.

Duke e parë si produkt me potencial të madh dhe me rritjen e kërkesës për këtë produkt, në vijim, Banka do vazhdojë me fuqizimin dhe zgjerimin e kapaciteteve me qëllim të përmbushjes së kërkesave të klientëve për gamën e produkteve që ofron Departamenti i Lizingut.

NJËSIA PËR ZHVILLIM TË BANCASSURANCE

Banka Ekonomike, si pronare e vetme e kompanisë së sigurimeve Siguria, përgjatë këtij viti ka vazhduar me jetësimin e planit të sinergjisë në mes të dy kompanive, duke u fokusuar në optimizim të proceseve për të ofruar shërbime dhe produkte sa më kualitative ndaj klientëve.

Qëllimi kryesor i sinergjisë është që Banka Ekonomike të vazhdojë t'i përkrahë klientët dhe t'i përmbushë kërkesat e tyre duke ofruar të gjitha produktet dhe shërbimet bankare dhe të sigurimit në një pikë të shitjes, dhe në këtë mënyrë, qasja jonë është që klientët tanë të shërbehen me produkte dhe shërbime të shpejta bankare dhe të sigurimit. Duke përfituar nga ekspertiza e kompanisë së sigurimeve Siguria, përgjatë vitit 2023 ne kemi arritur që nga degët e Bankës Ekonomike të ofrojmë edhe produktet dhe shërbimet e sigurimeve, sipas kërkesave të klientëve.

Në të njëjtën kohë, është konsoliduar njësia për zhvillim të bancassurance, njësi kjo e cila ka koordinuar të gjithë procesin e sinergjisë dhe siguron një bashkëpunim efektiv dhe efikas në mes të dy kompanive.

Suksesi më i madh i njësisë është realizimi i planit të ofrimit të shërbimeve bankare dhe të sigurimit në një pikë të shitjes, si një nga institucionet më inovatore në sektorin bankar. Banka Ekonomike është orientuar drejt një strategjie më të gjerë të diversifikimit të shërbimeve financiare për t'u rritur dhe për të qëndruar në krye të industrisë financiare në Kosovë.

ZHVILLIMI PRODUKTEVE

Si pjesë e angazhimit tonë të vazhdueshëm për të ofruar shërbime të shkëlqyera dhe inovative për klientët tanë, viti 2023 u shënuar si një periudhë e rëndësishme e zhvillimeve në Bankën Ekonomike.

Gjatë gjithë vitit, ne mbetëm të vendosur në angazhimin tonë për të kuptuar dhe për të përbushur nevojat e ndryshme të klientëve tanë, duke përdorur fuqinë e teknologjisë dhe inovacionit për të krijuar zgjidhje të përshtatura dhe efikase.


Një nga arritjet më të rëndësishme të Bankës në fushën e zhvillimit të produkteve është lansimi i pagesave elektronike përmes POS terminaleve. Kjo platformë e avancuar përmban teknologji të fundit në treg duke ofruar një përvojë të jashtëzakonshme për bizneset gjatë realizimit të pagesave më një nivel të lartë të efikasitetit.

Ky zhvillim paraqet një hap të rëndësishëm përpara në përmirësimin e infrastrukturës së pagesave elektronike dhe përforcimin e marrëdhënieve me klientët e Bankës. Pranimi nga klientët tanë ishte shumë pozitiv, duke na mundësuar në instalimin e pothuajse 1000 terminalëve POS dhe procesimin e mbi 200,000 transaksioneve, me një volum prej rreth 5 milionë euro.

Suksesi u thellua edhe më shumë me fitimin e mbi 73,000 euro për jo më shumë se 4 muaj nga komisionet e transaksioneve të POS-it, një shenjë e qartë e pranimin të përsosur të platformës sonë të re.

Parku Kombëtar i Bjeshkëve të Nemuna - Pejë/Cjakovë

Pos transaksionet



Në një përpjekje për të përmirësuar përvojën e klientëve të biznesit Banka ka zhvilluar kartelën e depozitës duke ofruar mundësinë e deponimit nga agjentët e biznesit përmes bankomatit. Me këtë zhvillim banka synon një përvojë më të përshtatshme dhe efikase për klientët e biznesit duke i lejuar të kryejnë operacione financiare pa vonesa. Ky produkt shërben si një zgjidhje e avancuar dhe e personalizuar për nevojat e bizneseve të mëdha/ vogla dhe klientëve të korporatave, duke përfunduar qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e tyre në menaxhimin e parave.

Duke përdorur këto kartela, bizneset mund të delegojnë agjentët e tyre të biznesit për të bërë deponimin e pazareve ditore në emër të tyre përmes kartelave të depozitit në bankomatët tanë që kanë veçorinë e deponimit. Kjo jo vetëm që e bën procesin e depozitave më të lehtë dhe më efikase për bizneset, por gjithashtu liron kohën dhe burimet e vlefshme të biznesit që mund të përdoren për të përmbushur detyrat e tjera dhe për të përparuar në aktivitetet e tyre të përditshme.



Parku i Karagaqit - Pejë

Përveç kësaj, përfitimi i kartelës së depozitës liron degët e bankës nga trajtimi i këtyre transakcioneve. Kjo jo vetëm që e lehtëson procesin e depozitave për bizneset, por gjithashtu lejon stafin tonë të përqendrohet në detyrat e tjera të rëndësishme bankare, duke përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm operacional.

Në sferën e bankimit elektronik, ne vazhduam të shtyjme kufijtë e përparimit, duke përmirësuar përvojën e përdoruesve dhe duke zgjeruar gamën tonë të shërbimeve.

Një zhvillim i vëmendshëm ishte përmirësimi i shërbimit tonë për procesimin e pagave për klientët e biznesit. Kjo zgjidhje e re lejon klientët të ngarkojnë dhe të procesojnë pagat për punonjësit e tyre me lehtësi dhe efikasitet.

Përveç kësaj, prezantuar disa karakteristika të reja brenda platformës sonë të Ebanking, duke duke përfshirë prezantimin e llogarive të trustit pensional, ku klientët do të kenë qasje për të parë bilancin e tyre përmes e-bankingut. Gjithashtu, kemi bërë të mundur edhe paraqitjen e llogarive të POS terminaleve, ku klientët e biznesit do të kenë mundësinë të menaxhojnë fondet nga transakcionet e POS-it përmes e-bankingut dhe t'i transferojnë ato në llogarinë e tyre rrjedhëse. Këto përmirësime fuqizojnë klientët për të menaxhuar fondet e tyre në mënyrë më efikase dhe më të sigurtë, duke shtuar më tej angazhimin tonë për të ofruar përvojë të jashtëzakonshme bankare.

Gjithashtu, procesi i pagesave ndërkombëtare është përmirësuar nëpërmjet automatizimit dhe avancimit të procesit me qëllim të reduktimit të kostove të pagesave. Ky inovacion na lejon të ofrojmë një shërbim më efikas dhe më ekonomik për klientët tanë kur bëhet fjalë për transakcione ndërkombëtare. Përmes këtij zhvillimi identifikohet në mënyrë automatike banka korrespondente që ofron koston më të ulët për të kryer transakcionin, duke garantuar që klientët tanë përfitojnë nga kursi më konkurrues dhe shpenzimet më të ulëta të transakcionit. Në këtë mënyrë Banka arrin të përfitoj nga një proces i optimizuar dhe efikas i pagesave, duke përmirësuar kohën, kostot dhe përvojën e klientit.

Me një fokus të përhershëm në inovacion dhe ofrimin e shërbimeve të shkëlqyera për klientët tanë, ne jemi të përkushtuar për të ndjekur përparimin dhe për të përmbushur pritshmëritë e tyre. Me të njëjtën pasion dhe përkushtim të vazhdueshëm, ne do të vazhdojmë të punojmë për të zhvilluar zgjidhje të reja dhe për të shërbyer nevojat e zhvilluara të klientëve tanë.

MENAXHIMI I RREZIKUT

Viti 2023 shënoi fillimin e stabilizimit të krizës globale financiare të shkaktuar fillimisht nga periudha pandemike, lufta në Ukrainë dhe kriza energjetike. Edhe pse gjysma e dytë e këtij viti solli në horizont elementet e para stabilizuese të ciklit të zakonshëm të krizave, viti 2023 sërish karakterizohet si vit mjaft sfidues.

Përkundër të gjitha sfidave të shkaktuara nga pandemia pasuar edhe nga konflikte ndërshtetërore në botë si dhe inflacioni, Banka ka treguar stabilitet, duke siguruar rritje të qëndrueshme, ku asetet kreditore prej vitit-në-vitit kanë shënuar rritje prej 16 përqind.

Edhe pse viti 2023 ka sjellë elemente të stabilizimit, viti 2024 duket të jetë me zhvillime mjaft të mëdha si në aspektin ekonomik ashtu edhe atë politik.

Në kontekstin lokal, viti 2024 për qytetarët e Kosovës solli liberalizimin e vizave në Zonën Shengen, një zhvillim mjaft pozitiv në aspekt integruar. Ka vite që në Kosovë ka migrim të fuqisë punëtore që po kufizon shfrytëzimin maksimal të kapaciteteve të bizneseve dhe ekziston pasiguria për rritje të mundshme të migrimit.

Parashikimet makro-ekonomike për vitin 2024 janë optimiste, ndërsa zhvillimi real ekonomik vjetor parashihet të sillet në rreth 4 përqind.

Procesi i menaxhimit të rrezikut në nivel banke përfshin menaxhimin e rrezikut kreditor, operacional, të tregut, likuiditetit, sistemeve të TI-së, investimeve dhe rreziqeve të tjera të cilave Banka mund t'u ekspozohet në çdo kohë. Më qëllim të arritjes se synimeve strategjike janë hartuar dokumente vjetore - strategji dhe janë adaptuar politika për çdo rrezik specifik në mënyrë që të mirëmbahen treguesit kyç të rrezikut, të kontrollohen dhe monitorohen në baza të rregullta, gjithnjë duke pasur për bazë kapitalin e disponueshëm të Bankës.

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut kreditor që është ndër rreziqet materiale dhe me ndikim në performancën e përgjithshme të Bankës. Në anën tjetër, Banka ka ekspozim të kufizuar ndaj tregjeve kapitale përmes thesarit ndërsa koncentrimin më të madh, rreth 72 përqind të totalit të aseteve, e mban portofoli kreditor i diversifikuar në tri segmente.

Po ashtu, vëmendje e veçantë gjatë vitit që lamë pas u është dhënë edhe trajnimeve dhe takimeve të vazhdueshme për të zhvilluar dhe përmirësuar aftësitë analitike në identifikimin e faktorëve kritikë të rrezikut kreditor. Banka do të vazhdojë të ketë qasje të njëjtë edhe këtë vit sa i përket përditësimit të njohurive të stafit, gjë që do të ketë ndikim në performancë më të mirë në menaxhimin e portofolit kreditor dhe në mbrojtjen e stabilitetit të Bankës sonë.

Një nga sukseset kyçe të këtij viti është edhe zbritja e kredive joperformuese nga 2.8 përqind (dhjetor 2022) në 2.4 përqind (dhjetor 2023). Ky rezultat është pasuar nga implementimi i strategjive dhe përdorimi i analizave të thelluara për identifikimin dhe trajtimin efikas të kredive me rrezikshmëri të lartë. Ky përmirësim shërben si dëshmi e përkushtimit të Bankës ndaj qëllimit të zvogëlimit të rrezikut kreditor dhe sigurimit të stabilitetit të portofolit kreditor.

Menaxhimi i rrezikut kreditor në Bankë është thelbësor për qëndrueshmërinë financiare dhe reputacionin e Bankës. Duke vazhduar të përqendrohemi në përmirësimin e proceseve dhe përdorimin e teknikave inovative, synojmë të ruajmë pozicionin tonë të sigurt në treg dhe t'i mbrojmë interesat e klientëve dhe aksionarëve tanë.

RREZIKU OPERACIONAL

Me qëllim të vendosjes së një sistemi efektiv të vlerësimit të rrezikut në të gjitha nivelet e Bankës, rreziku operacional kategorizon të gjitha ngjarjet e rrezikut si rreziku nga njerëzit, proceset, sistemet, ngjarjet e jashtme. Të gjitha ngjarjet e rrezikut mund të sjellin një shkallë të rrezikut reputacional, që nuk është pjesë e përkufizimit, por megjithatë është një rrezik i rëndësishëm për Bankën. Banka ka për qëllim të zvogëlojë rrezikun reputacional duke menaxhuar me efikasitet llojet e saj të tjera të rrezikut, përmes trajtimit të vazhdueshëm të të punësuarve, investimeve në teknologji, hartimit adekuat të proceseve si dhe kontrolleve tjera. Banka përcakton nivelin e rrezikut duke kombinuar ndikimin financiar dhe probabilitetin/gjasën e ndodhjes së një rasti. Procesi i vlerësimit dhe e gjithë korniza e menaxhimit të rrezikut operacional janë të lidhura ngushtë me tolerancën e Bankës ndaj rrezikut. Rishikimi i vazhdueshëm i aftësive të organizatës për ta menaxhuar rrezikun me të cilin ajo përballet, adresimi i të gjitha rreziqeve relevante dhe posedimi i një kornize për t'u përgjigjur rreziqeve janë vendimtare për një strategji të suksesshme të menaxhimit të rrezikut.

RREZIKU I LIKUIDITETIT

Rreziku i likuiditetit shfaqet kur nuk ka mjete të mjaftueshme për t'i përmbushur kërkesat e financimit në kohën e duhur dhe mund të ndodhë edhe kur pozicionet e hapura nuk mund të mbyllën në kohë me çmime të përshtatshme. Në anën tjetër, si pjesë e rrezikut të tregut shfaqet kur një pasuri e Bankës mund të humbasë në vlerë për shkak të ndryshimit të normës së interesit. Sa i përket likuiditetit, gjatë pjesës së parë dhe të dytë të vitit 2023, sektori bankar ka qenë i stresuar për herë të parë në një dekadë me tërheqje të depozitave për shkak të pasigurisë së biznesit dhe individëve, ndërkohë që sektori është rikuperuar mirë gjatë pjesës së tretë të vitit 2023, ku baza e depozitave është rritur dukshëm si pasojë e normave atraktive të interesit të ofruara për llogaritë e afatizimit.

Me qëllim të menaxhimit të hendekut sa u përket lëvizjeve të normave të interesit është zbatuar produkti i normës variabile të interesit. Raporti i Mbulueshmërisë me Likuiditet vazhdon të jetë në nivele të larta, duke mbajtur në nivel raportin e mbulueshmërisë me likuiditet dukshëm mbi kërkesën ligjore. Banka është mjaftueshëm likuide si dhe ka aftësi që në kohë t'i përmbushë detyrimet aktuale dhe të ardhshme. Gjatë gjithë periudhës janë mbajtur limitet e përcaktuara nga rregullatori, si dhe në baza të rregullta janë monitoruar indikatorët kyç të likuiditetit të cilët japin sinjale pozitive për stabilitet në Bankë.

RREZIKU I TREGUT

Rreziku i tregut është rreziku që vjen nga humbjet prej pozicioneve brenda dhe jashtë bilancit të Bankës që vijnë nga lëvizjet në kushtet e tregut si ndryshimi i normave të interesit dhe normave të këmbimit. Normat e interesit Euribor kanë pësuar rritje të ndjeshme gjatë vitit 2023.

PROCESI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM TË MJAFTUESHMËRISË SË KAPITALIT

Banka ka zbatuar dokumentin i cili si koncept ka për qëllim të identifikojë, vlerësojë dhe menaxhojë të gjitha rreziqet sipas standardeve të Basel-it për mjaftueshmërinë e kapitalit. Ky proces i standardizuar i vlerësimit të brendshëm është i rëndësishëm për planifikimin e kërkesave minimale për kapital, ndaj të cilave Banka është ekspozuar apo mund të ekspozohet në mënyrë që të vazhdojë me operacione të rregullta të biznesit. Rreziqet individuale që rrjedhin prej modelit apo strategjisë gjatë kohëzgjatjes së planit të biznesit, koncentrimi i portofolit kreditor, disponueshmëria e kolateralit, rreziku operacional dhe i sistemeve të TI-së, likuiditetit, rreziku i normës së interesit, e përcakton nevojën e planifikimit të kapitalit për këto rreziqe.

RREZIKU I TI-SË

Rreziqet e TI-së çdo ditë e më shumë po kthehen në dukuri të përditshme në shumicën e institucioneve pasi që vazhdimisht po digjitalizohen proceset, andaj është e nevojshme që këto rreziqe të kontrollohen në mënyre efektive. Rreziqet, nëse nuk trajtohen si duhet, kthehen në incidente të cilat mund të rezultojë në dëme të konsiderueshme financiare dhe reputacionale. Për t'i zvogëluar këto rreziqe, Banka ka investuar në masa të qëndrueshme të sigurisë kibernetike dhe ka siguruar që punonjësit e Bankës janë vetëdijësuar në formë adekuate për t'i zbuluar dhe parandaluar kërcënimet e mundshme.

Menaxhimi i Rrezikut të TI-së brenda Bankës vlerësohet në baza të rregullta nga Departamenti për Menaxhimin e Rrezikut, si funksion i pavarur prej Departamentit të TI-së. Vlerësimi i rreziqeve të rregullta të vlerësuara dhe të ndërlydhura me sistemet e TI-së është i ndarë në këto kategori: Rreziku nga ndryshimet, rreziku i vazhdimësisë dhe disponueshmërisë, rreziku i integritetit të të dhënave, rreziku i palëve të treta kontraktuese dhe rreziku i sigurisë.

Në kuadër të trajtimit të rrezikut të vazhdimësisë dhe disponueshmërisë, Banka ka të hartuar një plan të vazhdimësisë së biznesit i cili rishikohet dhe simulohet në baza vjetore si dhe ad-hoc në hapësirat e Qendrës së Rikuperimit të të Dhënave.

OPERACIONET DHE PAGESAT

Banka Ekonomike ka vazhduar përqendrimin në shërbimin e klientëve dhe stabilitetin e funksioneve operacionale duke zhvilluar dhe zbatuar një numër të projekteve zhvillimore që kanë të bëjnë me përmirësimin e proceseve të Bankës dhe plotësimin e kërkesave ligjore vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Me këtë, Banka Ekonomike vazhdon të jetë konkurrent në treg, duke qenë e orientuar drejt përmirësimit të mëtejshëm të infrastrukturës së shërbimeve ndaj klientëve tanë.

Banka Ekonomike ka implementuar projekte të ndryshme që kontribuojnë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve të pagesave.

TRANSFERET KOMBËTARE


Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse, nga 1.96 miliardë sa ishte në vitin 2022, është rritur në 2.17 miliardë në vitin 2023, që përbën një rritje prej rreth 10 përqind, përderisa gjatë vitit 2023 transferet dalëse kombëtare të kryera në degë kanë pasur një rritje prej 5 përqind në shumë dhe rritje prej 3 përqind në numër krahasuar me vitin paraparak. Në kuadër të strategjisë së Bankës sonë për avancim të mëtejshëm të automatizimit të proceseve dhe shfrytëzimit të kana

Kalaja e Prizrenit - Prizren

leve alternative, shfrytëzueshmëria e platformës E-Banking është rritur për 22 përqind në numër dhe 16 përqind në vlerë.

Transferet Kombëtare **Hyrëse** dhe **Dalëse**

FIGURA 13. Transferet kombëtare, hyrëse dhe dalëse; Të gjitha shifrat janë në '000 Eur




TRANSFERET NDËRKOMBËTARE

Transferet ndërkombëtare në vitin 2023 kanë pasur rritje krahasuar me vitin paraparak. Vlera e përgjithshme e transfereve hyrëse dhe dalëse është rritur për rreth 14 përqind, nga 467 milionë sa ishte në vitin 2022 në 526 milionë për vitin 2023, siç është prezantuar në tabelën më poshtë. Shfrytëzueshmëria e platformës E-Banking sa i përket pagesave ndërkombëtare është rritur për 23 përqind në numër dhe 46 përqind në vlerë në krahasim me vitin 2022, ku 46 përqind e të gjitha transfereve dalëse ndërkombëtare janë realizuar përmes E-Banking gjatë vitit 2023.

Burimi i Istogut - Istog

FIGURA 14. Transferet ndërkombëtare hyrëse dhe dalëse; Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Transferet Ndërkombëtare **Hyrëse** dhe **Dalëse, Total**




GARANCIONET DHE LETËRKREDITË NDËRKOMBËTARE

Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak, kanë pasur zvogëlim. Nëse marrim shumën totale të garancioneve në këtë vit, kemi zvogëlim për rreth 48 përqind në krahasim me vitin e kaluar.

FIGURA 15. Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare ndër vite.

Të gjitha shifrat janë në '000 Euro

Garancionet dhe letërkreditë ndërkombëtare



KARTELAT BANKARE

Banka Ekonomike vazhdon të luajë një rol kyç në sektorin e shërbimeve financiare, duke ofruar një gamë të gjerë të debit dhe kredit kartelave për klientët tanë brenda dhe jashtë vendit. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i debit kartelave të brendit Mastercard dhe Visa në krahasim me vitin e kaluar ka shënuar një rritje prej 9 përqind, duke arritur në një total prej mbi 96 mijë kartelash. Ky është një tregues i qartë i rritjes së besimit të klientëve në produktet tona dhe i nevojës së shtuar për mjetet e sigurta të pagesave.

Një trend i njëjtë shihet edhe tek kredit kartelat, duke treguar një rritje prej 8 përqind krahasuar me vitin e kaluar.

Në të njëjtën kohë, duhet të theksojmë edhe rritjen e numrit të kartelave debitore lokale. Kemi një total mbi 21 mijë kartelash debitore lokale, duke shënuar një rritje prej 7 përqind në krahasim me vitin e kaluar. Kjo rritje tregon një rritje të vazhdueshme të nevojave të klientëve për shërbimet tona në tregun vendas.

Këto rritje pozitive në numrin e debit dhe kredit kartelave, si dhe në kartelat debitore lokale, është një shenjë e qartë e suksesit të strategjisë sonë për të ofruar zgjidhje inovative dhe të përshtatshme për nevojat e klientëve tanë.

Banka Ekonomike	2019	2020	2021	2022	2023
Debit Kartela	54,145	72,966	75,134	87,090	96,135
Kredit Kartela	5,350	6,863	7,452	7,657	8,301
Kartela Lokale		8,040	17,466	20,024	21,463

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT

Në vitin 2023, Departamenti i Teknologjisë së Informacionit ka vazhduar të përparojë në përm-bushjen e objektivave të tij të rëndësishme, të përqendruara në përmirësimin e sigurisë, besueshmërisë dhe ofrimin e produkteve/shërbimeve inovative. Strategjia primare e TI-së është përqendruar në këto aspekte kryesore për të siguruar një infrastrukturë të fuqishme dhe të sigurt për t'i mbështetur nevojat e Bankës dhe klientëve tanë. Ekipi ynë gjithashtu ka bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të disponueshmërisë në rimëkëmbjen e tyre nga fatkeqësitë. Investimet në pajisje të avancuara të rrjetit janë bërë për të rritur sigurinë dhe disponueshmërinë e infrastrukturës sonë teknologjike. Përmirësimi i prezencës sonë në shërbimet Cloud të Office 365 ka sjellë përparime të rëndësishme, duke mundësuar organizimin më të mirë të punëve dhe sigurimin e vazhdimësisë së biznesit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm ka qenë zëvendësimi i shumë kompjuterëve të vjetër me performancë të ulët me versione më të reja dhe më të shpejta, duke siguruar një infrastrukturë më efikase dhe të gatshme për t'i përballuar sfidat e kohës.

Përveç kësaj, kemi përjetuar zhvillime të reja në sistemin tonë, duke na sjellë në një mjedis më të qëndrueshëm dhe të digjitalizuar, që është në përputhje me kërkesat e tregut. Këto ndryshime janë vlerësuar pozitivisht nga klientët e Bankës dhe janë një dëshmi e përkushtimit tonë për të ofruar një eksperiencë më të mirë për ta.

Gjithashtu, kemi vazhduar të investojmë në inovacion, duke implementuar pajisje POS inovative në treg dhe duke shtuar shërbime të reja në platformën tonë të e-bankingut. Implementimi i numrit pa pagesë për qendrën tonë të thirrjeve ka përmirësuar shërbimin për klientët dhe ka rritur efikasitetin tonë në komunikim me ta.

Ndër të tjera, nga aspekti i sigurisë së informacionit, objektivi ynë kryesor është të garantojmë sigurinë dhe mbrojtjen e informacionit të klientëve dhe punonjësve tanë, dhe jemi krenar të themi se kemi bërë hapa të mëdhenj drejt këtij qëllimi.

Për të garantuar mbrojtjen e të dhënave dhe të sistemeve tona, Departamenti i sigurisë së informacionit ka ndërmarrë një sërë masash dhe implementime të përhershme.

Fillimisht, kemi investuar në trajnime dhe ndërgjegjësim për stafin tonë lidhur me rrezikun e sigurisë së informacionit dhe praktikat e sigurisë. Kjo ka përfshirë edukimin e tyre për identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme, si dhe për rolin e tyre në mbrojtjen e të dhënave.

Pastaj kemi kryer një analizë të hollësishme të rrezikut për t'i identifikuar pikat e dobëta dhe që mund të jenë të rrezikshme në infrastrukturën tonë. Si rezultat, kemi ndërmarrë veprime për t'i adresuar këto rreziqe dhe për të përmirësuar sigurinë tonë në tërësi.

Implementimi i softuerëve të ndryshëm për sigurinë e informacionit është gjithashtu një fokus i rëndësishëm për ne. Kemi përdorur softuerë të specializuar për zbulimin e rreziqeve, monitorimin e aktivitetit të rrjetit, dhe mbrojtjen e të dhënave të ndjeshme. Kjo na ka lejuar të identifikojmë shpejt incidentet potenciale dhe të ndërhyjmë në mënyrë efektive.

Në lidhje me kontrollet, kemi vendosur një strukturë të qartë të kontrollit të sigurisë së informacionit për të siguruar zbatimin e politikave dhe procedurave të përcaktuara. Përmes inspektimit dhe vlerësimit periodik, monitorojmë zbatimin e këtyre kontrolleve për të siguruar që sistemet tona janë në përputhje me standardet dhe parashikimet e sigurisë.

Një aspekt i rëndësishëm i përmirësimit të sigurisë së informacionit është përdorimi i modeleve të sigurisë në baza CIS (Center for Internet Security). Këto modele na ofrojnë udhëzime specifike dhe të testuara për të përmirësuar sigurinë tonë nëpërmjet konfigurimeve të sistemeve dhe aplikimeve.

Në fund, për të forcuar mbrojtjen tonë, jemi në procesin e implementimit të standardeve ISO 27001 për menaxhimin e sigurisë së informacionit. Kjo përfshin një qasje të strukturuar dhe të dokumentuar për t'i menaxhuar rreziqet, duke përdorur një qasje të bazuar në rrezik për t'i identifikuar dhe trajtuar rreziqet potenciale.

Në përfundim, përkushtimi ynë për të përmirësuar sigurinë e informacionit është i palëkundur. Përmes trajnimeve të stafit, analizës së rrezikut, implementimit të softuerëve të specializuar, kontrolleve të rregullta dhe zbatimit të standardeve të njohura ndërkombëtare, ne vazhdojmë të ndërtojmë një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për të dhënat tona.

MENAXHIMI DHE TRAJNIMI I PERSONELIT

Duke pasur parasysh rëndësinë e stafit, si resurs kryesor për arritjen e qëllimeve të Bankës Ekonomike, jemi orientuar në rekrutimin e profileve sa më të përshtatshme për pozitat përkatëse por gjithmonë duke u ofruar mundësi zhvillimi brenda institucionit.

Me fokus kryesor në maksimizimin e fitimit dhe krijimin e ambientit të punës si një ambient konkurrues në tregun e punëkërkesve, jemi siguruar që gjatë vitit 2023, përveç plotësimit të pozitave të reja me punonjës të rinj, të përkujdesemi edhe për punonjësit aktualë duke ofruar trajnime nga fusha të ndryshme por edhe duke organizuar ngjarje të ndryshme rekreative në mënyrë që të kemi një ambient sa më atraktiv për ekipin tonë, duke arritur kështu në 423 numri total i punonjësve.

Si çdo vit, edhe në vitin 2023 Banka Ekonomike ka bërë shpërndarjen e mirënjohjeve për punëtorët me 10 dhe 20 vite përvojë pune në Bankën Ekonomike, gjë që konfirmon edhe një herë se Banka Ekonomike vazhdon të jetë punëdhënëse atraktiv me kulturë organizative dhe ambient të mirë të punës.

Vlen të ceket se Banka Ekonomike, në bashkëpunim me një numër të madh të universiteteve, ka vazhduar që edhe gjatë vitit 2023 t'u ofroj mundësi për të kryer punën praktike studentëve në vitet e fundit të studimeve apo të posadiplomuarve nga fakulteti duke i angazhuar ata në projekte të ndryshme përbrenda Bankës. Gjatë vitit 2023, kjo mundësi u është ofruar rreth 45 studentëve/të posadiplomuarve kryesisht me fushë studimi ekonominë dhe administratën si dhe teknologjinë informative. Nga ky program i studentëve, karrierën me Bankën tonë e kanë vazhduar mbi 20 studentë të profileve të ndryshme.

Si pjesë e integruar e strategjisë sonë për të punësuarit, trajnimi dhe zhvillimi brenda Bankës Ekonomike luan një rol kryesor në ndërtimin e aftësive dhe shkathtësive për të ardhmen. Sikurse edhe në vitet e mëparshme, edhe këtë vit jemi përkushtuar në zhvillimin profesional të të gjithë punonjësve në fusha të ndryshme relevante.

Në përgjithësi, punonjësit tanë në vazhdimësi kanë ndjekur aktivitete trajnuese gjatë gjithë vitit. Ne jemi shumë të përkushtuar ndaj kapitalit njerëzor dhe punës ekipore për t'iu përgjigjur rrethanave gjithnjë në ndryshim, si dhe sjelljes dhe kërkesave të klientëve në zhvillim.



Çarshia e vjetër e qytetit - Pejë

Në përgjithësi, punonjësit tanë në vazhdimësi kanë ndjekur aktivitete trajnuese gjatë gjithë vitit.

Ne jemi shumë të përkushtuar ndaj kapitalit njerëzor dhe punës ekipore për t'iu përgjigjur rrethanave gjithnjë në ndryshim, si dhe sjelljes dhe kërkesave të klientëve në zhvillim.

Gjatë këtij viti, kemi vazhduar përkushtimin tonë në trajnimin e të gjithë punonjësve me fokus të veçantë orientimin kulturor dhe etik të punës, duke i aftësuar ata me shkathtësi teknike dhe përmes aftësive të buta, rifreskimin e njohurive rreth politikave dhe procedurave të bankës, si dhe të gjitha trajnimet e kërkuara nga rregullatori.

Ndër tjerash, gjatë vitit 2023 kemi vazhduar përmirësimin në udhëheqjen tonë nëpërmjet trajnimit të një grupi menaxherësh të departamenteve të cilët kanë ndjekur trajnime në nivel më të avancuar nga institucionet kredibile botërore si Harvard, Oxford, Cambridge, MIT, të cilët do të mbështesin transformimin digjital të proceseve bankare si pjesë e vazhdueshme e strategjisë si dhe duke i ndihmuar punonjësit në rrugën e tyre të karrierës hap pas hapi.

Ne kemi vazhduar të jemi të përkushtuar edhe në konsolidimin e drejtuesve dhe suksesorëve tanë brenda institucionit, të cilët përmes trajnimit janë aftësuar të promovojnë një model lider-shipi të mirëfilltë në zhvillimin dhe menaxhimin e ekipeve.

PAJTUESHMËRIA E PËRGJITHSHME

Departamenti i pajtueshmërisë, në ushtrim të funksionit dhe përgjegjësive, në vazhdimësi është kujdesur për harmonizimin e akteve dhe proceseve të brendshme të institucionit në përputhje me legjislacionin primar dhe sekondar si dhe praktikatat ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të një mjedisi të punës sa më të shëndoshë dhe proaktiv.

Bazuar në funksionet e departamentit të pajtueshmërisë, rëndësi e veçantë, ndër të tjera, i është kushtuar funksionit të menaxhimit të dokumenteve të brendshme të Bankës, i cili pasqyron ofrimin e proceseve bankare, kërkesat rregullatore dhe ligjore, si dhe përgjegjësitë e palëve përgjegjëse.

Gjithashtu, si prioritet parësor dhe vëmendje i është kushtuar trajnimit të stafit të Bankës në fushën e pajtueshmërisë, me ç'rast është digjitalizuar trajnimi për të gjithë stafin, me qëllim të informimit dhe vetëdijesimit të tyre në lidhje me kërkesat ligjore dhe rregullative, aktivitetet e pajtueshmërisë, mënyrat e komunikimit, me theks të veçantë: mënjanimin/shmangien e konfliktit të interesit; konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale; parandalimin e mashtrimeve si dhe rëndësinë apo rolin e informatorit/sinjalizuesit në Bankë.

PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS

Përgjegjësia sociale e korporatës ka qenë një element kyç në përfaqësimin dhe promovimin e vlerave të Bankës Ekonomike dhe është thelbësore për misionin tonë për të ndikuar pozitivisht në komunitetin dhe mjedisin që na rrethon.

Në vitin 2023, Banka Ekonomike ka qenë e përkushtuar në mbështetjen e projekteve sociale në të gjithë vendin. Kemi investuar në mbi 50 projekte të ndryshme, në fusha si: arsimit, shëndetësia, sporti dhe kultura. Përveç kontributit financiar, kemi ofruar edhe ekspertizën tonë në menaxhimin e projekteve dhe strategjitë afatgjata për të siguruar suksesin e tyre në realizimin e qëllimeve të tyre të përbashkëta.

Angazhimi ynë në mbështetjen e projekteve sociale është një detyrë që ne e marrim shumë seriozisht dhe kemi qëllimin e qartë për të vazhduar këtë angazhim edhe në të ardhmen. Ne besojmë se duke qenë një partner i besueshëm i shoqërisë dhe duke qenë aktorë të përgjegjshëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve, ne mund të ndërtojmë një shoqëri më të mirë dhe një mjedis më të qëndrueshëm për të gjithë.

Në vijim do të paraqesim në detaje projektet sociale që kemi mbështetur gjatë vitit 2023 dhe ndikimin pozitiv që kanë pasur në shoqëri dhe mjedis, duke synuar të demonstrojmë përpjekjet tona për të bërë një ndryshim pozitiv dhe për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë.



Malet e Lubotenit - Sharr

MBËSHTETJA PËR SPORTIN

Në vitin 2023, Banka Ekonomike vazhdoi të angazhohet për sportin, duke shfaqur një përkushtim të vazhdueshëm për të përparuar komunitetin lokal dhe për të ndikuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Në përshtatje me këtë qëllim, Banka ka investuar në një numër të madh të klubeve sportive në të gjithë Kosovën.

Gjatë vitit 2023, Banka Ekonomike ka sponsorizuar dhe mbështetur 46 klube sportive në fusha të ndryshme sportive, duke përfshirë futbollin, hendbollin, volejbollin, tenis, dhe shumë sporte të tjera. Ky angazhim ka shërbyer si një investim në të ardhmen e sportit në vend, duke siguruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e talenteve sportive dhe për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e aktivitetit fizik në jetën e qytetarëve.

Përmes kësaj mbështetjeje të përkushtuar, Banka Ekonomike ka ndihmuar në rritjen e nivelit të konkurrencës dhe performancës në fushat sportive lokale, duke krijuar një mjedis më të fuqishëm dhe më të zhvilluar për sportistët dhe tifozët e tyre.

Duke parë nevojën për mbështetje të klubeve me qëllim të krijimit të kushteve sa më të mira për punë, kemi vazhduar me mbështetjen e 46 klubeve në mbarë Kosovën, si: KB Rahoveci, KH

Raporti vjetor





Rahoveci, KB Vëllaznimi, KFC Vëllaznimi, FC Malisheva, KF Gjakova, Klubi i Hendbollit, Vushtrria - Femrat, Klubi i Hendbollit Vushtrria – Meshkujt, KF Trepça 89, KB Trepça, Klubi i Hendbollit Trepça-M, KPP Lidhja e Prizrenit, KB Bashkimi, Klubi i Karatesë - Eagle Karate, KBF Bashkimi (femrat), Klubi i Shahut Sharri, KF Kosovari , KF Drenasi, Kv Feronikeli, K.F. Llapë 1932 Sh.p.k, KV Ulpiana, KF Flamurtari, 2 Korriku, FC KEK, KF Shkëndija Hajvali, Skijimi, KV Prishtina Elite, TOP Futboll, Federata e Golfit të Kosovës, Federata e Tenisit të Kosovës, Klubi i Volejbollit Prishtina Femrat, Klubi i Volejbollit M-technologie, Klubi i Atletikës Dardania, Klubi i Shenjtërisë dhe Shig-jetarisë, Tenis Hajvali, Akademia Taekwondo Hapkido Tiger, FC Ferizaj, KVF Klubi i Volejbollit, Klubi i Hendbollit Ferizaj, KF Lepenci, KB ISTOGU, KB Peja, KVF Drita, FC Drita SHPK, SC Gjilani, Klubi i Volejbollit FENIKS Kamenice.

Angazhimi ynë në sport shpreh vlerat e Bankës Ekonomike në përkrahje të zhvillimit të komunitetit dhe promovimit të një stili jetese të shëndetshme. Përmes kësaj përpjekje të vazhdueshme, ne synojmë të krijojmë një mjedis më të mirë për të gjithë qytetarët dhe të përcaktojmë një standard të lartë të kontributit tonë shoqëror dhe kulturor në Kosovë.

BANKA EKONOMIKE ME DEGË TË RE NË “PRISHTINA MALL”

E njohur si bankë me kapital 100 përqind vendor, besnike ndaj të gjithë klientëve për 23 vite me radhë, duke i qëndruar krah parimeve cilësore dhe të sigurta, Banka Ekonomike ka hapur degë të re në “Prishtina Mall”, lokacion i ri por me qëllime të njëjta.

Banka Ekonomike vazhdon të demonstrojë angazhimin e saj në zhvillimin ekonomik dhe financiar në të gjitha anët e Kosovës.





JAVA NDËRKOMBËTARE E PARASË

Banka Ekonomike ka shënuar Javën Ndërkombëtare të Parasë me disa aktivitete dhe ligjërata të dedikuara për fëmijët. Fëmijët e shkollës fillore “Mileniumi i Tretë” vizituan Bankën Ekonomike, të cilët nga afër janë njoftuar me ambientet e Bankës, proceset e punës si dhe mësuan më shumë rreth rëndësisë së kursimit. Po ashtu, Banka Ekonomike ka vizituar fëmijët e “Kopshtit Magjik”, duke i mësuar fëmijët për rëndësinë e kursimit që në moshë të vogël. Ne po ndihmojmë të ndërtojmë një kulturë të mirëqenies financiare që do të ndihmojë në përmirësimin e jashtëzakonshëm të jetës sonë financiare në të ardhmen.

Banka Ekonomike do të vazhdojë të jetë e angazhuar në mbështetjen e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin të financave personale për të gjithë.

DHURIMI I PAJISJES PËR DETEKTIMIN E PARAVE TË FALSIFIKUARA NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE “PRISHTINA PARKING”

Banka Ekonomike i dhuron Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking” pajisje për detektimin e parave të falsifikuara.



Përgjegjësia Sociale është një nga vlerat kyçe të Bankës Ekonomike. Ne jemi mbështetës aktiv i proceseve që e lehtësojnë dhe përmirësojnë mbarëvajtjen e shërbimeve ku përfiton publiku, dhe në këtë drejtim kemi vendosur t'i dhurojmë si donacion pajisje për detektimin e parave të falsifikuara Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking”.

BANKA EKONOMIKE VLERËSOHET NGA VISA

Banka Ekonomike vlerësohet nga VISA për lansimin e kartelës së parë metalike Visa Platinum në Kosovë, kartelë e cila ofron avantazhe dhe privilegje të veçanta.

Ky vlerësim vjen si rezultat i angazhimit të pandërprerë të Bankës duke u kushtuar vëmendje të veçantë zhvillimeve teknologjike, duke bërë një hap të rëndësishëm në tregun e kartelave në Kosovë për të ofruar zgjedhje të reja dhe inovative për klientët tanë.

Përmes këtij donacioni, Banka Ekonomike do të kontribuojë dhe ndihmojë në evidentimin e parasë së falsifikuar, në mënyrë që të eliminohen nga qarkullimi paratë e falsifikuara, gjë që ndikon në mbrojtjen e qytetarëve tanë.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI MES BANKËS EKONOMIKE DHE FONDIT KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

Banka Ekonomike dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore zyrtarizuan bashkëpunimin përmes nënshkrimit të marrëveshjeve për dy dritaret e reja financiare “Dritarja Gratë në Biznes” dhe “Dritarja StartUP”.

Bazuar në këtë ngjarje të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë së vendit, Shpend Luzha, Kryeshef Ekzekutiv i Bankës Ekonomike, theksoi: “Është kënaqësi të njoftojmë se Banka Ekonomike ka arritur marrëveshje me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore në lidhje me lansimin e Dritares së Re për Gratë në Biznes dhe Start-up Bizneset.

Kjo marrëveshje është një hap drejt mbështetjes së grave në biznes dhe nxitjes së inovacionit dhe zhvillimit të start-up bizneseve. Me këtë marrëveshje, Banka Ekonomike do të ofrojë garanci kreditore për biznese të reja dhe bizneset që janë të themeluara ose të drejtuara nga gratë, duke u mundësuar atyre qasje në financa për të ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e tyre.

Banka Ekonomike do të vazhdojë të angazhohet në mbështetjen e komunitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe nxitjen e barazisë gjinore në fushën e biznesit”.



BANKA EKONOMIKE NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME MEISTER TRAINING CENTER

Banka Ekonomike nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Meister Training Center për financimin e programit të studimeve.

Banka Ekonomike vazhdon me përkrahje të arsimit dhe zhvillimit të rinisë në vendin tonë duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Meister Training Center, për financim të programit të trajnimit dhe punësimin në programet e mëposhtme:

- Instalues elektrik;
- Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit;
- Operator i robotëve industrialë-technik i drejtimit të mekatronikës.

Rrjedhimisht, Banka Ekonomike, përmes financimit, inkurajon të gjithë të interesuarit të bashkohen në këtë program dhe të përfitojnë qasje më të lehtë në tregun e punës.



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI NË MES TË BANKËS EKONOMIKE DHE UNIVERSITETIT "HAXHI ZEK"

Marrëveshja e bashkëpunimit mes Bankës Ekonomike dhe Universitetit "Haxhi Zeka" është një hap i rëndësishëm drejt ofrimit të mundësive të punës praktike për studentët e universitetit. Kjo marrëveshje synon të japë mundësi tërheqëse për studentët e vitit të fundit ose ata që kanë mbaruar studimet e tyre së fundmi.

Nëpërmjet programit të saj "Onboarding", Banka Ekonomike do t'ua ofrojë studentëve mundësinë për të kryer punë praktike në institucionin tonë. Është objektivi i Bankës Ekonomike që t'i përshtasë detyrat e punës praktike me fushën e studimit të Universitetit "Haxhi Zeka", duke u përpjekur të maksimizojë përvojën praktike të studentëve.

Ky bashkëpunim paraqet një rast të shkëlqyeshëm për studentët e Universitetit "Haxhi Zeka" për të fituar njohuri të reja dhe për t'i zhvilluar aftësitë e tyre praktike në fushën e financave dhe bankave.

Ne shpresojmë që kjo marrëveshje do të vazhdojë të rrisë ndërlidhjet e mira mes Bankës dhe Universitetit duke kontribuar në rritjen e cilësisë së arsimit dhe të punësimit të studentëve.



BANKA EKONOMIKE NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE (FKGK)

Banka Ekonomike nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), marrëveshja e quajtur Dritarja GROW. ZV Kryeshefi Ekzekutiv i Bankës Ekonomike, Arijan Haxhibeqiri dhe Drejtori Menaxhues i FKGK-së, Besnik Berisha, kanë bërë një hap të rëndësishëm me një qëllim të qartë, përkrahjen e investimeve në fushën e energjisë së ripërtëritshme dhe eficientën e energjisë në Kosovë. Arijan Haxhibeqiri theksoi se Banka Ekonomike është e angazhuar për të vazhduar këtë rrugë të suksesshme të bashkëpunimit me FKGK, duke ofruar këshillë dhe mundësi konkrete për investime në energji të ripërtëritshme.

Në një thirrje për bashkëpunim të mëtejshëm Zt. Haxhibeqiri ka shfaqur gatishmërinë e Bankës Ekonomike për të ndihmuar ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në kuptimin dhe përfitimin maksimal të investimeve në këtë fushë. Kjo marrëveshje sjell një perspektivë të re në fushën e financave dhe energjisë, ndërsa Banka Ekonomike do të vazhdojë të jetë ndihmojë të jenë sa më pranë dhe sa më efikas në shpërndarjen e ndihmës për ata që kanë nevojë për më shumë kujdes dhe dashuri. Organizata "Jetimat e Ballkanit" ka një mision të rëndësishëm dhe të admirueshëm humanitar, që jep një kontribut për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit tonë. Banka Ekonomike do të vazhdojë të tregoj kujdesin e nevojshëm për kategoritë shoqërore, duke synuar të rrisë edhe më tutje vetëdijesimin e shoqërisë sonë për kategoritë të cilat kanë nevojë për përkujdesje të vazhdueshme institucionale.



BANKA EKONOMIKE MIRËPRET FËMIJËT E INSTITUCIONIT PARASHKOLLOR “PËLLUMBAT E PAQES”

Stafi nga Banka Ekonomike, dega në Pejë, ka organizuar një vizitë të veçantë për fëmijët e institucionit parashkollor dhe Pëllumbat e Paqes”.

Gjatë vizitës, fëmijët patën mundësinë e edukimit financiar duke ngritur vetëdijesimin se si të kujdesen për paratë, të mësojnë për shërbimet që Banka ofron, si dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre për menaxhimin e parasë për një të ardhme sa më të ndritur.

Banka Ekonomike është e vendosur të kontribuojë në edukimin financiar të gjeneratave të reja dhe ky aktivitet është vetëm një nga shembujt e angazhimit tonë. Ne jemi të sigurt se kjo eksperiencë e jashtëzakonshme do të lë ndikim të madh në fëmijët e institucionit parashkollor "Pëllumbat e Paqes", duke i ndihmuar ata të mësojnë rëndësinë e menaxhimit të parasë dhe të ndërtojnë baza të forta financiare për të ardhmen e tyre.



ALPINIZËM ME STAFIN NË PARKUN KOMBËTAR TË BLINAJËS

Banka Ekonomike organizoi një eksperiencë të mrekullueshme alpinizmi për stafin e Bankës në Parkun Kombëtar të Blinajës, me guidat e Klubit Alpin Prishtina të cilët i falënderojmë që e bënë këtë aktivitet më të sigurt dhe të këndshëm.

Kjo eksperiencë na dha mundësinë të largoheshim nga rutina e përditshme e zyrës dhe të rikrijonim lidhjen tonë me natyrën dhe ambientin e jashtëm. Kemi përjetuar bukurinë e natyrës së paprekur dhe kemi qenë të frymëzuar nga fuqia e saj dhe ndryshimi që ajo sjell në mendje dhe trup. Ne besojmë se është detyra jonë të mbrojmë dhe të kultivojmë natyrën për brezat e ardhshëm.

Ky udhëtim ishte një përvojë e jashtëzakonshme që do ta mbajmë gjatë në kujtesën tonë dhe do të na sjellë energji të reja dhe motivim për t'i përballuar sfidat e ardhshme.

DITA NDËRKOMBËTARE E FËMIJËVE

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, 1 Qershorit, Banka Ekonomike ofroi aktivitete argëtuese dhe edukative për fëmijët e qytetit tonë.

Aktiviteti ynë përfshiu praninë e maskotave të animuara. Maskotat ishin aty për të krijuar një atmosferë të gëzueshme dhe argëtuese, të cilat përcjellën ndjenjën e magjisë dhe sjellën buzëqeshje në fytyrat e fëmijëve, së bashku me ngjyrosjen e fytyrave si imazhet e tyre të preferuara. Gjithashtu u organizuan një seri lojërash të ndryshme edukative, ku fëmijët patën mundësinë të mësojnë dhe të argëtohen njëkohësisht. Aktiviteti përfshiu edhe sesione vallëzimi për fëmijët, ku ata shprehën kreativitetin e tyre.

Organizimi i këtij aktiviteti tregon përkushtim tonë ndaj komunitetit, si një nga vlerat kryesore të Bankës Ekonomike.



BANKA EKONOMIKE HAP DEGË TË RE NË LAGJEN PEJTON

Banka Ekonomike ka hapur degën e re në qendër të Prishtinës, në lagjen Pejton, rr. "Robert Doll", me një dizajn modern dhe ambient të përshtatshëm. Dega e re është e pajisur me teknologji të avancuar për të ofruar shërbime cilësore dhe të sigurta për të gjithë klientët tanë.

Ne jemi të vendosur të kontribuojmë në zhvillimin ekonomik të vendit dhe të ofrojmë zgjidhje financiare inovative për nevojat e biznesit dhe individëve të komunitetit tonë.

Në degën tonë të re do të gjeni një ekip të përkushtuar profesionistësh bankarë që janë gati për t'i mbështetur planet tuaja dhe për të siguruar që t'i arrini qëllimet tuaja financiare.



BANKA EKONOMIKE DHURON VETURË TË RE PËR ORGANIZATËN “JETIMAT E BALLKANIT”

Banka Ekonomike vazhdon përkushtimin ndaj vlerave të saj të përgjegjësisë sociale dhe solidaritetit, duke dhuruar veturë të re për organizatën humanitare "Jetimat e Ballkanit". Vetura e dhuruar do të shërbejë si mjet transporti për ekipin e organizatës "Jetimat e Ballkanit", që t'i ndihmojë të jenë sa më pranë dhe sa më efikas në shpërndarjen e ndihmës për ata që kanë nevojë për më shumë kujdes dhe dashuri. Organizata "Jetimat e Ballkanit" ka një mision të rëndësishëm dhe të admirueshëm humanitar, që jep një kontribut për të përmirësuar mirëqenien e komunitetit tonë. Banka Ekonomike do të vazhdojë të tregoj kujdesin e nevojshëm për kategoritë shoqërore, duke synuar të rrisë edhe më tutje vetëdijesimin e shoqërisë sonë për kategoritë të cilat kanë nevojë për përkujdesje të vazhdueshme institucionale.



2023

BANKA EKONOMIKE, SPONSOR GJENERAL I FESTIVALIT NDËRKOMBËTAR “PRIZREN FEST”

Banka Ekonomike ka nënshkruar marrëveshje sponsorizimi me festivalin ndërkombëtar të teatrit në ambient të hapur “Prizren Fest”. Festivali do të sjellë bashkë aktorë, regjisorë, dhe të pasionuarit pas artit teator.

Kjo marrëveshje sponsorizimi shënon angazhimin tonë për të zhvilluar kulturën dhe artin në vendin tonë, dhe jemi të lumtur që mund të krijojmë mundësi për publikun të përjetojë performancat e mrekullueshme teatrale të këtij festivali. Në këtë edicion të festivalit ndërkombëtar, i cili do të mbahet nga data 22 deri më 28 korrik, do të ofrohen shfaqje të shumta teatrore nga vende të ndryshme pjesëmarrëse, si: Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Çekia, Bullgaria, Ukraina, Italia, Sllovakia, Greqia dhe Maqedonia e Veriut. Por, përveç këtyre shfaqjeve, festivali do të promovojë edhe trashëgiminë kulturore dhe monumentet e shumta të Prizrenit. Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes, Zëvendës Kryeshefja Hamide Pacolli Gashi theksoi:

“Përgjegjësia shoqërore është një nga vlerat kryesore të Bankës Ekonomike. Jemi krenarë që jemi pjesë e “Prizren Fest” dhe shpresojmë që ky bashkëpunim të sjellë emocion, frymëzim dhe përvoja të jashtëzakonshme për të gjithë ata që do të marrin pjesë. Ju ftojme të bashkoheni me ne në këtë udhëtim të mrekullueshëm të artit teator dhe të eksploronit pasurinë kulturore të Prizrenit”. Ndërsa, drejtori gjeneral i festivalit Shkelzen Vaseli vazhdoi duke thënë: “Si drejtor i festivalit jam i lumtur dhe kam kënaqësinë që në një festival ndërkombëtar të teatrit kemi partneritet tashmë me një bankë vendore me vlera siç është Banka Ekonomike. Uroj që ky bashkëpunim të jetë vetëm fillimi dhe të vazhdojmë ndër vite që së bashku të arrijmë më shumë suksese”.



BANKA EKONOMIKE ZHVENDOS DEGËN NË ISTOG

Banka Ekonomike është e përkushtuar për të qenë pranë jush, ku jeni dhe kur keni nevojë. Me këtë frymë, jemi krenarë të ju njoftojmë se dega jonë në Istog është zhvendosur në një adresë të re dhe më të përshtatshme! Ky hap është një tjetër dëshmi e angazhimit tonë për të përmirësuar dhe zgjeruar shërbimet tona për ju. Ju mirëpresim në degën tonë të re me adresë rr. "Fadil Ferati", nr.26, ku kemi sjellë një ambient të ri dhe modern për të plotësuar çdo nevojë bankare që keni. Ekipi ynë është i gatshëm dhe i entuziazmuar të ju presë në hapësirën tonë të re.



BANKA EKONOMIKE ZHVENDOS DEGËN E FUSHË-KOSOVËS

Në përshtatje me strategjinë tonë për të avancuar infrastrukturën bankare dhe për t'i përbushur nevojat e klientëve tanë, me kënaqësi ju njoftojmë se dega jonë në Fushë-Kosovë tani është zhvendosur në adresë të re. Nëndega e re ndodhet në rrugën "Nënë Tereza", nr. 149, Fushë-Kosovë. Kjo zhvendosje është një hap thelbësor drejt ofrimit të shërbimeve më efikase dhe investimet vazhdojnë të jenë prioritet për të siguruar që të jemi sa më pranë klientëve tanë kudo.



BANKA EKONOMIKE ISHTE PJESËMARRËSE NË “PANAIRIN E PRAKTIKËS KOSOVA JOB” NË BASHKËPUNIM ME BERZH-IN

Panairi u mbajt më 14 nëntor 2023 në Swiss Diamond Hotel. Ne ishim aty për të ju treguar për detajet e aplikimit, trajnimet e specializuara dhe mundësitë e zhvillimit të karrierës që do t'ju ndihmojnë të kuptoni se si të ecni në rrugën drejt suksesit.

Ne jemi të përkushtuar në zhvillimin e talenteve të rinj dhe për të ju ofruar mundësi për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre në një mjedis profesional. Jemi të lumtur që kemi këtë mundësi për të gjetur talentët e rinjë dhe për të ndihmuar në ndërtimin e një rrjeti të forte të praktikantëve për të ardhmen.



BANKA EKONOMIKE MBËSHTET PËR TË TRETIN VIT ME RADHË AKTIVITETIN E LËSHIMIT ME LITAR TË SUPERHERONJVE

Për të tretin vit radhazi, jemi krenarë të mbështesim aktivitetin emocionues të lëshimit me litar të superheronjve në Spitalin e Pediatriisë. Kjo nismë, e organizuar nga Klubi Alpin Prishtina dhe Care for Kosovo Kids, ka një ndikim të jashtëzakonshëm jo vetëm tek fëmijët në repartin e hematologjisë-onkologjisë, por edhe në rritjen e ndërgjegjësimit në shoqëri rreth sfidave me të cilat përballen këta fëmijë. Është një mundësi për të treguar se si solidariteti dhe kujdesi mund të sjellin ndryshime të mëdha.

Kryeshefi Ekzekutiv, Shpend Luzha, në emër të Bankës Ekonomike falënderoi organizatorët dhe theksoi: “Në kuadër të prioriteteve për përgjegjësinë sociale, Banka përsëri ka dhuruar donacion për organizatën Care for Kosovo Kids, i cili do të destinohet për blerje të medikamenteve dhe pajisjeve të nevojshme për Klinikën Pediatrike.

Banka Ekonomike e konsideron të rëndësishme jo vetëm të ofrojë mbështetje financiare, por edhe të sjellë gëzim në jetët e fëmijëve që janë në spital. Për këtë arsye, kemi dhuruar pako dhuratash për fëmijët, të cilat janë shpërndarë gjatë defilimit të superheronjve në klinikë”, theksoi Z. Luzha.



BANKA EKONOMIKE MBËSHTET KONFERENCËN E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Banka Ekonomike, për të dytin vit me radhë, mbështet Konferencën e Sigurisë së Informacionit, e organizuar nga Bsidet Prishtina. Konferenca dyditore e sigurisë së informacionit u mbajt për herë të dytë në Kosovë si pjesë e kornizës së Security Bsidet me seli në Amerikë, me qëllim që të mblidhen entuziastët e sigurisë kibernetike që të shpërndalet dija përmes prezantimeve dhe bashkëbisedimeve. Gjatë konferencës, përveç prezantuesve nga Kosova, pati prezantues edhe nga Amerika, Bishop Fox, Microsoft, SpecterOps si dhe Mandiant etj.

Banka Ekonomike vazhdon t'i kushtojë rëndësi të veçantë sigurisë së informacionit për faktin se bankimi çdo ditë e më shumë gjen shtrirjen në platforma digjitale, përfshirë dhe sigurinë e mbrojtjes së dhënave online, prandaj do të mbesim përkrahës aktiv në aktivitete që i kontribuojnë avancimit të sigurt të digjitalizimit.

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGURIA







Fitim Rexhepaj

Kryeshef Ekzekutiv



Lumbardh Kusari

Zv. Kryeshef Ekzekutiv

MESAZHI NGA MENAXHMENTI EKZEKUTIV

Duke reflektuar mbi arritjet e vitit të kaluar, shpreh mirënjohjen time për përpjekjet bashkëpunuese, përkushtimin dhe mbështetjen e kompanisë mëmë, bordit drejtues dhe të gjithë punonjësve. Ky raport shërben si një dëshmi për përkushtimin tonë, për përmirësimin e shërbimit dhe inovacionin në industrinë e sigurimeve.

Performanca financiare: KS 'Siguria' dha një performancë të mirë financiare në vitin 2023, duke arritur një fitim prej 744 mijë euro. Ky rezultat vë në pah stabilitetin financiar dhe menaxhimin strategjik të kompanisë. Për më tepër, kompania mbajti një rrjedhë pozitive të parave të gatshme gjatë gjithë vitit, duke treguar një shëndet të mirë financiar dhe praktika efektive të menaxhimit të parave të gatshme. Efikasiteti operacional: Një pikë e rëndësishme u arrit me një rritje prej 20 përqind të shitjeve premium, duke treguar efektivitetin e strategjive të shitjes dhe marketingut të KS 'Siguria'. Ristrukturimi i suksesshëm i operacioneve, duke përfshirë delegimin e funksioneve të tilla si BNj, TI, ISO, dhe Marketingu, ka çuar në përmirësimin e efikasitetit dhe në modernizimin e proceseve në të gjithë organizatën. Ky agjilitet operacional e vë KS 'Siguria' në pozicion për rritje dhe inovacion në vazhdim.

Ujëvara e Prevallës - Prizren

Menaxhimi dhe respektimi i rrezikut: Respektimi i kërkesave rregullatore nga KS 'Siguria' mbeti i fortë, ku raportet e kapitalit tejkalojnë pragun rregullator. Konsolidimi i funksioneve të riskut dhe pajtueshmerisë ka rritur mbikëqyrjen dhe qeverisjen, duke siguruar që kompania të operojë brenda kornizave rregullatore. Këto masa jo vetëm që lehtësojnë rreziqet, por edhe forcojnë besimin midis palëve të interesit.

Rritja e tregut dhe strategjia: Pavarësisht sfidave të tregut, KS 'Siguria' rriti pjesën e saj të tregut nga 7.3 përqind në 7.9 përqind nëpërmjet strategjive proaktive të marrjes në sigurim, marketingut dhe iniciativave gjithëpërfshirëse të trajnimit të stafit. Futja e kontratave të reja të risigurimit ka kontribuar në këtë trajektore rritjeje, duke e pozicionuar KS 'Siguria' si një lojtar të sigurt në industrinë e sigurimeve.

Perspektiva e ardhshme: Në rrugën përpara, KS 'Siguria' parashikon një vit rritjeje të qëndrueshme, me një rritje të parashikuar prej 15 përqind të shitjeve. Për të qëndruar konkurruese në një treg që po evoluon në vazhdimësi, kompania synon të ndër marrë një udhëtim transformimi digjital, duke shfrytëzuar teknologjinë për të rritur efikasitetin operacional dhe përvojën e klientit. Kjo metodë largpamëse nënvizon angazhimin e KS 'Siguria' ndaj inovacionit dhe përshatshmërisë.

Si përfundim, i shpreh mirënjohjen time të përzemërt kompanisë mëmë, bordit drejtues dhe punonjësve të KS 'Siguria' për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre të palëkundur gjatë gjithë rrugëtimit transformues të vitit 2023. Përpjekjet tuaja bashkëpunuese dhe angazhimi për përsosmëri kanë qenë të rëndësishme në arritjen e rezultateve pozitive dhe pozicionimin e KS 'Siguria' për suksesin e ardhshëm. Ndërsa nisemi në rrugën përpara, le të qëndrojmë të palëkundur në ndjekjen tonë të inovacionit, rritjes dhe krijimit të vlerës së qëndrueshme, duke siguruar që KS 'Siguria' të vazhdojë të lulëzojë në peizazhin dinamik të industrisë së sigurimeve.

Në emër të Menaxhmetit Ekzekutiv,

Fitim Rexhepaj
Kryeshef Ekzekutiv

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
MË 31 DHJETOR 2023

PASURITË	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	469	393
Depozitat	9,914	11,264
Investimet në letrat me vlerë	5,084	1,959
Të arkëtueshmet nga sigurimet	1,538	1,304
Kostot e shtyra të përvetësimit	532	469
Prona, pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurisë	3,462	3,421
Prona investuese	895	895
Pjesa e risiguruesit në detyrimet e provizioneve teknike	963	1,457
Pasuritë tjera	1,351	1,227
GJITHSEJ PASURITË	24,208	22,389

EKUITETI DHE DETYRIMET

EKUITETI	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Kapitali aksionar	19,503	18,203
Rezerva e rivlerësimit	534	534
Humbjet e akumuluar	-13,604	-14,349
GJITHSEJ EKUITETI	6,433	4,388

PASURITË	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Detyrimet e provizioneve teknike	11,221	11,065
Provizioni për prime të pafituara	5,168	4,835
Detyrim ndaj tatimit në të ardhura	54	-
Detyrimet e Qirasë	445	211
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	887	1,890
GJITHSEJ DETYRIMET	17,775	18,001
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET	24,208	22,389

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 04 Prill 2024 dhe janë nënshkruar në emër të:


Z. Fitim Rexhepaj
Drejtor Gjeneral


Z. Adhurim Kastrati
Drejtor Financiar

PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023


	2023 EUR '000	2022 EUR '000
Primet e shkruara bruto	11,018	9,246
Minus: Primet e bartura tek risiguruesit	-813	-2,649
PRIMET E SHKRUARA NETO	10,206	6,597
Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara	9,914	11,264
Ndryshimi në pjesën e risiguruesëve të rezervës së primit të pafituar	5,084	1,959
PRIMET E FITUARA NETO	9,961	6,037
Të ardhurat financiare neto	229	145
Të ardhura tjera	420	732
GJITHSEJ TË ARDHURAT	10,610	6,915
FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT	858	-2,998
Tatimi në të ardhura	-114	-66
FITIMI/(HUMBJA) PËR VITIN	744	-3,064
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	202
GJITHSEJ FITIMI/(HUMBJA) GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN	744	-2,862

PERFORMANCA E KS SIGURIA


Në linjë me strategjinë e kompanisë dhe rëndësinë e mbështetjes së bizneseve, të cilat janë punëdhënës kryesorë, fokus parësor ka qenë plotësimi i nevojave të tyre si partnerë kryesorë drejt rritjes dhe zhvillimit të përbashkët. Krahas fokusit tonë në biznese, pjesë shumë me rëndësi e përkrahjes mbeten personat fizikë, e ku me qëllim të qasjes sa më të lehtë, kompania ka vijuar me hapje të degëve të reja dhe njëkohësisht modernizim të degëve ekzistuese me qëllim të krijimit të një ambienti sa më komod për ofrim të shërbimeve. Një hap substancial që konfirmon qasjen tonë drejt shërbimit cilësor ndaj klientëve është integrimi i shërbimeve tona në degët e Bankës Ekonomike, ku klientët do të kenë mundësinë për t'u shërbyer me produktet tona brenda këtyre zyrave.

Rritja e primeve përgjatë vitit 2023 në raport me vitin paraprak ka vijuar me një rritje të konsiderueshme në total primesh prej 18 përqind, përderisa tregu në total është rritur për 9.5 përqind. Për të vijuar më tutje dhe dëshmuar përkushtimin tonë drejt nevojave të klientëve dhe kujdesin për shëndetin e tyre, tek produkti i sigurimit shëndetësor kemi rritje prej 30 përqind, përderisa tregu ka rritje prej 6.9 përqind, indikator ky i cili dëshmon shërbimin cilësor dhe besimin e klientëve në kompani. KS 'SIGURIA', përgjatë vitit 2023, në përputhje me strategjinë për rritje të biznesit dhe prezencës në tregun e industrisë së sigurimeve, ka lansuar një mori kampanjash përshëndetin, pronën, bashkëpunimin me partnerë afaristë etj., derisa në kuadër të përgjegjësisë sociale janë organizuar aktivitete të ndryshme për kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe rasteve në nevojë.


Portofoli: Përgjatë vitit 2023, KS 'SIGURIA', në portofolin e saj ka pasur gjithsej 41428 klientë aktivë, ku 57 përqind e tyre i takojnë portofolit të sigurimeve të detyrueshme dhe 43 përqind sigurimeve vullnetare. Portofoli i KS 'SIGURIA' është i risiguruar nga risiguruesit reputabilë, me stabilitet financiar dhe kredibilitet në tregjet e risiguruesve në Evropë.




KS 'SIGURIA' shënoi rritje të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2023 për rreth 1.7 milion euro, apo 18 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak 2022. Referuar primeve të shkruara bruto, KS 'SIGURIA' ka pjesëmarrje në nivelin 7.9 përqind në tregun e sigurimeve për vitin 2023.



Rritja e primeve përgjatë vitit 2023 rezulton kryesisht tek primet motorike MTPL, me 18 përqind realizim më shumë se viti paraparak 2022, ndërsa rritja tek primet vullnetare me 18 përqind më shumë se viti i kaluar 2022. KS 'SIGURIA' shënoi trend të rritjes së pjesëmarrjes në treg, ku nga 6.6 përqind për vitin 2022, primet vullnetare për vitin 2023 e vendosën KS 'SIGURIA' me pjesëmarrje në treg prej 7.2 përqind.



DËMET: KS 'SIGURIA' edhe përgjatë vitit 2023 vazhdoi trendin e njëjtë në përmbushjen e pagesave të dëmeve për palët e zhdëmtuara, apo me një rritje të lehtë prej 3 përqind krahasuar me vitin e kaluar 2022.



KS 'SIGURIA' vazhdon të ketë pjesëmarrje të lartë të dëmeve të paguara në nivelin 8 përqind në gjithsej tregun e sigurimeve për vitin 2023.

DEPARTAMENTI SHITJES DHE MARRJES NË SIGURIM

Kompania jonë mbetet e dedikuar drejtë një transformimi të shpejtë duke synuar të jetë organizate adaptive, me qëllimin primar që të shtojmë më shumë vlerë për klientin tonë duke rritur nivelin e shërbimeve dhe produkteve dhe duke zgjeruar gamën e ofertave digjitale gjithëpërfshirëse, e cila në fund do të përkthehet në një përvojë tëshkëlqyeshme për klientët tanë. Gjatë vitit 2023, kemi arritur të bëjmë progres të konsiderueshëm në këtë drejtim, derisa përmirësimi dhe digjitalizimi i proceseve dhe shërbimeve tona për të qenë sa më konkurrues mbetet një nga shtytësit tanë kryesorë gjatë vitit të ardhshëm.

Viti 2023 për Departamentin e Shitjeve ishte një vit plot arritje, duke shënuar kështu nivelin më të lartë të primeve që nga themelimi i kompanisë. Ky rezultat pozitiv si në vëllim të primeve ashtu dhe në zgjerim të bazës së klientëve vjen si rezultat i procesit të rivitalizimit dhe përpjekjeve të kombinuara për të ofruar tek klientët shërbime dhe produkte konkurruese të një cilësie të lartë. Në linjë me këtë, klientëve tanë si individual ashtu dhe biznesorë iu kemi kushtuar vëmendje dhe rëndësi të veçantë përmes ofertave atraktive, shërbimeve të personalizuar si dhe procesimit të shpejtë të kërkesave të klientëve.

Pavarësisht sfidave në mjedisin makroekonomik për shkak të rritjes së ndjeshme të çmimeve, rritja e primeve tregoi tendenca shumë pozitive në vitin 2023, ku në raport me vitin paraprak u shënuar një rritje prej 18 përqind, rritje kjo e cila u vu re në të gjitha produktet e sigurimeve,

duke riafirmuar pozicionin e KS 'SIGURIA' në tregun e risigurimeve dhe në mbajtjen e një pozicioni të kënaqshëm të pjesëmarrjes në mbarë tregun e sigurimeve në Kosovë. Objektive kryesore e kompanisë mbetet mbështetja e klientëve tanë ndaj nevojave të tyre, e cila do të ndikojë pozitivisht edhe në zhvillimin e vendit. Krahas produkteve që ofrojmë, mbetemi të përkushtuar që të zgjerojmë gamën, e njëkohësisht në kohët bashkohore të investojmë në digjitalizim të shërbimeve dhe produkteve tona.

DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË SHËNDETIT DHE AKSIDENTEVE

Duke qenë se shëndeti është primar, kompania përgjatë vitit 2023 i ka kushtuar rëndësi të veçantë plotësimit të kërkesave të klientëve, të cilat dalin nga sigurimi shëndetësor. Në linjë me këtë dhe strategjinë e kompanisë, në mënyrë që të jemi sa më afër klientëve, përgjatë vitit është lansuar kampanja e sigurimit shëndetësor me tre lloje të pakove me tarifa preferenciale dhe mbulime adekuate. Padyshim që i gjithë fokusi në aspekt të plotësimit të nevojave të klientëve është shënuar me një rritje prej 29.12 përqind, e cila dëshmon dukshëm besimin në rritje të klientëve tanë. Tutje, për të rritur nivelin e kënaqësisë së klientëve tanë, kompania ka vijuar me zgjerimin e bashkëpunimit me disanga spitalet private, proces ky në vazhdimësi dhe në vitet tjera në vijim. Ne jemi fuqimisht të fokusuar për t'i sjellë produktet tona sa më cilësore dhe bashkohore dhe në këtë kontekst përgjatë vitit paraprak janë iniciuar projekte për digjitalizim të shërbimeve, ku pas lansimit të këtyre aplikacioneve klientët do të kenë mundësinë që shërbimet tona t'i marrin online, duke kursyer kohën e tyre.

DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË PRONAVE DHE GARANCIONEVE

Spektori i pronave dhe garancioneve dha një kontribut të palëkundur në rritjen e primit përgjatë vitit 2023. Duke marrë parasysh rëndësinë e bizneseve për ekonominë e Kosovës, në kuptim të gjenerimit të punësimit dhe krijimi të vlerave të reja, K.S. 'SIGURIA', në masë të madhe u përkujdes që këtij target grupi t'i ofrojë shërbime sa me cilësore në kuptim të nevojave të tyre. Në këtë kontekst, në drejtim të ekonomizimit të kohës së tyre, në Degët e Bankës Ekonomike, të gjitha bizneseve iu ofrua mundësia e kryerjes së shërbimeve në strategjinë e "One stop shop". Nëpërmjet këtij veprimi, kompania synon rritjen e nivelit të kënaqësisë së klientëve dhe njëkohësisht rritjen e pjesëmarrjes në nivel tregu me produktin e pronave. Kjo iniciativë e fokusuar rezultoi të jetë e suksesshme pasi që efektet ishin pozitive në kontekst të rritjes së sigurimit të pronave prej 12.58 përqind. Në arritjen e këtyre sukseseve rol të veçantë luajtën edhe kampanjat përgjatë vitit, të cilat kishin në fokus plotësimin e nevojave të klientëve.

DEPARTAMENTI I SIGURIMEVE KASKO

Në kuadër të plotësimit të nevojave të klientëve dhe rritjes së aftësisë konkurruese në treg, gjatë vitit të kaluar kompania tregoi fokus të theksuar tek sigurimet kasko. Në bashkëpunim me Bankën Ekonomike dhe partnerët afaristë u lansuan një mori kampanjash, të cilat treguan rezultate sinjifikante. Me këtë qasje kompania synoi që t'i japë një shtysë tjetër aktiviteteve ekonomike duke mbështetur klientët në sigurimet kasko. Me qëllim të arritjes së objektivave strategjike në kompani, në Departamentin e Shitjeve dhe Dëmeve u shtuan kapacitete njerëzore dhe avancime teknologjike në mënyrë që shërbimet të jenë efikase dhe të rritet niveli i kënaqshmërisë së klientëve. Të gjitha këto aktivitete gjatë vitit padyshim që u dëshmuuan si të suksesshme, ku në raport me vitin paraparak u shënuan një rritje prej 23.51 përqind.

DEPARTAMENTI I SIGURIMIT TË AUTOPËRGJEGJËSISË

Marrë parasysh rëndësinë e produktit të autopërgjegjësisë, mbetet crucial ofrimi i shërbimeve të personalizuar dhe cilësore për këtë produkt. Në linjë me këtë, përgjatë vitit paraparak në kompani është punuar në zgjerimin e rrjetit të shitjes, kështu duke u ofruar qasje klientëve në pikat më të afërta të tyre për sigurimin e mjeteve të tyre motorike. Kjo qasje e kompanisë, njëkohësisht angazhimi drejt rekrutimit të klientëve të rinj individualë dhe biznesorë rezultoi me sukses, ku përgjatë vitit u shënuan një rritje prej 16.58 përqind në raport me rritjen në nivel tregu, ndërsa pjesëmarrje në nivel tregu prej 8.32 përqind në total.

DEPARTAMENTI DËMEVE

Gjatë vitit 2023, kompania ka treguar kujdes të veçantë në përmbushjen e pagesave të dëmeve për palët e zhdëmtuara duke i lehtësuar ata nga kostot e papritura. Në këtë drejtim, fokus primar ka qene definimi i përgjegjësisë brenda departamentit të dëmeve dhe shtimi i kapaciteteve në mënyrë që t'i përgjigjemi në kohë kërkesave të klientëve. Kjo qasje, në fund të vitit rezultoi të jetë shumë e suksesshme duke përmbushur të gjitha nevojat e klientëve, ku në raport me vitin paraparak janë paguar rreth 40 përqind dëme më shumë në numër, ndërsa 3.41 përqind më shumë në vlerë. Kjo padyshim që tregon dedikimin tonë ndaj plotësimit të kërkesave të klientëve. Krahas aktiviteteve të sektorit të dëmeve, departamenti ka qene i fokusuar shumë në avancimin e infrastrukturës teknologjike, e cila do të ndihmojë në rritjen e nivelit të kënaqshmërisë së klientëve dhe njëkohësisht në ekonomizimin e kohës së tyre në rastet e trajtimit të dëmeve.



Liqeni i Breznës - Opojë

MARKETINGU

Viti 2023 ka qenë një periudhë e rëndësishme për Departamentin e Marketingut në KS Siguria. Gjatë këtij viti, kemi asistuar në konsolidimin dhe rikujdesjen (reformësimin) e departamentit të marketingut, duke siguruar që të gjitha strategjitë dhe aktivitetet e marketingut të përshtaten me standardet më të larta të cilësisë dhe profesionalizmit.

Një zhvillim kyç i vitit 2023 ishte caktimi i Departamentit të Marketingut të bankës për të marrë përgjegjësinë edhe për KS 'Siguria'. Ky vendim ka sjellë një harmonizim dhe sinergji të fuqishme midis dy entiteteve, duke mundësuar shfrytëzimin e përvojës dhe resurseve të përbashkëta në dobi të të dyja organizatave.

Një nga arritjet më të rëndësishme të vitit ka qenë krijimi i një brendi të ri për KS Siguria. Nëpërmjet një përkushtimi të vazhdueshëm, kemi arritur të krijojmë një identitet të fuqishëm dhe të dallueshëm për kompaninë tonë. Ky brend i ri është implementuar në të gjitha kanalet e marketingut, duke përfshirë brendimin e degëve, prezantimin e logos së re, dizajnet e posterëve, fletushkave, dhe materialet e tjera promovuese. Ky proces ka fuqizuar jo vetëm një imazh të ri për kompaninë, por edhe një strategji të qartë dhe të qëndrueshme për të ardhmen e marketingut të KS Siguria.

Gjatë vitit 2023, strategjitë dhe fushatat e marketingut kanë rezultuar në një rritje të njohurisë së brendit, një rritje të numrit të klientëve të rinj, si dhe një ndikim pozitiv në nivelin e shitjeve dhe të ardhurave. Ndryshimet e bëra në strategjinë e marketingut dhe brendit kanë përfshirë përdorimin e mediave sociale për të rritur prezencën tonë në internet, organizimin e eventeve

dhe promovimeve lokale për të përforcuar lidhjet me komunitetin, si dhe përmirësimin e përvojës së klientit nëpërmjet inovacioneve në komunikimin dhe shërbimet e ofruara.

Me një angazhim të vazhdueshëm për kualitetin, inovacionin dhe shërbimin ndaj klientit, Departamenti i Marketingut është gati të përballet me sfidat dhe të shfrytëzojë mundësitë për të arritur suksesin në të ardhmen.

MBËSHTETJA PËR SOS FSHATRAT E FËMIJËVE

Gjatë festave të fundvitit, KS SIGURIA bashkëpunoi me fëmijët dhe stafin e SOS Fshatrave të Fëmijëve për të sjellë magjinë e Vitit të Ri, duke dekoruar së bashku Bredhin e Vitit të Ri. Momentet e këndshme të mbushura me këngë e bënë këtë aktivitet një ngjarje të paharueshme për të gjithë. Me sjelljen e dhuratave për fëmijët, kontribuam për të sjellë buzëqeshje dhe gëzim të shtuar në këtë periudhë festive. Festimi i Vitit të Ri është kohë për të ndarë gëzim dhe për të qenë bashkë.



MBËSHËTETJA PËR DOWN SYNDROME KOSOVA

Me një angazhim të palëkundur ndaj përgjegjësisë sociale, Banka Ekonomike dhe Kompania e Sigurimeve Siguria vazhdon të mbështesë Down Syndrome Kosova. Kjo iniciativë është pjesë e angazhimit tonë për të ofruar mbështetje dhe mundësi më të mira për fëmijët me sindromën Down.

Përmes kësaj mbështetjeje, synojmë të ndihmojmë në ndërtimin e një mjedisi më të mirë dhe të mbështesim shërbimet terapeutike që janë të rëndësishme për zhvillimin e tyre.



Përmbajtja	Faqe
Banka Ekonomike Sha - Pasqyrat individuale	81
Grupi Bankar Banka Ekonomike - Pasqyrat e konsoliduara financiare	138
Kompania e Sigurimeve Siguria - Pasqyrat individuale	209

BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat Individuale Financiare të përgatitura në përputhje me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	84
Pasqyra Individuale e Pozicionit Financiar	86
Pasqyra Individuale e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	87
Pasqyra Individuale e Ndryshimeve në Ekuitet	88
Pasqyra Individuale e Rrjedhës së Parasë	89
Shënime për Pasqyrat Individuale Financiare	90-137

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Bankës Ekonomike Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat individuale financiare të Banka Ekonomike Sh.A. ("Banka"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën individuale të rrjedhës së parasë për vitin që përfundon dhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë politikat materiale kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat individuale financiare shoqëruese paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2023, dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Theksimi i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 2(a) të pasqyrave individuale financiare shoqëruese, këto pasqyra individuale financiare janë përgatitur për të ndihmuar Bankën në përmbushjen e kërkesave të Bankës Qendrore të Kosovës për raportim financiar dhe mund të mos jenë të përshtatshme për t'u përdorur për qëllime të përgjithshme, përveç nëse ato lexohen së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Bankës, por nuk përfshijnë pasqyrat individuale financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat individuale financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave individuale financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuar më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat individuale financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave individuale financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave individuale financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Individuale Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat individuale financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra individuale financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu :

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave individuale financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Bankës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël, dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti .
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Bankës. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat individuale financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Banka të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave individuale financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat individuale financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Organizatës, në mes të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë disa mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë .

RSM Kosovo Sh.p.k.

RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

18 Prill 2024


Sadik Berisha

Auditor ligjor

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	54,299	32,388
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	7	74,360	95,201
Kreditë për klientët	8	441,298	379,892
Investime në letra me vlerë	9	10,605	28,225
Investimet në degë	9.1	7,358	6,058
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	10	13,604	13,979
Pasuritë e paprekshme	11	3,860	4,794
Pasuri të tjera	12	2,547	2,529
Gjithsej pasuritë		607,931	563,066
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	13	537,067	505,342
Detyrime ndaj bankave	14	1,487	93
Detyrimi i tatimit në fitim		88	210
Detyrime të tjera	15	3,802	3,549
Detyrimi i shtyer tatimor		600	604
Gjithsej detyrimet		543,044	509,798
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	16	29,422	29,422
Rezerva e rivlerësimit dhe rezervat tjera	16	4,746	4,853
Fitime të mbajtura		30,719	18,993
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		64,887	53,268
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		607,931	563,066

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues i Bankës dhe nënshkruar në emër të tyre më 16 Prill 2024 nga:



 Zt. Shpend Luzha
 Kryeshef Ekzekutiv



 Zt. Berat Isa
 Zyrtar Kryesor Financiar

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	17	30,746	24,579
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	17	(5,450)	(3,251)
Të ardhurat neto nga interesi		25,296	21,328
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	18	4,776	4,358
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	18	(1,201)	(914)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		3,575	3,444
Të ardhurat e tjera operative	19	606	497
Të ardhurat		29,477	25,269
Shpenzimet e personelit	20	(5,067)	(4,548)
Zhvlërësimi dhe amortizimi	10,11	(3,004)	(2,380)
Shpenzime të tjera	21	(8,936)	(6,613)
(Lirimi)/ngarkesa e lejitimit të humbjeve neto në instrumentet financiare	6,7,8,9	1,380	(705)
Humbjet nga zhvlërësimi i pasurive të paprekshme	11	(942)	-
Gjithsej shpenzimet operative		(16,569)	(14,246)
Fitimi para tatimit		12,908	11,023
Tatimi në fitim	22	(1,182)	(1,003)
Fitimi neto për vitin		11,726	10,020
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje</i>			
Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi		-	-
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës		18	18
<i>Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje</i>			
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		(125)	41
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		(107)	59
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		11,619	10,079

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera	Fitimet e mbajtura	Gjithsej ekuiteti dhe rezervat
Me 01 Janar 2022	29,422	4,794	10,973	45,189
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenda e shpërndarë (Shënimi 16)	-	-	(2,000)	(2,000)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	(2,000)	(2,000)
Fitimi për vitin	-	-	10,020	10,020
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	18	-	18
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	41	-	41
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	59	10,020	10,079
Më 31 Dhjetor 2022	29,422	4,853	18,993	53,268
Me 01 Janar 2023	29,422	4,853	18,993	53,268
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenda e shpërndarë (Shënimi 16)	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	11,726	11,726
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>				
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	18	-	18
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	(125)	-	(125)
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(107)	11,726	11,619
Më 31 Dhjetor 2023	29,422	4,746	30,719	64,887

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

	Shëni mi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		12,908	11,023
<i>Ndryshime për:</i>			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	3,004	2,380
(Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në kreditë për klientët	8	(1,375)	668
Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme (Lirimi)/Ngarkesa e provizionit për garancitë dhe letrat me vlerë	11	942	-
Të ardhurat nga interesi	15,9	(78)	146
Shpenzimet e interesit	17	(30,746)	(24,579)
	17	5,450	3,251
		(9,895)	(7,111)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rezerva statutorë me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara		1,951	(5,176)
Kreditë për klientët		(59,385)	(53,135)
Pasuri të tjera		(18)	946
Depozitat nga klientët		30,822	93,208
Detyrime ndaj bankave		1,394	(993)
Detyrime të tjera		85	63
		(35,046)	27,802
Interesi i paguar		(4,469)	(2,160)
Interesi i arkëtuar		30,150	24,772
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(1,308)	(1,050)
Neto rrjedha e parasë e (përdorur në)/gjeneruar nga aktivitetet operative		(10,673)	49,364
Aktivitetet investuese			
Blerja e pronave dhe pajisjeve dhe pasuritë e paprekshme	10,11	(1,474)	(2,486)
Blerjet e letrave me vlerë	9	(8,667)	(23,190)
Shitjet e letrave me vlerë	9	26,111	-
Investimi në degë	9.1	(1,300)	(6,058)
Neto rrjedha e parasë gjeneruar nga/(përdorur në) aktivitetet investuese		14,670	(31,734)
Aktivitetet financiare			
Shlyerja e detyrimit të qirasë	10	(976)	(840)
Dividentët e paguar	16	-	(2,000)
Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet financiare		(976)	(2,840)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		3,021	14,790
Paraja dhe ekuivalentët e saj, në fillim të vitit	6	93,101	78,311
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	6	96,122	93,101

Shënimet shoqëruese nga 1 në 26 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave individuale financiare.

1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a (“Banka”) është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës (“BQK”), Banka ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Banka operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan dhe 22 nëndegë. Banka ka të punësuar 441 punonjës më 31 Dhjetor 2023 (2022: 425).

Në Shtator 2022, Banka përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Kompanisë të Sigurimeve Siguria Sh.a. Më 31 Dhjetor 2022, Banka zotëron 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra individuale financiare përgatiten në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e tyre të adoptuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Këto pasqyra individuale financiare përfaqësojnë rezultatin dhe pozicionin financiar të Bankës dhe nuk përfshijnë atë të filialit të saj (shënimi 9.1). Banka përgatit një grup tjetër pasqyrash financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF. Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur për qëllime ligjore lokale.

(b) Prezantimi i pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime qartësie, pasqyrat individuale financiare dhe shënimet e pasqyrave individuale financiare janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave individuale financiare agregohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare parësore. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime.

(c) Standardet dhe interpretimet e reja ose të ndryshuara të adoptuara nga Banka

Banka ka adoptuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. Adoptimi i këtyre standardeve dhe interpretimi nuk pati ndikim signifikant në pasqyrat financiare individuale të bankave.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 Janar 2023:

- SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Dhënia e Informacioneve Shpjeguese të Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF). Menaxhmenti rishikoi politikat kontabël dhe bëri përditësime të informacionit të shpalosur në shënimin 3 Politikat Materiale Kontabël (2022: Politika të rëndësishme kontabël) në raste të caktuara në përputhje me këtë ndryshim.
- Tatimi i shtyrë në lidhje me Pasuritë dhe Detyrimet që Rrjedhin nga një Transaksion i Vetëm (Ndryshimet në SNK 12)
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(d) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave individuale financiare të Bankës janë shpallur më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë” - Detyrimi i Qirasë në një Shitje dhe Kthim të qirsë - në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024
- Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” - Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata dhe Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Detyrimet afatgjata me Konventa - efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024
- Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Rrjedhës së Parasë” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese” - Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit – të dyja efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- SNRF S1 Kërkesat e Përgjithshme për Shpalljen e Qëndrueshmërisë - Informacioni Financiar i Ndërlidhur, në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- SNRF S2 Climate - Dhënia e informacioneve shpjeguese të ndërlidhura, në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- Ndryshimet në SNK 21 “Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor” - Mungesa e këmbueshmërisë - efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025
- Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta” - Shitja ose Kontributi i Pasurive ndërmjet një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe Ndryshime të Mëtejshme (data e hyrjes në fuqi është shtyrë për një kohë të pacaktuar derisa të përfundojë projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit).

Banka ka zgjedhur të mos miratojë para kohe këto deklarata dhe është në proces të analizimit të ndikimit të adoptimit të këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve në pasqyrat individuale financiare të Bankës në periudhën e aplikimit fillestar.

(e) Baza e kontabilitetit

Pasqyrat individuale financiare janë përgatitur duke përdorur parimin e vazhdimësisë dhe sipas konventës së kostos historike, me përjashtim të pasurive financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit të mbajtura për mbledhje dhe shitje dhe klasa të caktuara të pronave, impianteve dhe pajisjeve

(f) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat individuale financiare përgatiten mbi bazën e vijmësisë, pasi Drejtorët janë të kënaqur që banka ka burime për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë parashikimet e ardhshme të përfitimit, flukset monetare, kërkesat për kapital dhe burimet kapitale. Këto konsiderata përfshijnë skenarë të theksuar. Ata gjithashtu morën parasysh rreziqe të tjera kryesore, si dhe nga ndikimet e lidhura me përfitimin, kapitalin dhe likuiditetin.

(g) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra individuale financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Bankës. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç ku shprehet ndryshe.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(h) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimi

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave individuale financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Bankës dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 25.

3. Politikat e materiale kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra individuale financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

Për më tepër, Banka miratoi Dhënien e Informacioneve Shpjeguese të Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) që nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale' sesa 'të rëndësishme'. Megjithëse ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël, ato ndikuan në informacionin e politikës kontabël në lidhje me instrumentet financiare të shpalosura në shënimin 3 në raste të caktuara (shih shënimin 2(c) për informacion të mëtejshëm).

(a) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare, duke përjashtuar ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim, njihen në 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi mbi pasuritë financiare të zhvlerësuara nga kredia njihet duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (d.m.th., vlerën kontabël bruto të aktivitetit minus provizionin për 'ECL').

Për pasuritë financiare të blera ose të origjinës të dëmtuara nga kredia ('POCI'), Banka llogarit të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI të rregulluar nga kredia dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e rregulluar nga kredia është norma e interesit që, në njohjen fillestare, skonton flukset e ardhshme monetare të vlerësuara (përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të pasurive POCl.

(b) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit (shënimi (3a)).

Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, shitjet nga komisioni dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(c) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit .

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjrisht për të kompensuar detyrimet dhe pasuritë tatimore afatshkurtera dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor.

Taksat shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendëve nga Banka njihen në të njëjtën kohë me njohjen e detyrimit për të paguar dividendin përkatës .

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Banka merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

(d) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet e shprehura në valutë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, përveç aktiveve dhe detyrimeve jomonetare të matura me koston historike, të cilat përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën fillestare të transaksionit.

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë, investimet e mbajtura deri në maturitet dhe të vlefshme për shitje, depozitat dhe huamarrjet dhe borxhet e varura në datën që ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e pasurive financiare njihen në datën e tregtimit në të cilën Banka angazhohet për të blerë ose shitur aktivin. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit, e cila është data kur Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDNFH. Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja këto kushte dhe është nuk është caktuar si në VDNFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar .

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(ii) Klasifikimi (vazhdim)

Pasuritë financiare (vazhdim)

Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH :

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, objektivi i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Banka mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Këto zgjedhje bëhen në bazë të investim pas investimi.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose në VDATGJ.

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare .

Detyrimet financiare

Banka klasifikon detyrimet e saj financiare matur me koston e amortizuar.

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Banka çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjen e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Banka as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes transferohet në pasuri financiare që kualifikohen për mosnjohje që krijohen ose mbahen nga Banka njihen si një pasuri ose detyrim i veçantë.

Detyrimet financiare

Banka ç' regjistron një pasuri financiare kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose mbarojnë.

(iv) Ndryshimet e pasurive financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Banka vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të pasurisë të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse flukset e mjeteve monetare janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në flukset e mjeteve monetare nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale çregjistrohen dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Nëse rrjedhat e parasë të pasurisë të modifikuar të mbartur me koston e amortizuar nuk janë në thelb të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në çregjistrimin e pasurisë financiare. Në këtë rast, Banka rikalkulon vlerën kontabël bruto të pasurisë financiare dhe njeh shumën që vjen nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje modifikimi në fitim ose humbje. Nëse një ndryshim i tillë kryhet për shkak të vështirësive financiare të huamarrësit, atëherë fitimi ose humbja paraqitet së bashku me humbjet nga zhvlerësimi. Në raste të tjera, ajo paraqitet si e ardhura nga interesi.

(v) Netimi

Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare netohen reciprokisht dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiare kur, dhe vetëm kur, Banka ka të drejtë ligjore për të kompensuar shumat dhe synon ose t'i shlyejë ato në bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe ta shlyejë detyrimin njëkohësisht.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vii) Matja e vlerës së drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi që do të merret për të shitur një pasuri ose për të paguar transferimin e një detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principalin ose në mungesë të saj tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës .

Kur është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në treg aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin.

Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - përshembull vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Banka vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri ose detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme mbi jetën e instrumentit, por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet. Nëse një pasuri ose një detyrim i matur me vlerën e drejtë ka një çmim të ofertës dhe një çmim të kërkesës, atëherë Banka mat pasuritë dhe pozicionet afatgjata me një çmim të ofertës dhe detyrimet dhe pozicionet afatshkurtra me një çmim të kërkesës.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur do të kërkohej pagesa e depozitës .

Banka njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ky ndryshim ka ndodhur .

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Banka njih humbjet e lejimeve për HPK për instrumentet financiare të mëposhtme që nuk janë matur në VDNFH:

- kreditë për klientët;
- pasuritë tjera financiare me kosto të amortizuar;
- pasuritë financiare që janë instrumente borxhi; dhe
- zotimete e huasë dhe kontratat e garancisë financiare të lëshuara (më parë, zhvlerësimi është matur nën SNK 37 Provizionet, Detyrimet Kontingjente dhe Pasuritë Kontingjente).

Banka do të njohë lejimet e humbjeve në një shumë të barabartë me Jetëgjatësinë HPK, përveç rasteve të mëposhtme, për të cilat shuma e njohur do të jetë HPK 12-mujore :

- letrat me vlerë të investimit të borxhit që përcaktohen të kenë rrezik të ulët të kredisë në datën e raportimit. Banka e konsideron një siguri borxhi të ketë rrezik të ulët të kreditit kur vlerësimi i rrezikut të tij të kredisë është i barabartë me përkufizimin e kuptimit global të 'klasës së investimit'; dhe
- kreditë dhe letrat me vlerë të investimit të borxhit për të cilat rreziku i kredisë nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare .

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Matje e HPK

HPK të janë një vlerësim i ponderuar me probabilitet i humbjeve të kredisë dhe do të matet si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të dëmtuara me kredi në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha mangësive në të holla - dmth. Diferenca midis flukseve të mjeteve monetare që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të dëmtuara nga kreditë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme të vlerësuara ;
- zotimet e huazuara: vlera aktuale e diferencës midis flukseve monetare kontraktuale që i detyrohen Bankës nëse tërheqja e zotimit dhe flukset e mjeteve monetare që Banka pret të marrë; dhe
- kontratat e garancisë financiare: vlera aktuale e pagesave të pritshme për të rimbursuar mbajtësin minus shumat që Banka pret të mbulojë .

Përkufizimi i dështimit

Sipas SNRF 9, Banka do të konsiderojë një pasuri financiare të dështuar kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e saj të kredisë në Bankë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Bankës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie për Bankën.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose të humbura.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në dështim, Banka do të konsiderojë tregues që janë në përputhje me kërkesat rregullatore të rrezikut për klasifikimin e huave si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e marrëveshjes kontraktuale;
- sasiorë: p.sh. statusi i vonuar dhe mospagesa e një detyrimi tjetër të huamarrësit të njëjtë në Bankë; dhe
- klasifikimi i rrezikut rregullator të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera.

Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në dështim dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet në rrethanat .

Nivelet e rrezikut të kredisë

Banka cakton çdo ekspozim në një klasë të rrezikut të kredisë bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë rrezikun e mosplotësimit. Krahas klasave të rrezikut të prezantuara për qëllime rregullative, Banka identifikon dhe monitoron veçmas huatë standarde në të kaluarën nga kreditë standarde jo në të kaluarën.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të rrezikut të kredisë për njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do t'i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, gjë që mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë të rrezikut të kredisë.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Përcaktimi nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë (dmth. rreziku i dështimit) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Banka do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe mbështetëse që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informacion cilësor dhe analiza bazuar në përvojën historike të Bankës, vlerësimin e kredive të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm.

Banka do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e rrezikut rregullator nga standardi për tu shikuar në përputhje me politikën e Bankës për klasifikimin e rrezikut rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë klasifikohen në Fazën 2.

Si një ndihmesë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Banka me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e rrezikut të kredisë ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë vonesë. Banka do të përcaktojë ditët në vonesë duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme e vonuar për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Banka monitoron efektivitetin e kritereve të përdorura për të identifikuar rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar atë:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritjet e ndjeshme në rrezikun e kredisë para se një ekspozim të jetë në mungesë ;
- koha mesatare e identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë dhe mospagimit duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet përgjithësisht nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja e HPK-së 12-mujore në kreditë e zhvlerësuara.

Mjetet financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të tanishëm ose potencial të kredisë të klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuara, mund të çregjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare ndryshohen dhe modifikimi nuk rezulton në çregjistrim, Banka do të shqyrtojë nëse rreziku i kredisë së pasurisë është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në rrezikun e mosplotësimit.

Banka rinegocion kredi për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitetet e ristrukturimeve) për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar rrezikun e mospagimit. Sipas politikës së ristrukturimeve së bankës, lëkundja e huasë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në mospagim të borxhit të tij ose nëse ka një rrezik të lartë të mospagimit, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kontratës fillestare kushtet dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Termet e rishikuar zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të besëlidhjeve të huasë. Të dy kreditë me pakicë dhe biznesi janë subjekt i politikës së durimit.

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i dështimit dhe zhvlerësimit të kredisë dhe pritet e ristrukturimeve janë relevante për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të kredisë.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave në mënyrë të qëndrueshme gjatë tetë muajve para se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK 12-mujore.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Inputet në matjen e HPK

Inputet kryesore në matjen e HPK është e mundur të jenë struktura e termave të variablave në vijim:

- probabiliteti i dështimit (PD)
- humbja e dhënë nga dështimi (HDHD), dhe
- ekspozimi ndaj dështimit (END).

Këta parametra rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. PD-të janë rregulluar për të pasqyruar informacionin largpamës, siç përcaktohet më poshtë.

Nivelet e rrezikut të kredisë do të jenë një input primar në përcaktimin e strukturës së afateve të PD për ekspozimet. Banka do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD të jetës së mbetur të ekspozimeve dhe si këto pritjet të ndryshojnë si rezultat i kalimit të kohës.

Kjo analizë përfshin identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve midis ndryshimeve në normat e mospagimit dhe ndryshimeve në faktorët makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvoja e ristrukturimeve) mbi rrezikun e mospagimit. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë kanë të ngjarë të përfshijnë normat e papunësisë dhe inflacionin e çmimeve të konsumit. Qasja e Bankës për përfshirjen e informacionit largpamës në këtë vlerësim diskutohet më poshtë.

HDHD është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka një dështim. Banka do të vlerësojë parametrat HDHD bazuar në historinë e normave të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve të kundërta. Modelet HDHD do të konsiderojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rimëkëmbjes të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e aktivitetit financiar. Për kreditë e siguruar nga prona me pakicë, raportet e kredisë për vlerën (RKV) ka gjasa të jenë një parametër kyç në përcaktimin e HDHD.

Vlerësimet HDHD do të kalibrohen për faktore të jashtëm të ndryshëm, si për huadhënien e pasurive të paluajtshme, të pasqyrojnë ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten në bazë të fluksit të mjeteve monetare të skontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor zbritës.

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një dështimi. Banka do të nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. END i një aktiviteti financiar do të jetë vlera kontabël bruto në mungesë. Për angazhimet e kreditimit dhe garancitë financiare, END do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të nxirren ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrotimet historike.

Banka do të matë HPK-në duke marrë në konsideratë rrezikun e mosplotësimit për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë, edhe nëse për qëllime të administrimit të rrezikut Banka konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Banka ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të ndërpresë një angazhim ose garanci kredie.

Për mbritërheqjet me pakicë dhe pajisjet e kredit kartelës dhe disa struktura rrotulluese korporative që përfshijnë të dyja një hua dhe një përbërës të zotimit të padeklaruar, Banka do të matë HPK-në për një periudhë më të gjatë se periudha maksimale kontraktuale, nëse aftësia kontraktuale e Bankës për të kërkuar shlyerjen dhe anulimin e angazhimit të paditur nuk e kufizon ekspozimin e Bankës ndaj humbjeve të kreditit në periudhën e njoftimit kontraktual. Këto objekte nuk kanë një afat të caktuar ose strukturë të ripagimit dhe menaxhohen në baza kolektive. Banka mund t'i anulojë ato me efekt të menjëhershëm, por kjo e drejtë kontraktuale nuk zbatohet në menaxhimin normal të përditshëm, por vetëm kur Banka vihet në dijeni për një rritje të rrezikut të kredisë në nivel kredie. Kjo periudhë më e gjatë do të vlerësohet duke marrë parasysh veprimet e menaxhimit të rrezikut të kredisë që Banka pret të ndër marrë dhe që shërbejnë për të zbutur HPK-të. Këto përfshijnë reduktimin e kufijve dhe anulimin e objektit.

3. Politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Kur modelimi i një parametri kryhet në baza kolektive, instrumentet financiare do të njihen në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut që përfshijnë:

- llojet e intrumenteve; dhe
- klasifikimi i rrezikut të kredisë.

Njohja do t'i nënshtrohet rishikimit të rregullt për të siguruar që ekspozimet brenda një banke të veçantë të mbeten në mënyrë të përshtatshme homogjene.

Për investimet në letrat me vlerë të borxhit në lidhje me të cilat Banka ka të dhëna të kufizuara historike, informacion i jashtëm i referencës i publikuar nga agjencitë e njohura të vlerësimit të jashtëm të kreditit siç është Moody's do të përdoret për të plotësuar të dhënat në dispozicion brenda vendit.

Informacione me vështrim të mëtejshëm

Lejimet e humbjeve për HPK është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

Sipas SNRF 9, Banka ka përfshirë informacione me vështrim të mëtejshëm në vlerësimin e saj nëse rreziku i kredisë i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e saj e HPK-ve. Banka formulon një pamje të 'rastit bazë' të drejtimit të ardhshëm të variablave përkatës ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat nga Komiteti i Riskut të Bankës dhe ekspertët ekonomikë dhe duke marrë në konsideratë një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe të parashikuara. Ky proces përfshin zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe marrjen në konsideratë të probabiliteteve relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendin ku operon Banka, organizatat mbikombëtare si Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, si dhe parashikues të përzgjedhur të sektorit privat dhe akademik. Rasti bazë përfaqëson një rezultat më të mundshëm dhe që përafrohet me informacionin e përdorur nga Banka për qëllime të tjera, si planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë paraqesin rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Banka gjithashtu kryen periodikisht teknikën analitike "testin e stresit" të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e saj të këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues. Banka ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë për çdo portofol të instrumenteve financiare dhe, duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet midis variablave makroekonomike dhe rrezikut të kredisë dhe humbjeve të kredisë. Këta shtytës kryesorë përfshijnë normat e papunësisë dhe parashikimet e inflacionit të çmimeve të konsumit. Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe normave të dështimit dhe humbjes në portofolet e ndryshme të pasurive financiare janë zhvilluar bazuar në analizimin e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

Paraqitja e lejimeve për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet e humbjeve për HPK është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si një zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancisë financiare: në përgjithësi, si një provizion;
- kur një instrument financiar përfshin si një komponent të tërhequr dhe një të papërcaktuar, dhe Banka nuk mund të identifikojë HPK në komponentin e angazhimit të huasë veças nga ato në përbërësin e tërhequr: Banka paraqet një kompensim të humbjes së kombinuar për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e përbërësit të tërhequr. Çdo tejkallim i lejimit të humbjes mbi shumën bruto të komponentit të tërhequr paraqitet si një provizion; dhe'
- instrumentet e matura në VDATGJ: asnjë lejim nuk njihet në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera neto e këtyre pasurive është vlera e tyre e drejtë. Sidoqoftë, lejimi është i shpalosur dhe i njohur në rezervën e rivlerësimit.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(e) Pasuritë financiare dhe detyrimet (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit (vazhdim)

Vlerësimi i kolateralit

Për të zbutur rreziqet e saj të kredisë mbi pasuritë financiare, Banka përdorë kolateralin si mjet për zbutjen e rrezikut, aty kur është e mundur. Kolaterali vjen në forma të ndryshme; para në dorë, hipotekë dhe marrëveshje pengu të levizeshem. Kolaterali, përveç rasteve kur riposedohet, nuk regjistrohet në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Megjithatë, vlera e drejtë e kolateralit ndikon në llogaritjen e ECL. Në përgjithësi, ai vlerësohet, minimalisht, në fillim dhe rivlerësohet në baza periodike. Megjithatë, disa forma të kolateralit, për shembull, parja në dorë, vlerësohen çdo ditë. Për atë që është e mundur, Banka përdor të dhëna aktive të tregut për vlerësimin e aktiveve financiare, të mbajtura si kolateral. Kolaterali jo-financiar, si pasuritë e paluajtshme, vlerësohet bazuar në të dhënat e ofruara nga palë të treta si agjentët e licencuar për vlerësimin e patundshmerise, indekset e çmimeve të banesave, pasqyrat financiare të audituara dhe burime të tjera të pavarura.

Shlyerjet

Kreditë dhe letrat me vlerë të borxhit shlyhen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit. Kjo zakonisht ndodh kur Banka përcakton se huamarrësi nuk ka asete ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë flukse të mjaftueshme të mjeteve monetare për të shlyer shumat që i nënshtrohen heqjes. Megjithatë, asetet financiare që janë shlyer mund të jenë ende subjekt i veprimeve përmbarimore në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Bankës për mbulimin e shumave të duhura.

(f) Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë shënimet dhe monedhat në dorë, bilancet e pakufizuara të mbajtura me bankat qendrore dhe asetet financiare shumë likuide me maturitet fillestare prej tre muajsh ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë të përdorura nga Banka në menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

(g) Investimet në letrat me vlerë

Titulli "investimet në letra me vlerë" në pasqyrën e pozicionit financiar përfshin letrat me vlerë të borxhit të matura në koston e amortizuar dhe në VDATGJ.

Për letrat me vlerë të borxhit të matur në VDATGJ, fitimet dhe humbjet njihen në ATGJ, përveç sa vijon, të cilat njihen në fitim ose humbje në të njëjtën mënyrë si për pasuritë financiare të matura me kosto të amortizuar.

Kur siguria e borxhit të matur në VDATGJ çregjistrohet, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në ATGJ është riklasifikuar nga kapitali neto në fitim ose humbje.

(h) Depozitat, borxhi i varur dhe detyrimet tjera

Depozitat, borxhet e varura dhe detyrimet e tjera maten fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(i) Prona dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga dëmtimet.

(ii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje në bazë lineare përgjatë jetës së dobishme të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe krahasuese është si vijon:

	Jetëgjatësia 2023	Jetëgjatësia 2022
Ndërtesa	40 vite	40 vite
Kompjutera dhe pajisje të lidhura me to	5 vite	5 vite
Automjete	5 vite	5 vite
Instalime, mobilje dhe pajisje	5 vite	5 vite

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(i) Prona dhe pajisje (vazhdim)

(ii) Zhvlerësimi (vazhdim)

Përmirësimet e qirasë së tokës zhvlerësohen duke përdorur bazën lineare gjatë periudhës më të shkurtër të qirasë dhe jetëve të tyre të dobishme.

Toka dhe ndërtesa

Toka dhe ndërtesa e zyrave qendrore tregohen me vlerën e drejtë, periodikisht, vlerësime nga vlerësues të jashtëm të pavarur, minus amortizimin dhe dëmtimin e ndërtesave. Vlerësimet ndërmerren më shpesh nëse ka një ndryshim material në vlerën e drejtë në raport me vlerën kontabël.

(j) Prona dhe pajisje me qira

Banka njih një pasuri me të drejtë përdorimi dhe një detyrim qiraje në datën e fillimit të qirasë. Pasuria me të drejtë të përdorimit fillimisht matet me koston, e cila përfshin shumën fillestare të detyrimit të qirasë të rregulluar për çdo pagesë të qirasë të bërë në ose përpara datës së fillimit, plus çdo kosto fillestare direkte të shkaktuar dhe një vlerësim të kostove për çmontimin dhe heqjen e pasurisë bazë ose për të rivendosur pasurinë bazë ose vendin ku ai ndodhet, minus çdo stimuj qiraje të marrë.

Pasuria me të drejtë të përdorimit amortizohet duke përdorur metodën lineare nga data e fillimit deri në fundin e jetës së dobishme të pasurisë me të drejtë përdorimi ose në fund të afatit të qirasë. Jeta e dobishme e vlerësuar e pasurive të së drejtës së përdorimit përcaktohet në të njëjtën bazë me ato të pronës dhe pajisjeve. Për më tepër, pasuria me të drejtë të përdorimit zvogëlohet periodikisht nga humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka, dhe rregullohet për disa matje të pasivit të qirasë.

Detyrimi i qirasë matet fillimisht me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk janë paguar në datën e fillimit, të skontuar duke përdorur normën e interesit rritëse në qira.

Detyrimi i qirasë rimatet kur ka një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rrjedhin nga një ndryshim në një indeks ose normë, nëse ka një ndryshim në vlerësimin e Bankës për shumën që pritet të paguhet sipas një garancie të vlerës së mbetur, ose nëse Banka ndryshon vlerësimi nëse do të ushtrojë një opsion blerjeje, vazhdimi ose përfundimi.

Kur rimatet në këtë mënyrë, bëhet një rregullim përkatës në vlerën kontabël të pasurisë me të drejtë përdorimi, ose regjistrohet në fitim ose humbje nëse vlera kontabël e pasurisë me të drejtë përdorimi është zvogëluar në zero.

Mesatarja e ponderuar e normës rritëse së huamarrjes e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 më 31 Dhjetor 2023 ishte 3.05%.

Banka përdor një ose më shumë nga përdoruesit praktikë të mëposhtëm sipas SNRF 16.C10, duke e aplikuar atë në bazë të qirasë:

- Përdorimi i një norme të vetme zbritje në një portofol të qirave me karakteristika të ngjashme;
- Rregullimi i pasurisë me të drejtë përdorimi për çdo provizion të njohur të qirasë, në vend të kryerjes së rishikimit të zhvlerësimit;
- Aplikimi i një lirimi nga njohja për qiratë për të cilat afati i qirasë përfundon brenda 12 muajve nga data e aplikimit fillestar dhe qiratë e pasurive me vlerë të ulët (Për këtë qëllim banka ka zgjedhur një prag prej rreth 5,000 euro). Banka njih pagesat e qirasë që lidhen me këto qira si një shpenzim në bazë lineare për periudhën e qirasë;
- Duke përjashtuar koston fillestare direkte nga matja e pasurisë me të drejtë përdorimi;
- Përdorimi i mbikëqyrjes, siç është përcaktimi i afatit të qirasë nëse kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Në fillim ose në rivlerësimin e një kontrate që përmban një komponent qiraje, Banka shpërndan konsideratën në kontratë për secilin përbërës të qirasë në bazë të çmimeve të tyre relative të pavarura. Megjithatë, për qiratë e tokës dhe ndërtesave në të cilat ajo është qiramarrëse, Banka ka zgjedhur të mos ndajë përbërësit jo-qira dhe të llogarisë komponentët e qirasë dhe ato joqira si një komponent i vetëm i qirasë.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(k) Pasuritë e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga Banka janë matur me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Shpenzimet pasuese mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në asetin specifik me të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së dobishme të aktivitetit, që nga data që është të vlefshme për përdorim.

Programi kompjuterik amortizohet duke përdorur metodën lineare gjatë jetës së dobishme prej pesë vjetësh. Metodatat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi dhe rregullohen nëse është e përshtatshme.

Hulumtimi dhe zhvillimi

Kostot e kërkimit dhe zhvillimit të kërkimit shpenzohen në periudhën në të cilën ato ndodhin. Kostot e zhvillimit kapitalizohen kur është e mundur që projekti të jetë i suksesshëm duke marrë parasysh fizibilitetin e tij komercial dhe teknik; Banka ka synime dhe burime të mjaftueshme për të përfunduar zhvillimin; dhe kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme. Kostot e kapitalizuara të zhvillimit amortizohen në bazë lineare gjatë periudhës së pritshme të fitimit, duke qenë jeta e tyre e kufizuar.

(l) Pasuri e riposeduar

Pasuritë e riposeduara fitohen nëpërmjet zbatimit të garancisë mbi kreditë jo-performuese për klientët dhe janë të destinuara për nxjerrjen jashtë përdorimi brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Pasuritë e riposeduara fillimisht njihen duke përdorur shumën e grupit përmbartimor në ankandin e fundit dhe më pas maten me vlerën më të ulët të koston dhe vlerës neto të realizueshme dhe çdo zhvlerësim njihet në fitim ose humbje kur ndodhin.

Fitimet ose humbjet nga shitja e këtyre pasurive njihen në fitim ose humbje.

(m) Rënia në vlerë e pasurive jo financiare

Vlera kontabël e pasurive jo-financiare të Bankës, përveç pasurive tatimore të shtyera, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e pasurisë. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare të saj e tejkalon shumën e saj të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të parasë është më e madhja nga vlera e tij në përdorim dhe vlera e drejtë minus kostoja për shitje. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e të hollave të ardhshme të parasë janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë aktualizimi para taksave që reflektojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për pasurinë.

Humbjet nga rënia në vlerë janë njohur në fitim apo humbje. Humbja nga rënia në vlerë kthehet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, nëqoftëse nuk është njohur humbja nga zhvlerësimi.

(n) Provizionet

Një provizion njihet nëse si pasojë e një ngjarje të mëparshme, Banka ka një obligim ligjor aktual apo konstruktiv që mund të vlerësohet me saktësi dhe ka mundësi që një dalje e të mirave materiale do të kërkohet për të shlyer obligimin. Provizionet përcaktohen duke aktualizuar flukset e ardhshme të pritura të pasurive monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën e parasë në kohë dhe sipas rastit, me rreziqet specifike të detyrimit. Efekti i aktualizimit njihet si kosto financiare.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(o) Përfitimet e punonjësve

(i) Planet e përcaktuara të kontributeve

Detyrimet për kontributet në planet e përcaktuara të kontributeve njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Banka paguan vetëm kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme që ofrojnë përfitime në formë të pensioneve për punonjësit me rastin e pensionimit. Autoritetet vendase janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pensione.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punëtorëve maten mbi një bazë të paskontuar dhe njihen si shpenzime në momentin e ofrimit të shërbimit. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet sipas një bonusi afatshkurtër në të holla ose sipas planit për ndarjen e fitimit nëse Banka ka një detyrim ligjor aktual ose konstruktiv për të paguar këtë vlerë si rezultat i shërbimeve në të kaluarën të ofruara nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me saktësi.

(p) Garancitë financiare dhe angazhimet për hua

Garancitë financiare janë kontrata që e detyrojnë Bankën që të bëjë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për një humbje që lind kur një debitor specifik nuk paguan në afat sipas termave të një instrumenti huadhënës. Angazhimet për hua janë angazhimet e përcaktuara për të siguruar kredi sipas termave dhe kushteve të paracaktuara. Angazhime të tilla financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar, nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

Garancitë financiare të lëshuara ose zotimet për të siguruar një kredi me një normë interesi nën nivelin e tregut fillimisht maten me vlerën e drejtë dhe vlera e drejtë fillestare amortizohet gjatë jetës së garancionit ose angazhimit. Më pas, ato maten me më të lartën e kësaj shume të amortizuar dhe shumës së provizionit të humbjes.

Banka nuk ka dhënë asnjë zotim të kredisë që matet në VDNFH.

Për angazhimet e tjera të kredisë, Banka njeh kompensimin e humbjes.

Vlera nominale kontraktuale e garancive financiare dhe e angazhimeve të huave të patërhequra nuk regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlerat nominale të këtyre instrumenteve janë shpalosur në shënimin 23 dhe provizionet korresponduese të humbjeve janë paraqitur në shënimin 15.

(q) Dividentët

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen në kapital në periudhën në të cilën ato janë miratuar nga aksionarët e bankës. Dividendët për vitin që janë deklaruar pas datës së raportimit janë paraqitur si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.

(r) Investimet në filiale

Një kompani filiale është ajo në të cilën Banka ka një investim afatgjatë dhe mbi të cilën ajo ushtron kontroll, duke përfshirë qeverisjen e politikave të saj financiare dhe operative. Investimet në filial në këto pasqyra financiare të veçanta mbahen me kosto.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti diskuton me Komitetin e Auditimit dhe Bordin e Drejtorëve zhvillimin, përzgjedhjen dhe zbulimin e politikave kritike të kontabël të Bankës dhe zbatimin e tyre, si dhe supozimet e bëra në lidhje me pasiguritë kryesore të vlerësimit. Informacioni në lidhje me supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material brenda vitit të ardhshëm financiar dhe rreth gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumatat e njohura në pasqyrat individuale financiare, janë shpalosur më poshtë.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi menaxhimin e rrezikut financiar (shih shënimin 25).

(a) Zhvlerësimi

Pasuritë e llogaritura me kosto të amortizuara vlerësohen për zhvlerësim në bazë të politikave të kontabilitetit të përshkruara në 3 (e)(viii).

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin në baza të tremujore.

Vlera kontabël dhe neto e pasurive financiare më 31 Dhjetor 2023, është paraqitur më poshtë:

Pasuritë financiare	Vlera kontabël	Rënia në vlerë	Vlera neto
Kreditë ndaj klientëve	451,567	(10,269)	441,298
Investimet në letrat me vlerë në VDATGJ	10,608	(3)	10,605

(b) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të pasurisë dhe detyrimeve financiare për të cilat nuk ka asnjë çmim tregu kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në shënimin 3(e)(vii).

Banka vlerëson vlerën e drejtë duke shfrytëzuar hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmim i kuotuar i tregut në tregje aktive për instrumentet identike.
- Niveli 2: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të vlerësueshme. Kjo kategori përfshin instrumentet e vlerësuara duke shfrytëzuar: çmimet e tregut për instrumente të ngjashme apo identike në tregjet të cilat konsiderohen më pak se aktive; apo teknika tjera të vlerësimit në të cilat të gjithë faktorët material në mënyrë direkte apo indirekte janë të vëzhgueshëm nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Metodë vlerësimi bazuar në inpute të rëndësishme të pa vëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet për të cilat teknikat e vlerësimit përfshijnë faktorë që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe faktorët e pavëzhgueshëm kanë një ndikim material në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumentet që janë vlerësuar në bazë të çmimeve të tregut për instrumente të ngjashme për të cilat rregullime apo gjykime materiale të pavëzhgueshme kërkohen për të reflektuar dallimet në mes të instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës së drejtë është shpalosur në shënimin 5.

5. Paraqitja dhe përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerave reale bazohen në instrumente financiare ekzistuese në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës pa u përpjekur për të vlerësuar vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e pasurive dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare.

Instrumentet financiare të matura me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare të matura me vlerën e drejtë dhe analizën e tyre sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar. Vlerat janë bazuar në vlerat e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar.

Vlera e drejtë e investimeve në letra me vlerë është e bazuar në çmimet e tregut ose kuotimet broker / dealer të çmimeve. Kur ky informacion nuk është i disponueshëm, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të flukseve monetare të bazuara në një kurbë aktuale të të ardhurave të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Investimet në letrat me vlerë	Vlera Kontabël	Vlera e drejtë Niveli 1	Vlera e drejtë Niveli 2	Vlera e drejtë Niveli 3
31 Dhjetor 2023	10,605	-	10,605	-
31 Dhjetor 2022	28,225	-	28,225	-

Letrat me vlerë të investimeve të matura në FVOCI sipas 31 December 2023 përfshijnë obligacionet e lëshuara nga Qeveria e Kosovës dhe (2022: Obligacionet e lëshuara nga Qeveria e Kosovës) të cilat blihen ose për t'u shitur ose do të mbahen deri në maturim në varësi të nevojave të likuiditetit të bankës. Në si bankë në portofolin tonë të investimeve financiare kemi Obligacione të Thesarit duke filluar nga maturimi tre vjet deri në katër vjet të shprehura në euro.

Instrumentet jo-financiare të matura me vlerën e drejtë-hierarki e vlerës së drejtë

Toka dhe Ndërtesa

Baza e vlerësimit të tokës dhe ndërtesave është vlera e drejtë. Toka dhe ndërtesat janë rivlerësuar për herë të fundit më 31 Dhjetor 2021 bazuar në vlerësues të jashtëm, të pavarur dhe të kualifikuar. Menaxhmenti nuk beson se ka pasur një lëvizje materiale në vlerën e drejtë që nga data e rivlerësimit deri më 31 Dhjetor 2023.

Matja e tokës dhe ndërtesës klasifikohet në nivelin 3 të hierarkisë së vlerës së drejtë pasi të dhënat dhe supozimet e përdorura për të arritur në vlerën e drejtë janë të pavëzhgueshme. Në mungesë të një tregu aktiv, vlera e drejtë e tokës dhe ndërtesës më 31 Dhjetor 2021 u përcaktua duke përdorur mesataren e vlerës së drejtë të tregut të përfutur nga metoda e krahasimit dhe qasja e të ardhurave.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerën e drejtë në datën e raportimit duke hequr zhvlerësimin e akumuluar.

Ndërtesat	Vlera e Drejtë Niveli 1	Vlera e Drejtë Niveli 2	Vlera e Drejtë Niveli 3
31 Dhjetor 2023	-	-	8,397
31 Dhjetor 2022	-	-	8,720

Të dhënat e përdorura për llogaritjen e vlerës së drejtë të ndërtesave janë paraqitur më poshtë:

	Çmimi për m²	Të ardhurat nga qiraja për m²	Norma e Kapitalizimit	Lokacioni
31 Dhjetor 2021	EUR 5,585	EUR 18	4.5%	Sheshi Nëna Terezë

5. Paraqitja dhe përcaktimi i vlerës së drejtë (vazhdim)

Instrumentet financiare jo të matur me vlerën e drejtë – Hierarkia e vlerës së drejtë

Tabela e mëposhtme përcakton vlerën e drejtë të instrumenteve financiare jo të matura me vlerën e drejtë dhe analizën sipas nivelit të tyre në hierarkinë e vlerës së drejtë, në të cilën secila matje me vlerën e drejtë është kategorizuar.

	Vlera Kontabël		Vlera e drejtë			
	2023	2022	Niveli 2 2023	Niveli 3 2023	Niveli 2 2022	Niveli 3 2022
Pasuritë						
Paraja e gatshme dhe në banka	54,299	32,388	54,299	-	32,388	-
Gjendja me BQK	74,360	95,201	74,360	-	95,201	-
Kredi për klientët	441,298	379,892	-	441,298	-	379,892
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	537,067	505,342	537,067	-	505,342	-
Detyrimet ndaj bankave	1,487	93	1,487	-	93	-

Vlera e drejtë për pasuritë dhe detyrimet financiare të mësipërme është përcaktuar duke përdorur Nivelin 2 apo 3 të të dhënave të përshkruara më lartë.

Balancat me banka

Detyrimet me bankat e tjera përfshijnë vendosjet ndërbankare dhe llogaritë. Përderisa balancat me bankat janë afatshkurtër, vlera e tyre e drejtë është konsideruar të jetë e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

Kreditë për klientët

Vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur modele vlerësimi, të tilla si teknikat e skontuara të fluksit monetar. Inputi në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës, normat e interesit dhe normat e parapagimit. Për të përmirësuar saktësinë e vlerësimit për kreditë tregtare me pakicë dhe ato më të vogla, kreditë homogjene grupohen në portofol me karakteristika të ngjashme. Nuk ka raste të kredive që vlerësohen në bazë të inputeve të vëzhgueshme.

Depozitat nga klientët

Vlera e drejtë e depozitave nga klientët vlerësohet duke përdorur teknikat e skontuara të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat dhe borxhet e varura me maturime dhe kushte të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshme në datën e raportimit. Depozitat kanë një vlerë të drejtë të vlerësuar e cila përafrohet me vlerën kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër ose të normave bazë të interesit që përafrohen me normat e tregut. Shumica e depozitave i nënshtrohen ri-çmimit brenda një viti.

6. Paraja e gatshme dhe në banka

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Paraja e gatshme	13,447	12,207
Llogari rrjedhëse me bankat	40,864	20,190
Lejimet për humbje	(12)	(9)
	54,299	32,388

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë përbëhen si më poshtë:

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Paraja e gatshme dhe në banka	54,299	32,388
Gjendja me BQK (Shënimi 7)	74,360	95,201
Rezerva e detyrueshme në BQK	(30,818)	(32,153)
Fondet e tjera të kufizuara	(1,719)	(2,335)
	96,122	93,101

Në përputhje me kërkesat e BQK-së në lidhje me rezervën e depozitave për qëllime likuiditeti, Banka duhet të mbajë minimalisht 10% të depozitave të klientëve me afat maturimi deri në një vit, si rezerva të ligjshme. Rezervat që duhet të njihen ligjerisht përfaqësojnë instrumente me likuiditet të lartë, duke përfshirë paratë në dorë, llogaritë në BQK ose në bankat tjera në Kosovë, dhe shumat e mbajtura në BQK nuk duhet të jenë më pak se gjysma e totalit të rezervës ligjore.

Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50% e ekuivalentit në euro të parave të gatshme të shprehura në valuta lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave.

Lëvizja e humbjeve për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, e ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	2023	2022
Gjendja fillestare	9	-
Ngarkimi/(lëshimi) në fitim dhe humbje	3	9
Gjendja përfundimtare	12	9

7. Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Rezerva e detyrueshme me BQK	30,818	32,153
Llogaritë rrjedhëse	43,559	63,070
Lejimet për humbje	(17)	(22)
	74,360	95,201

Lëvizja e provizionit për humbje për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, e ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë :

	2023	2022
Gjendja fillestare	22	-
Ngarkimi/(lëshimi) në fitim dhe humbje	(5)	22
Gjendja përfundimtare	17	22

8. Kredi për klientët

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Kreditë	385,936	328,009
Mbitërheqjet	64,953	63,480
	450,889	391,489
Interesi i përlllogaritur	2,403	1,757
Tarifa disbursimi të shtyra	(1,725)	(1,446)
	451,567	391,800
Lejimet për humbjet e kredive	(10,269)	(11,908)
Kreditë për klientët	441,298	379,892

Kreditë paraqiten në vlerën nominale, interesi i përlllogaritur bazohet në normat nominale të interesit, ndërsa tarifët e shtyra të disbursimit janë tarifa shtesë që janë pjesë e normës efektive të interesit.

Maturiteti për kreditë afatgjata varion nga 1 deri në 30 vjet (2022: 1 deri 30 vjet). Në 2023, norma e interesit për kreditë ndaj klientëve varioi nga 2.20% në 24% në vit (2022: 2.20% në 24% në vit). Banka ka dhënë disa kredi me normë interesi në limitin minimal të treguar më lartë, të cilat janë norma më të ulëta se ato që ofrohen përgjithësisht nga Banka dhe mbulohen nga kolaterali i parasë së gatshme. Lëvizjet në provizionet për humbjet nga kreditë janë si më poshtë:

	2023	2022
Lejimet për humbjet e kredive më 1 Janar	11,908	10,784
Kreditë e shlyera	(941)	(1,222)
Ngarkesa / (Lirimi) neto për vitin	(698)	2,346
Lejimet për humbjet e kredive më 31 Dhjetor	10,269	11,908

Lëvizja e lejimeve për humbje për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022, të ngarkuara ose liruara në fitim dhe humbje janë si më poshtë :

	2023	2022
Lirimi/(Ngarkesa)	698	(2,346)
Rikuperimet nga kreditë e shlyera më parë	677	1,678
Humbjet neto nga dëmtimi i kredive	1,375	(668)

8. Kreditë te klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në lejimet e kredive me kosto te amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	Gjthsej
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma e provizionit me 1 Janar 2023	4,131	1,939	5,838	-	11,908
<i>Levizjet me impakt në F&H</i>	-	-	-	-	-
<i>Transferet:</i>	-	-	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(155)	155	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(733)	-	733	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	17	(17)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(370)	370	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	36	-	(36)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	6	(6)	-	-
Lirimi i HPK-së për çregjistrimin e huave të tjera përveç shlyerjeve	(1,079)	(919)	(415)	-	(2,413)
Pasuritë e reja financiare me origjinë ose të blera	1,262	331	162	-	1,755
Ndryshimet ne Parametrat e Riskut (PD/HDHD/ENP)	(909)	(413)	1,267	-	(55)
Ndryshimet ne Modele	-	-	-	-	-
Rikthimi i skontimit	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	(926)	-	(926)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Vlera e provizionit neto për periudhën	(1,561)	(1,227)	1,149	-	(1,639)
Lëvizje të tjera pa impakt në F&H	-	-	-	-	-
Instrumente të ç'regjistruara	-	-	-	-	-
Shuma e provizionit më 31 Dhjetor 2023	2,570	712	6,987	-	10,269

8. Kreditë të klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive me kosto të amortizuara:

	Shuma bruto e bartur me 1 janar 2023			
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi
	EUR0'000	EUR0'000	EUR0'000	EUR0'000
<i>Transfertime:</i>	345,322	35,623	10,544	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(3,023)	3,023	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(1,568)	-	1,568	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	8,553	(8,553)	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(796)	796	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	256	-	(256)	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	95	(95)	-
Pasuritë financiare të ç'regjistruara gjatë periudhës përveç shlyerjeve	(94,746)	(16,197)	(1,044)	-
Instrumente financiare të reja, me origjinë ose të blera	218,659	9,992	346	-
Modifikimet në rrjedhën e parasë kontraktuale	(50,622)	(5,175)	(886)	-
Shlyerjet	-	-	(926)	-
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-
Shuma bruto e bartur më 31 dhjetor 2023	422,831	18,012	10,047	-
				450,889

8. Kreditë te klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në humbjet e pritshme të kredive mbajtur ne kosto te amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	Gjthsej
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	
	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000	EURO'000
Shuma e provizionit me 1 Janar 2022	2,661	1,847	5,810	466	10,784
<i>Levizjet me impakt në F&H</i>	-	-	-	-	-
<i>Transferet:</i>	-	-	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(380)	380	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(965)	-	965	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	60	(60)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(445)	445	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	4	-	(4)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	4	(4)	-	-
Lirimi i HPK-së për çregjistrimin e huave të tjera përveç shlyerjeve	(733)	(501)	(612)	-	(1,846)
Pasuritë e reja financiare me origjinë ose të blera	2,181	1,483	181	-	3,845
Ndryshimet ne Parametrat e Riskut (PD/HDHD/ENP)	1,303	(769)	263	(466)	331
Ndryshimet ne Modele	-	-	-	-	-
Rikthimi i skontimit	-	-	-	-	-
Shlyerjet	-	-	(1,206)	-	(1,206)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Vlera e provizionit neto për periudhën	1,470	92	28	(466)	1,124
Lëvizje të tjera pa impakt në F&H	-	-	-	-	-
Instrumente të ç'regjistruara	-	-	-	-	-
Shuma e provizionit më 31 Dhjetor 2022	4,131	1,939	5,838	-	11,908

8. Kreditë të klientët (vazhdim)

Tabela e mëposhtme paraqet ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive me kosto të amortizuara:

	Shuma bruto e bartur me 1 janar 2022				Gjithsej
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	ATGJ	
	12-muaj HPK	Jetëgjatësi HPK	Jetëgjatësi HPK	Kreditë e blera ose me origjinë dëmtimi	
	EUR0'000	EUR0'000	EUR0'000	EUR0'000	EUR0'000
<i>Transfertime:</i>	310,096	20,156	8,535	493	339,280
Transfer nga faza 1 në fazën 2	(14,515)	14,515	-	-	-
Transfer nga faza 1 në fazën 3	(2,608)	-	2,608	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 1	6,888	(6,888)	-	-	-
Transfer nga faza 2 në fazën 3	-	(1,309)	1,309	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 1	304	-	(304)	-	-
Transfer nga faza 3 në fazën 2	-	17	(17)	-	-
Pasuritë financiare të ç'regjistruara gjatë periudhës përveç shlyerjeve	(97,270)	(7,726)	(1,217)	-	(106,213)
Instrumente financiare të reja, me origjinë ose të blera	183,248	19,751	830	-	203,829
Modifikimet në rrjedhën e parasë kontraktuale	(40,821)	(2,893)	6	(493)	(44,201)
Shlyerjet	-	-	(1,206)	-	(1,206)
FX dhe lëvizjet e tjera	-	-	-	-	-
Shuma bruto e bartur më 31 dhjetor 2022	345,322	35,623	10,544	-	391,489

9. Investime në letrat me vlerë

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Investimet në letrat me vlerë – në VDATGJ		
Obligacionet qeveritare	10,546	28,115
Interes i llogaritur	62	116
Lejimet për humbje	(3)	(6)
Gjithsej investimet në letrat me vlerë	10,605	28,225

Investimet në letra me vlerë në datën e raportimit përfaqësojnë obligacionet qeveritare nga tre vjet deri në pesë vjet të shprehura në EUR. Portofolio e investimeve bankare klasifikohet në dy pjesë me kosto të amortizuar dhe VDATGJ, dhe të gjitha këto investime investohen në letrat me vlerë të emtuara nga Qeveria e Kosovës. Banka nuk ka bono të thesarit ose obligacione të cilat janë klasifikuar në kosto të amortizuar më 31 Dhjetor 2023.

Banka ka pesë Obligacione Qeveritare që nga dhjetori 2023 të cilat klasifikohen në VDATGJ, mesatarja e maturimit për këto obligacione është 3.15 vjet (2022: 3.91 vjet) dhe mesatarja e interesit është 3.16% (2022: 2.80%).

Tabela në vijim paraqet lëvizjet e investimeve në letra me vlerë të matura në VDATGJ gjatë vitit 2023 dhe 2022:

	Investimet në VDATGJ
Më 1 Janar 2023	28,115
Shtesat	8,667
Heqjet	(26,111)
(Humbja)/fitimi i perealizuar	(125)
Më 31 Dhjetor 2023	10,546
Më 1 Janar 2022	5,017
Shtesat	23,057
Heqjet	-
Fitimi/(humbja) e perealizuar	41
Më 31 Dhjetor 2022	28,115

9.1 Investimet në filial

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Investimet në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a.	7,358	6,058
Totali i Investimeve në Filialin	7,358	6,058

Më 17 Maj 2022 Banka ka nisur procesin e blerjes së Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. me nënshkrimin e kontratës së blerjes me aksionerin paraprak të Shoqërisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. Kontrata i është dërguar Rregullatorit për miratim.

Miratimi nga Rregullatori lidhur me transaksionin për blerjen e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. është marrë nga Banka më 22 qershor 2022 dhe miratimi i Autoritetit të Konkurrencës është marrë më 9 Shtator 2022.

Pas marrjes së miratimeve rregullatore, më 12 Shtator 2022, Banka përfundoi procesin e blerjes së saj për blerjen e 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a, pas transferimit të shumës së rënë dakord prej 2,100 mijë eurosh tek aksioneri i mëparshëm i Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. Pas datës së blerjes, një shumë shtesë prej 958 mijë euro, 3,000 mijë euro dhe 1,300 mijë euro është investuar në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a. më 30 Shtator 2022, 19 Dhjetor 2022 dhe 01 Shtator 2023, respektivisht.

Më 31 Dhjetor 2023, Banka është aksioneri i vetëm i Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a.

10. Prona, pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi

Më poshtë është një ndarje e pronave dhe pajisjeve në pronësi dhe me qira:

	2023	2022
Prona, dhe pajisjet në pronësi	10,890	11,391
Pasuritë me të drejtë përdorimi SNRF 16	2,714	2,588
Prona, Impiantet dhe Pajisjet dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	13,604	13,979

Banka jep me qira disa pasuri të cilat përbëhen nga objekte. Informacioni rreth pasurive me të drejtë të përdorimit dhe detyrimeve të qirasë për të cilat Banka është qiramarrës është paraqitur më poshtë:

Pasuritë me të drejtë përdorimi	2023	2022
Gjendja më 1 Janar	2,588	1,585
Shtesat në vitin aktual	1,936	1,832
Shlyerjet/kontrata të ndërprera	(582)	(172)
Shpenzimet e zhvleresimit per vitin	(1,228)	(657)
Gjendja më 31 Dhjetor	2,714	2,588
Detyrimi ndaj qirasë më 1 Janar 2022		1,458
+ Shtesat		1,637
- Shlyerjet		(56)
- Pagesat e qirasë		(840)
+ Interesi mbi detyrimet e qirasë		63
Detyrimi i qirasë më 31 Dhjetor 2022		2,262
+ Shtesat		1,324
- Shlyerjet		(181)
- Pagesat e qirasë		(976)
+ Interesi mbi detyrimet e qirasë		79
Detyrimi i qirasë më 31 Dhjetor 2023		2,508

Shumat e njohura si fitim ose humbje te Bankës për vitet e përfunduara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022:

	2023	2022
Interesi mbi detyrimet e qirasë - SNRF 16	(79)	(63)
Zhvlerësimi për Pasuritë me të drejtë përdorimi	(1,228)	(657)
Shpenzimet totale nga qiratë	(1,307)	(720)

10. Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi (vazhdim)

<i>Kostoja ose Rivlerësimi</i>	Ndërtesat	Përmirësimet e qirasë	Mobiljet, instalime dhe pajisje	Kompjutera dhe pajisje të lidhura	Automjete	Gjithsej
Në 1 Janar 2022	10,869	1,335	3,482	1,858	781	18,325
Shtesat	-	105	547	307	187	1,146
Heqjet nga përdorimi	-	(419)	(93)	(35)	-	(547)
Më 31 Dhjetor 2022	10,869	1,021	3,936	2,130	968	18,924
Shtesat	-	385	264	183	4	836
Shlyerjet	-	(100)	(149)	(23)	-	(272)
Më 31 Dhjetor 2023	10,869	1,306	4,051	2,290	972	19,488
Zhvlerësimi akumuluar						
Në 1 Janar 2022	1,829	793	2,362	1,379	429	6,792
Shpenzimi për vitin	320	194	405	216	129	1,264
Shlyerjet	-	(402)	(90)	(31)	-	(523)
Më 31 Dhjetor 2022	2,149	585	2,677	1,564	558	7,533
Shpenzimi për vitin	323	214	440	201	139	1,317
Shlyerjet	-	(83)	(147)	(22)	-	(252)
Më 31 Dhjetor 2023	2,472	716	2,970	1,743	697	8,598
Vlera Kontabël						
Në 1 Janar 2022	9,040	542	1,120	479	352	11,533
Më 31 Dhjetor 2022	8,720	436	1,259	566	410	11,391
Më 31 Dhjetor 2023	8,397	590	1,081	547	275	10,890

Më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 Banka nuk ka asnjë pronë ose pajisje të lënë peng si kolateral.

Vlera kontabël e pronës dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme të Bankës në 31 dhjetor 2023 ishte 13,336 mijë euro duke përfaqësuar 22.46 % të Kapitalit të Nivelit të Parë (2022: 13,053 mijë euro duke përfaqësuar 27.60 % të Kapitalit të Nivelit të Parë). Limiti maksimal rregullator për prona dhe pajisje dhe pasuri të paprekshme është 50% i Kapitalit të Nivelit të Parë. Nuk është raportuar shkelje e raportit të tillë në 2023, as në 2022.

Nëse toka dhe ndërtesat do të deklaroheshin sipas konventës së kostos historike, shumat do të ishin si më poshtë:

	2023	2022
Gjendja më 1 Janar	3,803	3,944
Shtesat në vitin aktual	-	-
Më pak: Zhvlerësimi	(141)	(141)
Gjendja më 31 Dhjetor	3,662	3,803

11. Pasuritë e paprekshme

Kosto	Pasuritë e paprekshme në		
	Softueri	vijim	Gjithsej
Me 1 Janar 2022	1,557	3,158	4,715
Shtesat gjatë vitit	411	981	1,392
Shlyerjet	(444)	-	(444)
Më 31 Dhjetor 2022	1,524	4,139	5,663
Shtesat gjatë vitit	597	-	597
Transferat	915	(915)	-
Shlyerjet	(372)	-	(372)
Humbja nga zhvlerësimi	-	(942)	(942)
Më 31 Dhjetor 2023	2,664	2,282	4,946
Amortizimi akumuluar			
Më 1 Janar 2022	766	-	766
Shpenzimi për vitin	459	-	459
Heqjet nga përdorimi	(356)	-	(356)
Më 31 Dhjetor 2022	869	-	869
Shpenzimi për vitin	459	-	459
Shlyerjet	(242)	-	(242)
Më 31 Dhjetor 2023	1,086	-	1,086
Vlera kontabël			
Më 31 Dhjetor 2022	655	4,139	4,794
Më 31 Dhjetor 2023	1,578	2,282	3,860

Banka ka nënshkruar një kontratë të re në Nëntor 2018 për zhvillimin e sistemit të ri kryesor bankar të cilin është në zhvillim e sipër. Projekti do të përfundojë në Tetor 2023.

Pas datës së raportimit, Banka arriti në përfundimin se funksionaliteti i sistemit të ri nuk plotëson plotësisht infrastrukturën e tyre ekzistuese të TI-së, si rezultat, banka rihyri në një diskutim me kontraktorin dhe negocioi një kontratë të rishikuar, sipas së cilës sistemi bankar ekzistues do të përmirësohej për të mbuluar të gjitha zhvillimet që ishin parashikuar fillimisht në kuadër të sistemit të ri bankar bazë, pa asnjë kosto shtesë për Bankën.

Banka dhe Kontraktori kanë rënë dakord për një listë specifike të moduleve dhe përmirësimeve që do të kryhen në sistemin ekzistues kryesor bankar, me afatin kohor të përfundimit të mbajtur të njëjtë me kontratën bazë, pra, tetor 2023.

Për shkak të mos përmbushjes së kërkesave kontraktuale të përfundimit të projekteve, më 29 dhjetor 2023 u miratua një ndryshim, duke ndryshuar marrëveshjen midis Bankës dhe Kontraktorit. Ky ndryshim zgjati afatet për projektet e papërfunduara, krahas rialokimit të burimeve mes tyre, me një përfundim të parashikuar në vitin 2024. Në të kundërt, pas analizimit të shumës së rikuperueshme të këtyre projekteve të papërfunduara, është njohur një humbje nga zhvlerësimi prej 942 mijë euro në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

Më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, Banka nuk ka pasuri pasuri të paprekshme të lëna peng si kolateral.

12. Pasuritë të tjera

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Parapagimet	745	752
Pronat e riposeduara	868	1,009
Të tjera	957	792
Lejmet për humbjet	(23)	(24)
Gjithsej	2,547	2,529

12. Pasuritë të tjera (vazhdim)

Lëvizjet në pronën e riposeduar gjatë viteve janë paraqitur më poshtë:

	2023	2022
Gjendja më 1 Janar	1,009	678
Shtesat në vitin aktual	118	712
Shitjet gjate vitit	-	(151)
Shlyerjet	(259)	(230)
Gjendja më 31 Dhjetor	868	1,009

13. Depozita nga klientët

	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Llogaritë rrjedhëse	229,392	252,266
Llogaritë e bllokuara	9,648	11,861
Depozitat Flexi	6,526	7,220
Llogaritë e kursimit	27,170	22,711
	272,736	294,058
Shtuara: Maturimi afatshkurtë i depozitave afatgjatë	65,458	62,792
Gjithsej depozitat afatshkurtëra të klientëve	338,194	356,850
Depozita me afat	259,778	207,633
	259,778	207,633
Zvogëluara: Maturimi afatshkurtë i depozitave afatgjatë	(65,458)	(62,792)
Gjithsej depozitat afatgjata të klientëve	194,320	144,841
Interes i përlllogaritur	4,553	3,651
Gjithsej	537,067	505,342

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.

Normat mesatare efektive të interesit për depozitat me afat në vitin 2023 dhe 2022 ishin si vijon:

Viti	1 muaj	3 muaj	6 muaj	1 vit	18 muaj	2 -5 vite	>5 vite
2023	0.02%	2.51%	1.52%	2.32%	2.22%	2.77%	1.80%
2022	0.03%	1.37%	1.26%	1.45%	2.10%	2.35%	2.5%

14. Detyrimet ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave prej 1,487 mijë euro (2022: 93 mijë euro) përfaqësojnë llogari rrjedhëse me bankat vendase.

15. Detyrimet tjera

	Më 31 Dhjetor 2023	Më 31 Dhjetor 2022
Detyrimet e qirasë (Shënimi 10)	2,508	2,262
Shpenzimet e përlllogaritura	748	743
Të hyrat të tjera të shtyera	237	197
Provizione për humbje nga garancitë	84	162
Provizione për çështje gjyqësore	63	138
Tarifat e pensioneve dhe asistencës sociale	40	33
Taksa tjera të pagueshme	122	14
Gjithsej	3,802	3,549

15. Detyrimet tjera (vazhdim)

Lëvizjet e provizioneve për humbje nga garancitë e lëshuara nga Banka janë si vijon:

	2023	2022
Provizionet më 1 Janar	162	22
(Lirimi)/Ngarkesa gjatë vitit (Shënimi 19)	(78)	140
Provizionet më 31 Dhjetor	84	162

16. Ekuiteti dhe rezervat

Ekuiteti i nënshkruar dhe paguar i Bankës përbëhet nga 114,930 aksione të zakonshme (2022: 114,930 aksione të zakonshme) me vlerë nominale 256 euro secili (2022: 256 euro). Struktura aksionare e Bankës është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2023		Më 31 Dhjetor 2022	
	%	Shuma	%	Shuma
Behgjet Pacolli	35	10,246	35	10,246
Immobilare Red Llc	29	8,402	29	8,402
Immobilare Blue Llc	18	5,360	-	-
Selim Pacolli	-	-	18	5,360
Xhabir Kajtazi	12	3,482	12	3,482
Ismet Gjoshi	3	987	3	987
Hasan Hajdari	1	297	1	297
Zyhra Hajdari	1	285	1	285
Others with less than 1%	1	363	1	363
	100	29,422	100	29,422

Mbajtësit e aksioneve të zakonshëm kanë të drejtë të marrin dividendë kur deklarohen herë pas here dhe kanë të drejtën e një vote për aksion. Të gjitha aksionet renditen në mënyrë të barabartë në lidhje me pasuritë e mbetura të Bankës.

Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2023, Selim Pacolli hoqi aksionet e tij të plota në bankë dhe aksionari i ri Immobilare Blue Llc bleu aksionet e tij. (2022: Nuk ka pasur ndryshime në strukturën aksionare).

Gjatë vitit që përfundoi më 31 dhjetor 2023 nuk ka dividendë të paguar, (2022: Banka pagoi dividendë në shumën prej 2,000,000 euro nga fitimi i pashpërndarë).

Në përputhje me ligjin nr.04/L-093 për “Bankat, Institucionet Mikrofinanciare, Institucionet Financiare Jobankare” minimumi i kapitalit të paguar për bankat vendase që veprojnë në Kosovë është 7 milion euro.

Rezervat e rivlerësimit

Lëvizjet në rezervën e rivlerësimit janë si në vijim:

	2023	2022
Rezerva e rivlerësimit më 1 Janar	4,853	4,794
Rivlerësimi i pronës (pa taksa)	18	18
Rezerva e rivlerësimit të investimeve në letra me vlerë e matur në VDATGJ	(125)	41
Transferimi në fitimin e pashpërndarë	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor	4,746	4,853

17. Te ardhurat neto nga interesi të llogaritura duke përdorur metodën e interesit efektiv

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Të ardhurat nga interesi		
Kreditë për klientët	29,800	24,295
Depozitat dhe llogaritë me bankat	453	7
Investime në letra me vlerë	493	277
Gjithsej të ardhurat nga interesi	30,746	24,579
Shpenzimet e interesit		
Depozitat nga klientët	(5,371)	(3,188)
Interesi mbi detyrimet e qirasë SNRF 16	(79)	(63)
Gjithsej shpenzimet e interesit	(5,450)	(3,251)
Te ardhurat neto nga interesi	25,296	21,328

18. Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2022
Shërbimet bankare	4,482	4,136
Garancitë	294	222
Te ardhurat nga tarifat dhe komisionet	4,776	4,358
Shpenzime për Swift	(604)	(651)
Tarifa për licensë dhe tarifa të tjera rregullatore	(597)	(263)
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(1,201)	(914)
Te ardhurat neto nga tarifat dhe komisionet	3,575	3,444

19. Të ardhura të tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Fitimet nga shitja e investimeve	354	-
Të ardhura të tjera	135	454
Fitimet/(humbjet) neto nga këmbimi valutor – (shënimi 19.1)	67	(4)
Lirim/(Ngarkesa) nga garancitë	78	(140)
(Ngarkesa)/Lirimi nga proceset gjyqësore	(28)	105
Lirimi nga zhvlerësimi i pasurive tjera	-	82
	606	497

19.1 Fitimet/(humbjet) neto nga këmbimi valutor përfshijnë fitimet nga valuta në vlerë prej 4,423 mijë Euro (2022: 1,568 mijë) dhe humbjet nga këmbimi në vlerë prej 4,356 mijë (2022: 1,572 mijë)

20. Shpenzimet e personelit

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Paga dhe mëditje	4,708	4,253
Kontribute për pension	239	202
Kompensime të tjera	120	93
Gjithsej	5,067	4,548

21. Shpenzimet e tjera

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Sigurimi	1,288	1,202
Riparimi dhe mirëmbajtja	1,216	1,107
Shërbime të TI	1,458	551
Tarifat e sigurimit të depozitave	756	644
Shpenzimet operacionale Mastercard	897	534
Reklamim dhe marketing	550	301
Të tjera	506	351
Sponsorizimi – lejohet për qëllime tatimore	396	305
Tarifa profesionale dhe tarifat tjera ligjore të lidhur me to	298	271
Shërbimet komunale dhe karburantet	285	285
Rënia në vlerë e pasurive të riposeduara	259	230
Shpenzimet e lidhura me konsulencën	198	71
Shpenzimet e tarifave në lidhje me FKGK	189	136
Shërbimet e mbledhjes së kredive	145	157
Shlyerja e pasurive fikse	149	120
Komunikimi	139	121
Shpenzimet e përfaqësimit	96	112
Materialet e zyrës	60	54
Udhëtime	27	14
Printime	24	47
Gjithsej	8,936	6,613

22. Tatimi mbi të ardhurat

Tatimi mbi të ardhura në Kosovë llogaritet në shkallën 10% (2022: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

Në vijim paraqitet një barazim i rezultatit kontabël me tatimin në fitim:

	2023	2022
Ftitimi para tatimit (përfshijë sponsorizimin)	13,303	11,328
Tatimi në shkallën 10%	1,330	1,133
<i>I rregulluar për:</i>		
Shpenzime të pazbritshme	455	655
Shpenzime interesi shtesë të zbritshme	20	(18)
Të ardhura të përjashtuara	(84)	(28)
Rregullimi tatimor i zhvlerësimit	(362)	(565)
Shtoni shpenzimet e lejuara të interesit	205	117
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat për vitin	1,564	1,294
<i>Norma efektive tatimore</i>	11.76%	11.42%
Sponsorizimi në kulturë dhe sport (deri në 30% të shpenzimit të tatimit në fitim)	(396)	(305)
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	1,168	989
Ngarkesa e tatimit të shtyrë	14	14
Shpenzimet e tatimit mbi të ardhurat e njohura në fitim dhe humbje dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	1,182	1,003

23. Zotimet dhe Kontigjencat

Banka lëshon garanci për klientët e saj. Këto instrumente kanë një rrezik kredie të ngjashëm me atë të kredive të dhëna klientëve. Bazuar në vlerësimin e menaxhmentit, nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me garancitë e papaguara më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022.

<i>Garancitë</i>	2023	2022
Siguruara me depozita	492	1,573
Siguruara me kolateral tjetër	12,315	8,265
	12,807	9,838
<i>Zotimet kreditore</i>		
Kreditë e aprovuara por jo të lëshuara	3,787	8,786
Mbitërheqjet	15,651	19,077
Kredit kartela	4,373	3,318
Objektet e kartës së kreditit të papërdorur	23,811	31,181

Kolaterale të tjera të zotuar për garanci, përfshijnë kryesisht pronat e pengut dhe të pasurive të paluajtshme. Zotimet përfaqësojnë bilancet e huaja të kredive, mbitërheqje dhe limit kartelat që u jepen klientëve.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2023, Banka ka njohur provizione në vlerën 63 mijë euro (31 dhjetor 2022: 138 mijë euro), në lidhje me procedurat ligjore. Menaxhmenti beson se provizionet e njohura janë një vlerësim i arsyeshëm kundrejt rezultatit të padive në vazhdim kundër Bankës më 31 Dhjetor 2023.

24. Transaksionet me palët e lidhura

Në përputhje me SNK 24 "Dhënia e informacioneve shpjeguese për palët e lidhura", një palë e lidhur është çdo palë që ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose të ushtrojë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative.

Transaksionet me palët janë bërë në kushte të njëjta me ato që mbizotërojnë në transaksionet në treg.

Në rrjedhën e kryerjes së aktiviteteve bankare, Banka hyn në transaksione të ndryshme biznesi me palët e lidhura dhe gjendjet me aksionarët dhe individët apo shoqëritë e tjera të lidhura më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si më poshtë:

	Bordi i Drejtorëve		Menaxhmenti kyç		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura		Gjithsej	
	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
Pasuritë								
<i>Kreditë e klientëve</i>								
Kreditë e klientëve, net	79	39	276	323	9,803	9,252	10,158	9,614
Pasuritë e paprekshme në progres	-	-	-	-	2,282	4,140	2,282	4,140
Gjithsej Pasuritë	79	39	276	323	12,085	13,392	12,440	13,754
Detyrimet								
Depozita nga klientët	(85)	(11)	(355)	(44)	(29,056)	(30,503)	(29,496)	(30,558)
Gjithsej Detyrimet	(85)	(11)	(355)	(44)	(29,056)	(30,503)	(29,496)	(30,558)
Garancitë	-	-	-	-	65	348	65	348
Gjithsej jashtë bilancit	-	-	-	-	65	348	65	348

Vlera totale e vlerësuar e kolateralit nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2023 ishte 16,213 mijë euro (Më 31 dhjetor 2022 vlera e tillë e vlerësuar ishte 18,428 mijë euro).

Angazhimet e papërdorura për kredi me palët e lidhura më 31 dhjetor 2023, janë 944 mijë euro (2022: 758 mijë euro).

Depozitat e palëve të lidhura përbëjnë 5.49 % (2022: 6.05 %) të gjendjes totale të depozitave të klientëve.

Transaksionet me palët e lidhura gjatë 2023 dhe 2022 janë si në vijim:

	Board of Directors		Key management		Major shareholders and other parties related to them		Total	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Të hyrat nga interesi	3	3	9	9	315	411	327	423
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	-	-	1	-	(98)	80	(97)	80
Shpenzimet e interesit	-	-	1	-	(126)	(36)	(125)	(36)
Shpenzimet e implementimit-BV	-	-	-	-	(1,386)	(383)	(1,386)	(383)
Paguhet për të paprekshme në zhvillim	-	-	-	-	-	981	-	981

Shpërblimi total për menaxhmentin kryesor të Bankës është si më poshtë:

	2023	2022
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për Bordin e Drejtorëve	120	93
Përfitimet afatshkurtra të punonjësve për menaxhmentin kyç	350	249
	470	342

25. Menaxhimi i rrezikut financiar

(a) Hyrje dhe përmbledhje

Banka është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiar:

- Rreziku i tregut
- Rreziku kreditor
- Rreziku i likuiditetit

Kuadri i menaxhimit të rrezikut

Ky shënim paraqet informacione rreth ekspozimit të Bankës ndaj secilit rrezik më sipër, objektivave, politikave dhe proceseve të saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut si dhe menaxhimin e kapitalit të saj.

Bordi i Drejtorëve ("Bordi") ka përgjegjësi për themelimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka themeluar Komitetin e Pasurive dhe Detyrimeve ("ALCO"), Komitetin e Likuiditetit, Komitetin e Kredive, Komitetin e Auditimit, dhe Komitetin e Manaxhimit të Rrezikut, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të Bankës mbi menaxhimin e rrezikut në fushat e tyre specifike. Të gjitha Komitetet e Bordit të Drejtorëve kanë anëtar ekzekutiv dhe jo ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballlet Banka, për të përcaktuar limitet dhe kontrollet e rrezikut, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve. Politikat e saj të menaxhimit të rrezikut dhe sistemet rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe shërbime të ofruara.

Banka synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolin dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit të Bankës është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të Bankës dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit për menaxhimin e rrezikut në raport me rreziqet me të cilat përballlet Banka. Komiteti i Auditimit të Bankës në këto funksione ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikime në mënyrë të rregullta dhe spontane të kontrollit dhe procedurave për menaxhim e rrezikut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Banka operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Bankës. Menaxhmenti i Bankës monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe merr masat e përshtatshme në lidhje me rrezikun e kredisë, të tregut (normës primare të interesit) dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet negative të mundshme nga kriza financiare dhe ekonomike globale. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut, duke mbajtur një pozicion të mjaftueshëm likuid dhe të kapitalit.

(b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të Bankës nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Banka merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Menaxhimi i rrezikut

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut kreditor. Një departament të veçantë i Rrezikut kreditor është përgjegjës për administrimin e rrezikut të kredisë të Bankës. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut kreditor për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë së huamarrësit. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfituar kolateral dhe garanci.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(b) Rreziku kreditor (vazhdim)
Analiza e cilësise së kredise

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë kreditore të asetet financiare dhe zbritjet për zhvlerësim/humbje krijuar nga Banka kundrejt këtyre pasurive. Tabela më poshtë paraqet rastin më të keq të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor për Bankën më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut kreditor. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garanctë financiare	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</i>	441,298	379,892	10,605	28,225	115,212	115,382	-	-
<i>Vlera e bartur</i>	441,298	379,892	10,605	28,225	115,212	115,382	-	-
<i>Me kosto të amortizuara</i>	451,567	391,800	10,608	28,231	115,241	115,413	-	-
<i>Provizionet për humbje</i>	(10,269)	(11,908)	(3)	(6)	(29)	(31)	-	-
<i>Vlera kontabël neto</i>	441,298	379,892	10,605	28,225	115,212	115,382	-	-
<i>Jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>								
<i>Angazhimet kreditorë: Rrezik i ulët - i drejtë</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	12,807	9,838
<i>Gjithsej Angazhime/garanci</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	12,807	9,838
<i>Provizionet e njohura si detyrim</i>	-	-	-	-	-	-	(84)	(162)
<i>Gjithsej Ekspozimi</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	12,723	9,676

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

	2023				2022			
	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kredite	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kredite
Kreditë për klientët								
Gjithsejt shuma bruto	144,336	142,246	164,986	451,567	125,644	117,694	148,462	391,800
Lejimet për humbje	(3,009)	(4,110)	(3,151)	(10,269)	(3,294)	(4,933)	(3,681)	(11,908)
Vlera kontabël neto	141,327	138,136	161,835	441,298	122,350	112,761	144,781	379,892
<i>Kreditë me kushte të rinegociuara</i>								
Vlera kontabël	405	2,365	447	3,217	310	2,219	1,261	3,791
Lejimet për humbje	(94)	(393)	(69)	(556)	(52)	(451)	(610)	(1,114)
Vlera kontabël neto	311	1,972	378	2,661	258	1,768	651	2,677
<i>Kreditë në vonesë</i>								
Jo në vonesë	130,546	123,563	152,315	406,424	119,359	107,344	143,988	370,691
Në vonesë 1-30 ditë	10,902	13,355	9,520	33,777	3,894	4,983	1,095	9,972
Në vonesë 31 - 90 ditë	893	1,242	306	2,441	900	1,496	168	2,564
Në vonesë 91 – 365 ditë	852	1,644	-	2,496	603	2,478	-	3,081
Në vonesë mbi 365 ditë	1,142	2,442	2,845	6,429	888	1,393	3,211	5,492
	144,335	142,246	164,986	451,567	125,644	117,694	148,462	391,800

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Zhvlerësime dhe provizionime

Gjithsej provizionet që kërkohen nga SNRF-të për “Menaxhimin e Rrezikut Kreditor” (shih 3. (f)(vii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuara në datën e raportimit (modeli i humbjes së shkaktuar) dhe humbjet e pritshme.

Banka vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërpalëve, duke përdorur mjete të brendshme rangimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpalesh. Mjete të tilla kombinojnë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpalët janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Bankës, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori. Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rangimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Banka.

Kreditë janë ranguar nga A në E në sistemin e brendshëm të rangimit të rrezikut kreditor:

- A Standarde
- B Vrojtuese
- C Nën-standarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Banka raporton klasifikimin e humarrësve të saj, tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosovës.

Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3.(f) (viii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Banka veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Banka vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë euro që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Banka dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Bankës. (2020: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

Kreditë në vonesë por të pazhlerësuara

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Bankës.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e shlyerjes

Banka shlyen një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi shlyerjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin. Gjithsej shuma e shlyer gjatë vitit 2023, është 940 mijë euro (2022: 1,222 mijë euro).

Depozita nga banka

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Banka kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.

Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim Gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Më 31 Dhjetor	2023	2022
AAA+ to BBB-	19,097	9,917
A+ to A-	781	1,790
BB+ to B-	-	-
BBB+ to B-	16,676	5,577
Të pa ranguara	3,082	1,912
Bankat vendore	1,216	985
	40,852	20,181

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

25. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Banka duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes

Banka menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.

Banka strukturon nivelet e rrezikut kreditor që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Banka mban kolateral kundrejt kredive ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

	2023		2022	
	Kredi për klientët	Vlera e drejtë e kolateralit	Kredi për klientët	Vlera e drejtë e kolateralit
Hipoteka	177,919	599,103	136,681	444,897
Kolateral në mjete monetare	16,207	16,207	13,240	13,240
Pengje	159,949	328,180	156,732	305,295
Miks (hipoteke dhe peng)	58,412	300,904	64,391	294,756
Pa kolateral	39,080	-	20,756	-
Gjithsej	451,567	1,244,394	391,800	1,058,188

Përqendrimi i rrezikut kreditor

Më 31 Dhjetor 2023, Banka ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në: 14.27%, gjithsej ishin pesë ekspozime ndaj kredive që tejkalonin 10% të kapitalit të nivelit të parë (2022: 14.43%, dy ekspozime të kredive). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 Dhjetor 2023, përfaqëson 17.90% (2022: 21.94%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 2.78% (2022: 5.54%) të kapitali të nivelit të parë.

Banka monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimit të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

25. Manaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Përqendrimi sipas sektorëve								
Korporative	161,835	144,781	-	-	-	-	9,925	1,845
Qeveria	-	-	10,605	28,225	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	115,212	115,382	-	-
Individët	141,327	122,350	-	-	-	-	-	-
Mikro entitete	138,136	112,761	-	-	-	-	2,882	7,993
Gjithsej	441,298	379,892	10,605	28,225	115,212	115,382	12,807	9,838
Përqendrimi sipas vendndodhjes								
Vendet e BE-së	-	-	-	-	39,648	19,544	-	-
Republika e Kosovës	441,298	379,892	10,605	28,225	75,564	95,838	12,807	9,838
Gjithsej	441,298	379,892	10,605	28,225	115,212	115,382	12,807	9,838

Pasojat e luftës Ukrainë-Rusi

Pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse dhe reagimi i mëpasshëm global ndaj këtyre veprimeve ushtarake mund të kenë efekte të rëndësishme financiare në shumë entitete dhe tregje financiare. Këto përfshijnë subjekte me operacione fizike në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi, si dhe interesa indirekte. Banka nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rosisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, Banka po monitoron vazhdimisht zhvillimet në lidhje me efektet e luftës Ukrainë-Rusi. Pozicioni financiar i Bankës vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si dhe në të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga tarifafat dhe komisionet.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është rregulluar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të Bankës kanë norma fikse interesi. Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Banka përpiket të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Ekspozimet e Bankës bazohen në normat e interesit të shënuara në Kosovë dhe Banka përballet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Bankës në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Thesarit monitoron në mënyrë konstante rrezikun e normave të interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për riçmimin ose rialokimin me miratimin e Komisionit të Pasurive dhe Detyrimeve. Raporti lidhur me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komisionit për Pasuri dhe Detyrime. Janë marrë masat e nevojshme nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analiza për depozituesit kryesorë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet në analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analizën e GAP-it mbi rrezikun e likuiditetit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e riçmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR dhe EURIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës me 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si në vijim:

	USD		EUR		CHF	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Pasuritë						
Paraja në dorë dhe në banka	2.87%	0.22%	1.00%	(0.35%)	-	(1.13%)
Balancat me BQK-në	-	-	0.30%	(0.41%)	-	-
Kreditë për klientët	-	-	6.88%	6.49%	-	-
Investime në letra me vlerë në VDATGJ	-	-	3.15%	2.80%	-	-
Detyrimet						
Depozitat e klientëve	0.58%	-	1.21%	0.85%	-	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Bankës ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në lakoren e pëqindjeve dhe një pozitë financiare të qëndrueshme) është si vijon:

Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
2023	(45)	(240)	(292)	(315)
2022	(97)	(163)	(144)	(426)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së maturimit. Rritja / rënia nuk është simetrike, sepse llogaritë e kursimit kanë normat 0.25% dhe në rast të rritjes për 100pb ato arrijnë 1.25%, ndërsa në rast rënie për 100bp, ato arrijnë deri në 0%. E njëjta gjë është me depozitimet; norma e tyre është 0% dhe në rast të rritjes me 100bp arrijnë në 1.00%, dhe në rast rënie ato arrijnë në 0%. Këto asete janë afatshkurtra, prandaj ato kanë prekur vetëm pjesën deri në një vit. Nuk ka asete afatgjata, kështu që ato nuk ndikojnë në pjesën mbi një vit.

31 Dhjetor 2023	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	25,426	-	-	-	-	-	28,873	54,299
Gjendja me BQK	74,360	-	-	-	-	-	-	74,360
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	10,605	-	-	10,605
Kredi klientëve – Norma fikse	9,015	11,390	24,186	40,378	224,685	131,644	-	441,298
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	934	934
Gjithsej	108,801	11,390	24,186	40,378	235,290	131,644	29,807	581,496
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	47,744	8,364	5,468	53,720	191,405	838	229,528	537,067
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	-	-	-	1,487
Detyrimet tjera	-	-	-	119	1,548	841	973	3,481
Gjithsej	49,231	8,364	5,468	53,839	192,953	1,679	230,501	542,035
Hendeku	59,570	3,026	18,718	(13,461)	42,337	129,965	(200,694)	39,461
Hendeku kumulativ	59,570	62,596	81,314	67,853	110,190	240,155	39,461	

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2022	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	7,066	-	-	-	-	-	25,322	32,388
Gjendja me BQK	95,201	-	-	-	-	-	-	95,201
Investimet në letra me vlerë	-	-	5,023	-	23,202	-	-	28,225
Kreditë e klientëve – Norma fikse	2,864	14,245	21,541	37,026	164,270	139,946	-	379,892
Pasuritë tjera	-	-	-	-	-	-	768	768
Gjithsej	105,131	14,245	26,564	37,026	187,472	139,946	26,090	536,474
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	48,287	10,102	5,467	42,163	146,958	6	252,359	505,342
Detyrimet ndaj bankave	93	-	-	-	-	-	-	93
Detyrimet tjera	-	-	-	2	1,469	790	929	3,190
Gjithsej	48,380	10,102	5,467	42,165	148,427	796	253,288	508,625
Hendeku	56,751	4,143	21,097	(5,139)	39,045	139,150	(227,198)	27,849
Hendeku kumulativ	56,751	60,894	81,991	76,852	115,897	255,047	27,849	-

Rreziku valutor

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë të huaj. Banka sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë valuta të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra.

Rreziku valuator nuk është i rëndësishëm, meqë pjesa më e madhe e transaksioneve të Bankës janë në valutën vendase. Valutat e huaja me të cilat Banka operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si në vijim:

Valuta	2023 EUR	2022 EUR
1 USD	1.1050	1.0666
1 CHF	0.9260	0.9847
1 GBP	0.8691	0.8869

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj një rritje apo zbritje në kursin e këmbimit është si në vijim:

	EUR	USD	CHF	GBP	Total
31 Dhjetor 2023					
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	42,627	5,594	5,201	877	54,299
Gjendja me BQK	74,360	-	-	-	74,360
Investimet në letra me vlerë	10,605	-	-	-	10,605
Kreditë ndaj klientëve	441,298	-	-	-	441,298
Pasuritë tjera	934	-	-	-	934
	569,824	5,594	5,201	877	581,496
Detyrimet					
Depozita nga klientët	525,858	5,138	5,196	875	537,067
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	1,487
Detyrime të tjera	3,481	-	-	-	3,481
	530,826	5,138	5,196	875	542,035
Pozicioni neto valutor	38,997	456	5	2	39,461
31 Dhjetor 2022					
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	21,912	4,251	4,680	1,545	32,388
Gjendja me BQK	95,201	-	-	-	95,201
Investimet në letra me vlerë	28,225	-	-	-	28,225
Kreditë ndaj klientëve	379,892	-	-	-	379,892
Pasuritë tjera	768	-	-	-	768
	525,998	4,251	4,680	1,545	536,474
Detyrimet					
Depozita nga klientët	497,886	2,037	4,665	754	505,342
Detyrimet ndaj bankave	93	-	-	-	93
Detyrime të tjera	3,190	-	-	-	3,190
	501,169	2,037	4,665	754	508,625
Pozicioni neto valutor	24,829	2,214	15	791	27,849

Një analizë e ndjeshmërisë së Bankës ndaj rritjes ose uljes së normave të valutës së huaj është si më poshtë:

	USD		CHF		GBP	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitimi ose humbja						
+5% e Euro	22.80	110.70	0.25	0.75	0.10	39.55
- 5% e Euro	(22.80)	(110.70)	(0.25)	(0.75)	(0.10)	(39.55)

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Banka do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.

Qasja e Bankës për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Bankës.

Banka monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Exposure to liq Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mbliidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Banka ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Bankës dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 arritën në 30,818 mijë euro (me 31 Dhjetor 2022: 32,153 mijë euro).

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Banka përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Për më tepër Banka mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabelat e mëposhtme tregojnë flukset monetare të pasurive dhe detyrimeve financiare të Bankës në bazë të maturimit më të hershëm kontraktual të mbetur. Flukset monetare të pritshme të Bankës për këto instrumente ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes.

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

31 Dhjetor 2023	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	54,299	-	-	-	-	-	54,299
Gjendja me BQK	74,360	-	-	-	-	-	74,360
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	10,605	-	10,605
Kreditë ndaj klientëve	9,015	11,390	24,186	40,378	224,685	131,644	441,298
Pasuri të tjera	934	-	-	-	-	-	934
Gjithsej	138,608	11,390	24,186	40,378	235,290	131,644	581,496
Liabilities							
Depozitat nga klientët	277,272	8,364	5,468	53,720	191,405	838	537,067
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	-	-	1,487
Detyrime të tjera	643	12	574	136	1,635	481	3,481
Gjithsej	279,402	8,376	6,042	53,856	193,040	1,319	542,035
Hendeku	(140,794)	3,014	18,144	(13,478)	42,250	130,325	39,461
Hendeku kumulativ	(140,794)	(137,780)	(119,636)	(133,114)	(90,864)	39,461	

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

31 Dhjetor 2022	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	32,388	-	-	-	-	-	32,388
Balances with CBK	95,201	-	-	-	-	-	95,201
Investimet në letra me vlerë	-	-	5,023	-	23,202	-	28,225
Kreditë ndaj klientëve	2,864	14,245	21,541	37,026	164,270	139,946	379,892
Pasuri të tjera	768	-	-	-	-	-	768
Gjithsej	131,221	14,245	26,564	37,026	187,472	139,946	536,474
Detyrimet							
Depozitat nga klientët	300,646	10,102	5,467	42,163	146,958	6	505,342
Detyrimet ndaj bankave	93	-	-	-	-	-	93
Detyrimet të tjera	341	6	756	85	1,545	457	3,190
Gjithsej	301,080	10,108	6,223	42,248	148,503	463	508,625
Hendeku	(169,859)	4,137	20,341	(5,222)	38,969	139,483	27,849
Hendeku kumulativ	(169,859)	(165,722)	(145,381)	(150,603)	(111,634)	27,849	-

25. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Banka e menaxhon kapitalin e vet për tu siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë.

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kososvës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Asetet e peshuara me rrezikun

Pasuritë peshohen sipas kategorive të gjera të rrezikut kombëtar, duke iu caktuar një peshë rreziku në përputhje me shumën e vlerësuar të kapitalit që konsiderohet të jetë e nevojshme për t'i mbështetur ato. Zbatohen gjashtë kategori të peshimit të rrezikut: (0%, 20%, 50%, 75%, 100%, dhe 150%): për shembull instrumentet e tregut të parasë peshohen me zero rrezik, i cili nënkupton që nuk nevojitet kapital për të mbështetur mbajtjen e këtyre pasurive. Pasuritë afatgjata materiale peshohen me rrezik 100% çka nënkupton që ato duhet të mbështetet nga Kapitali (Niveli 1) i barabartë me 9% të 2023 të vlerës kontabël.

Angazhimet jashtë bilancit të lidhura me kreditimin merren në konsideratë. Shumat më pas peshohen me rrezikun duke përdorur përqindje të njëjtë me atë të pasurive të bilancit.

	2023	2022
Pasuritë gjithsej të peshuara me rrezik	414,650	355,604
Pasuritë gjithsej të peshuara mepër rrezikun operacional	28,407	24,072
Gjithsej	443,057	379,676
Kapitali rregullator (Gjithsej Kapitali)	61,945	51,426
Raporti i adekuatshmërisë së kapitalit (Gjithsej Kapitali)	13.98%	13.54%

Rregullorja e BQK-së për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit bankar ka hyrë në fuqi më 01.01.2020 dhe për këtë arsye ka pasur një ndryshim të aktiveve financiare me AMR 100% ku disa prej këtyre pasurive janë llogaritur me 75% AMR.

Leva financiare

Komiteti i manaxhimit të rrezikut të Bankës rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2023	2022
Gjithsej Pasuritë	607,931	563,066
Gjithsej Ekuiteti	64,887	53,268
Raporti i levës	10.67%	9.46%

26. Ngjarjet pasuese

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose shpalesje në pasqyrat financiare.

BANKA EKONOMIKE SH.A.

Pasqyrat e Konsoliduara Financiare të përgatitura në përputhje
me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023
(së bashku me Raportin e Auditorit të Pavarur)

Përmbajtja	Faqe
Raporti i Auditorit të Pavarur	140-141
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar	142
Pasqyra e Konsoliduar e Fitimit ose Humbjes dhe e të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse	143
Pasqyra e Konsoliduar e Ndryshimeve në Ekuitet	144
Pasqyra e Konsoliduar e Rrjedhës së Parasë	145
Shënime për Pasqyrat e Konsoliduara Financiare	146-208

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e Banka Ekonomike Sh.A.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese të Banka Ekonomike Sh.A. dhe filialit të saj (Grupi), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023, dhe pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes ose të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që përfundon, dhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë politikat kontabël materiale.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat e konsoliduara financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar të Grupit më 31 dhjetor 2023, dhe performancën e tij financiare të konsoliduar dhe rrjedhen e parasë të konsoliduar për vitin e përfunduar në përputhje me bazën të përgatitjes siç shpjegohet në shënimin 2(a) të pasqyrave të konsoliduara financiare shoqëruese.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin '*Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare*' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi IESBA), dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave të konsoliduara financiare në Republikën e Kosovës, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Informatat tjera

Menaxhmenti është përgjegjës për informata tjera. Informatat tjera përbëjnë informatat e përfshira në raportin vjetor të Grupit, por nuk përfshijnë pasqyrat e konsoliduara financiare dhe raportin tonë të auditorit. Raporti vjetor i Grupit pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit të auditorit. Opinioni ynë për pasqyrat e konsoliduara financiare nuk mbulon informatat tjera dhe ne nuk shprehim asnjë konkluzion mbi të. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave të konsoliduara financiare, përgjegjësia jonë është ti lexojmë informatat tjera të identifikuar më lartë kur të bëhet i disponueshëm, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informatat tjera janë materialisht në kundërshtim me pasqyrat e konsoliduara financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose në të kundërt duket se është materialisht i keqdeklaruar. Kur lexojmë raportin vjetor, nëse konkludojmë se ka një keqdeklarim material në të, neve na kërkohet që t'ua komunikojmë çështjen atyre që janë të ngarkuar me qeverisjen dhe të raportojmë mospajtueshmërinë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen për Pasqyrat e Kons. Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave të konsoliduara financiare në përputhje me bazën e përgatitjes siç shpaloset në shënimin 2(a), dhe për një kontroll të tillë të brendshëm që menaxhmenti e përcakton se është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likuidojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave të Konsoliduara Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat e konsoliduara financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra të konsoliduara financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave të konsoliduara financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Grupit. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat e konsoliduara financiare ose nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Grupi të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave të konsoliduara financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.
- Marrim evidencë të mjaftueshme të përshtatshme auditimi në lidhje me informacionin financiar të njëjësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe kryerjen e auditimit të grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar për qeverisjen, përveçse çështjeve të tjera, edhe fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

RSM Kosovo Sh.p.k.
RSM Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Republika e Kosovës

18 Prill 2024


Sadik Berisha

Auditor Ligjor

	Shënimi	Më 31 dhjetor 2023	Më 31 dhjetor 2022
Pasuritë			
Paraja e gatshme dhe në banka	6	54,549	32,532
Gjendja me Bankën Qendrore të Kosovës	7	74,682	95,522
Depozitat me afat	8	5,363	7,164
Kreditë për klientët	9	441,298	379,846
Investime në letra me vlerë	10	15,689	30,183
Prona dhe pajisje dhe pasuritë me të drejtë përdorimi	11	17,042	17,377
Pasuritë e paprekshme	12	5,719	6,652
Pasuri të tjera	13	7,826	7,881
Gjithsej pasuritë		622,168	577,157
Detyrimet			
Depozitat nga klientët	14	532,619	501,314
Detyrime ndaj bankave	15	1,487	94
Detyrimet e provizioneve teknike	16	11,783	11,627
Provizioni për prime të pafituara	17	5,168	4,835
Detyrimi i tatimit në fitim		142	210
Detyrime të tjera	18	5,135	5,602
Detyrimi i shtyer tatimor		600	604
Gjithsej detyrimet		556,934	524,286
Ekuiteti dhe rezervat			
Kapitali aksionar	19	29,422	29,422
Rivlerësimi dhe rezervat tjera	19	4,746	4,853
Fitime të mbajtura		31,066	18,596
Gjithsej ekuiteti dhe rezervat		65,234	52,871
Gjithsej detyrimet, ekuiteti dhe rezervat		622,168	577,157

Shënimet shoqëruese nga 1 në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë aprovuar nga Bordi Drejtues dhe nënshkruar në emër të tyre më 16 Prill 2024 nga:



 Z. Shpend Luzha
 Kryeshef Ekzekutiv



 Z. Berat Isa
 Zyrtar Kryesor Financiar

	Shënimi	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022
Të ardhurat nga interesi të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	20	30,941	24,622
Shpenzimet e interesit të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv	20	(5,417)	(3,246)
Të ardhurat neto nga interesi		25,524	21,376
Të ardhurat nga tarifa dhe komisione	21	4,776	4,358
Shpenzimet nga tarifa dhe komisione	21	(1,201)	(914)
Të ardhurat neto nga tarifa dhe komisione		3,575	3,444
Primet e fituara neto, neto nga tatimi mbi primin	17	9,463	1,778
Të ardhura të tjera operative, neto	22	1,026	689
Të ardhurat		39,588	27,287
Shpenzimet e personelit	23	(6,781)	(4,950)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(3,276)	(2,480)
Shpenzime të tjera	24	(9,935)	(6,844)
Shpenzimet e provizioneve teknike	16	(6,268)	(1,672)
(Lirimi)/ngarkesa e lejimit të humbjeve neto në instrumentet financiare	6,7,8,9,10	1,380	(705)
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	12	(942)	-
Gjithsej shpenzimet operative		(25,822)	(16,651)
Fitimi para tatimit		13,766	10,636
Tatimi në fitim	25	(1,296)	(1,013)
Fitimi neto për vitin		12,470	9,623
Të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse			
<i>Zërat që nuk do të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje</i>			
Fitimet në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës, neto nga tatimi		-	-
Efekti i tatimit të shtyrë në rivlerësimin e pronës dhe ndërtesës		18	18
<i>Zërat që mund të riklasifikohen më pas në Fitim ose Humbje</i>			
Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të borxhit sipas vlerës së drejtë nepermjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		(125)	41
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi		(107)	59
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		12,363	9,682

Shënimet shoqëruese nga 1 në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

	Kapitali aksionar	Rezerva e rivlerësimit dhe të tjera	Fitimet e mbajtura	Gjithsej ekuiteti dhe rezervat
Me 01 Janar 2022	29,422	4,794	10,973	45,189
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenta e shpërndarë (Shënimi 16)	-	-	(2,000)	(2,000)
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	(2,000)	(2,000)
Fitimi për vitin	-	-	9,623	9,623
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	18	-	18
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	41	-	41
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	-	-	-
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	59	9,623	9,682
Më 31 Dhjetor 2022	29,422	4,853	18,596	52,871
Me 01 Janar 2023	29,422	4,853	18,596	52,871
Transaksionet me pronarët të regjistruara direkt në ekuitet				
Kontributet nga dhe shpërndarjet tek pronarët	-	-	-	-
Dividenta e shpërndarë (Shënimi 20)	-	-	-	-
Gjithsej transaksionet me pronarët të regjistruara në ekuitet	-	-	-	-
Fitimi për vitin	-	-	12,470	12,470
<i>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin</i>	-	18	-	18
Efekti i tatimit të shtyrë nga rivlerësimi	-	(125)	-	(125)
Rivlerësimi i letrave me vlerë (neto nga tatimi)	-	-	-	-
Transfer	-	-	-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(107)	12,470	12,363
Më 31 Dhjetor 2023	29,422	4,746	31,066	65,234

Shënimet shoqëruese nga 1 në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

	Shën im	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2023	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		13,766	10,636
Ndryshime për:			
Amortizimin dhe zhvlerësimin	10,11	3,276	2,480
(Lirimi)/ngarkesa e lejjimit të humbjeve neto në kreditë për klientët	9	(1,375)	668
Provizionet teknike	16	6,268	1,662
Humbje neto nga zhvlerësimi i pasurive të paprekshme	12	942	-
Ngarkesa e provizionit për garancitë dhe letrat me vlerë	18,10	(78)	146
Të ardhurat nga interesi	20	(30,941)	(24,622)
Shpenzimet e interesit	20	5,417	3,246
		(2,725)	(5,784)
<i>Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative</i>			
Rezerva statutorë me BQK-në dhe fondet tjera të kufizuara		1,951	(5,497)
Kreditë për klientët		(59,385)	(51,411)
Pasuri të tjera		35	(1,371)
Depozitat nga klientët		30,822	89,180
Detyrime ndaj bankave		1,394	(992)
Detyrimet e provizioneve teknike		(6,112)	(1,519)
Provizioni për prime të pafituara		334	276
Detyrime të tjera		(939)	(83)
		(34,625)	22,799
Interesi i paguar		(4,469)	(2,218)
Interesi i arkëtuar		30,388	24,815
Tatim mbi të ardhurat i paguar		(1,248)	(1,056)
Neto rrjedha e parasë e (përdorur në) / gjeneruar nga aktivitetet investuese		(9,954)	44,340
Aktivitetet investuese			
Blerjet e pronave dhe pajisjeve dhe pasurive të paprekshme	10,11	(1,521)	(2,562)
Blerjet e letrave me vlerë		(11,742)	(23,190)
Shitjet e letrave me vlerë		26,111	-
Zvogëlim i depozitave me afat		1,351	566
Blerja e filialit, neto nga paratë e blera	29	-	(1,362)
Neto rrjedha e parasë e gjeneruar nga / (përdorur në) aktivitetet investuese		14,199	(26,548)
Aktivitetet financiare			
Shlyerja e detyrimit të qirasë		(1,117)	(858)
Dividentët e paguar	20	-	(2,000)
Neto rrjedha e parasë e përdorur në aktivitetet financiare		(1,117)	(2,858)
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		3,128	14,934
Paraja dhe ekuivalentët e saj, fillim të vitit	6	93,245	78,311
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	6	96,373	93,245

Shënimet shoqëruese nga 1 në 30 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

1. Hyrje

Banka Ekonomike Sh.a ("Shoqëria Mëmë") është një shoqëri aksionare e krijuar në Republikën e Kosovës. Adresa e saj e regjistruar për Zyrat Qendrore është Sheshi Nëna Terezë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK"), Shoqëria Mëmë ka marrë licensën për aktivitetet bankare më 28 Maj 2001 dhe ka filluar operimin më 5 Qershor 2001. Shoqëria Mëmë operon si një bankë komerciale dhe e kursimeve për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës nëpërmjet rrjetit të 7 degëve kryesore në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjiilan dhe 22 nëndegë. Shoqëria Mëmë ka të punësuar 441 punonjës më 31 Dhjetor 2023 (2022: 425).

Në 9 Shtator 2022, Shoqëria Mëmë përfundoi procesin e blerjes së 100% të aksioneve në Kompaninë e Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiala") përmes një marrëveshje blerjeje, duke marrë kështu kontrollin e plotë të Filiales. Më 31 Dhjetor 2022, Shoqëria Mëmë zotëron 100% të aksioneve në Filialë.

Filiala është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë me numër biznesi 70167671 si shoqëri aksionare.

Filiala është e licencuar si kompani e sigurimeve jo të jetës. Veprimtaria kryesore e Filialës është sigurimi motorik për përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe klasa të tjera të sigurimit të tilla si:

- Sigurimi i pronave;
- Të gjitha Risqet gjatë Ndërtimit (CAR);
- Sigurimi shëndetësor gjatë udhëtimit;
- Aksidentet personale;
- Sigurimi Gjithëpërfshirës i Automjeteve Motorike, etj.

Selia e regjistruar e Filialës gjendet në rrugën Luan Haradinaj, Llamella A, 10000, Prishtinë, Kosovë. Më 31 Dhjetor 2023 Filiala ka gjithsej 168 të punësuar dhe menaxhment të lartë (2022: 162).

Shoqëria mëmë, së bashku me filialin e saj të konsoliduar vendas (bashkë, "Grupi"), janë institucione financiare të rregulluara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë përfshijnë llogaritë e Komapnisë.

2. Baza e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra të konsoliduara financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe Interpretimet (së bashku SNRF), me përjashtim të SNRF 17. SNRF 17 nuk zbatohet më 31 dhjetor 2023, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për vazhdimin e afatit për zbatimin e këtij standardi. Zbatimi i SNRF 17 do të jetë në fuqi për periudhën e raportimit vjetor që fillon më 1 janar 2026. Megjithatë, faza përgatitore dhe plani i veprimit nga Grupi duhet të përfshijë aktivitete dhe veprime konkrete duke filluar nga viti 2024, drejt përgatitjes për zbatimin e plotë të këtij standardi deri në fund të vitit 2025. Kështu, këto pasqyra financiare nuk mund të lexohen si të përgatitura në përputhje me SNRF-të. Bazat e matjes përshkruhen më plotësisht në politikat kontabël më poshtë.

(b) Paraqitja e pasqyrave financiare dhe shënimeve

Për qëllime qartësie, pasqyrat financiare të konsoliduara dhe shënimet në pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur duke përdorur konceptet e materialitetit dhe rëndësisë.

Kjo do të thotë që zërat e linjës që nuk konsiderohen materiale për sa i përket matjeve sasiore dhe cilësore ose të lidhura me përdoruesit e pasqyrave financiare të konsoliduara, grumbullohen dhe paraqiten së bashku me zërat e tjerë në pasqyrat financiare primare. Në mënyrë të ngjashme, informacioni që nuk konsiderohet material nuk është paraqitur në shënime

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(c) Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara të miratuara nga Grupi

Grupi, me përjashtim të SNRF 17, ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit. SNRF 17 nuk është zbatuar, bazuar në njoftimin e Bankës Qendrore të Kosovës të datës 29 dhjetor 2023 për zgjatjen e afatit për zbatimin e këtij standardi. Miratimi i këtyre standardeve dhe interpretimit, përveç IRFS 17, nuk pati ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit.

Standardet dhe ndryshimet e reja të mëposhtme janë bërë efektive më 1 Janar 2023:

- SNRF 17 “Kontratat e sigurimit” duke përfshirë ndryshimet në SNRF 17
- Klasifikimi i Detyrimeve si afatshkurta ose afatgjata (Ndryshimet në SNK 1)
- Dhënia e Informacioneve Shpjeguese të Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës 2 SNRF). Menaxhmenti rishikoi politikat kontabël dhe bëri përditësime të informacionit të shpalosur në shënimin 3 Politikat Materiale Kontabël (2022: Politika të rëndësishme kontabël) në raste të caktuara në përputhje me këtë ndryshim.
- Tatimi i shtyrë në lidhje me Pasuritë dhe Detyrimet që Rrjedhin nga një Transaksion i Vetëm (Ndryshimet në SNK 12)
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)

Grupi është aktualisht në fazat fillestare të vlerësimit të ndikimit të mundshëm të SNRF 17 Kontratat e Sigurimit në pasqyrat e tij financiare. Në këtë moment, bazuar në vlerësimin tonë fillestar, menagjemti nuk parashikon një ndikim material në pozicionin ose performancën financiare të Grupit. Megjithatë, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të procesit të zbatimit, nuk mund të konkludohet përfundimisht se nuk do të ketë ndikim material. Prandaj, ne e kuptojmë rëndësinë e zbulimit të kësaj pasigurie. Prandaj, ne e pranojmë se efekti i zbatimit nuk mund të përcaktohet me siguri absolute në këtë moment.

Gjatë muajit mars 2023, Byroja Kosovare e Sigurimeve ka organizuar trajnime lidhur me kërkesat e standardit SNRF 17. Gjithashtu, gjatë këtij trajnimi u prezantua një modul për plotësimin e kërkesave të SNRF 17 siç rrjedhin nga standardi. Në vazhdim të vitit 2023, Byroja Kosovare e Sigurimeve pritet të organizojë punëtori me kompanitë vendore lidhur me fillimin e analizës për zbatimin e modulit SNRF 17.

(d) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive

Standardet dhe interpretimet që janë nxjerrë, por të cilat nuk janë ende efektive, deri në datën e lëshimit të pasqyrave të konsoliduara financiare të Grupit janë shpalosur më poshtë. Grupi synon të miratojë këto standarde, nëse janë të zbatueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

- Ndryshimet në SNRF 16 “Qiratë” - Detyrimi i Qirasë në një Shitje dhe Kthim të qirsë - në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024
- Ndryshimet në SNK 1 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” - Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata dhe Ndryshimet në SNK 1 “Prezantimi i Pasqyrave Financiare” - Detyrimet afatgjata me Konventa - efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- Ndryshimet në SNK 7 “Pasqyra e Rrjedhës së Parasë” dhe SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese” - Marrëveshjet Financiare të Furnizuesit – të dyja efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- SNRF S1 Kërkesat e Përgjithshme për Shpalosjen e Qëndrueshmërisë - Informacioni Financiar i Ndërlidhur, në fuqi për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.
- SNRF S2 Climate -Dhënia e informacioneve shpjeguese të ndërlidhura, në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024.

2. Baza e përgatitjes (vazhdim)

(d) Standardet dhe interpretimet e reja të cilat nuk janë ende efektive (vazhdim)

- Ndryshimet në SNK 21 “Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit Valutor” - Mungesa e këmbyeshmërisë - efektive për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2025
- Ndryshimet në SNRF 10 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara” dhe SNK 28 “Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta” - Shitja ose Kontributi i Pasurive ndërmjet një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose Sipërmarrjes së Përbashkët dhe Ndryshime të Mëtejshme (data e hyrjes në fuqi është shtyrë për një kohë të pacaktuar derisa të përfundojë projekti kërkimor mbi metodën e kapitalit).

Grupi ka zgjedhur të mos miratojë para kohe këto deklarata dhe është në proces të analizimit të ndikimit të adoptimit të këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve në pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit në periudhën e aplikimit fillestar.

(d) Baza e kontabilitetit

Pasqyrat e konsoliduara financiare janë përgatitur ne baze te konventës së kostos historike, me përjashtim të pasurive financiare të listuara më poshtë, të cilat maten me vlerën e drejtë:

- Instrumentet e borxhit të mbajtura sipas modelit të biznesit të mbajtura për mbledhje dhe shitje dhe klasa të caktuara të pronave, impianteve dhe pajisjeve

(e) Parimi i vijmësisë

Pasqyrat e konsoliduara financiare përgatiten mbi bazën e vijmësisë, pasi Drejtorët janë të kënaqur që grupi ka burime për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Në bërjen e këtij vlerësimi, drejtorët kanë marrë në konsideratë një gamë të gjerë informacioni në lidhje me kushtet aktuale dhe të ardhshme, duke përfshirë parashikimet e ardhshme të përfitimit, flukset monetare, kërkesat për kapital dhe burimet kapitale. Këto konsiderata përfshijnë skenarë të theksuar. Ata gjithashtu morën parasysh rreziqe të tjera kryesore, si dhe nga ndikimet e lidhura me përfitimin, kapitalin dhe likuiditetin.

(f) Valuta funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra individuale financiare paraqiten në euro, që është monedha funksionale e Grupit. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijërat më të afërt, përveç ku shprehet ndryshe

(f) Përdorimi i gjykimeve dhe vlerësimi

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare, menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël të Grupit dhe shumat e raportuara të pasurive, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

Informacioni për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare individuale janë përshkruar në shënimet 4, 5 dhe 28.

3. Politikat materiale kontabël

Politikat kryesore të kontabilitetit të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra të konsoliduara financiare. Aty ku është e nevojshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar në përputhje me ndryshimet në paraqitje për vitin aktual.

Për më tepër, Grupi miratoi Dhënien e Informacioneve Shpjeguese të Politikave Kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës SNRF 2) që nga 1 janari 2023. Ndryshimet kërkojnë dhënien e informacioneve shpjeguese të politikave kontabël 'materiale' sesa 'të rëndësishme'. Megjithatë ndryshimet nuk rezultuan në ndonjë ndryshim në vetë politikat kontabël, ato ndikuan në informacionin e politikës kontabël në lidhje me instrumentet financiare të shpalosura në shënimin 3 në raste të caktuara (shih shënimin 2(c) për informacion të mëtejshëm).

3. Politikat materiale kontabël

(a) Kombinimet e biznesit

Blerja e bizneseve llogaritet duke përdorur metodën e blerjes.

Kur shoqëria mëmë ka kontroll mbi një të investuar, ajo klasifikohet si një filial. Shoqëria mëmë kontrollon një të investuar nëse të tre elementët e mëposhtëm janë të pranishëm: fuqia mbi të investuarin, ekspozimi ndaj kthimeve të ndryshueshme nga i investuari dhe aftësia e investitorit për të përdorur fuqinë e tij për të ndikuar në ato kthime të ndryshueshme.

Pasqyrat e konsoliduara financiare paraqesin rezultatet e shoqërisë mëmë dhe filialeve të saj ("Grupi") sikur të ishin një njësi ekonomike e vetme.

(i) Interesat jo kontrolluese

Grupi fillimisht njeh çdo interes jo kontrollues në të blerin, i cili është një interes aktual pronësor dhe u jep të drejtë zotëruesve të tij për një pjesë proporcionale të aktiveve neto të njësisë ekonomike në rast likuidimi ose me vlerën e drejtë në datën e blerjes ose, me instrumentet aktuale të pronësisë. pjesë proporcionale në shumatat e njohura të aktiveve neto të identifikueshme të të blerit.

(ii) Emri i mirë

Emri i mirë përfaqëson tejkalimin e kostos së një kombinimi biznesi mbi interesin e Grupit në vlerën e drejtë të pasurive, detyrimeve dhe detyrimeve të kushtëzuara të identifikueshme të blera. Kostoja përfshin vlerën e drejtë të pasurive të dhëna, detyrimet e marra përsipër dhe instrumentet e kapitalit të emetuar, plus shumën e çdo interesi jo kontrollues në të blerin plus, nëse kombinimi i biznesit arrihet në fazë, vlerën e drejtë të interesit ekzistues të kapitalit neto në fitues. Emri i mirë kapitalizohet si pasuri e paprekshme dhe nuk amortizohet. Në vend të kësaj, emri i mirë testohet çdo vit për zhvlerësim, ose më shpesh nëse ngjarjet ose ndryshimet në rrethana tregojnë se ai mund të zhvlerësohet.

(b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi për të gjitha instrumentet financiare, duke përjashtuar ato të klasifikuara si të mbajtura për tregtim, njihen në 'të ardhura nga interesi' dhe 'shpenzime nga interesi' në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Interesi mbi pasuritë financiare të zhvlerësuara nga kredia njihet duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar (d.m.th., vlerën kontabël bruto të aktivitetit minus provizionin për HPK).

Për pasuritë financiare të blera ose të origjinës të dëmtuara nga kredia ('POCI'), Banka llogaritet të ardhurat nga interesi duke llogaritur NEI të rregulluar nga kredia dhe duke aplikuar atë normë në koston e amortizuar të pasurisë. NEI e rregulluar nga kredia është norma e interesit që, në njohjen fillestare, skanton flukset e ardhshme monetare të vlerësuara (përfshirë humbjet e kredisë) në koston e amortizuar të pasurive POCI.

(c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një pasuri ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit (shënimi (3a)).

Të ardhurat e tjera nga tarifa dhe komisionet, përfshirë edhe tarifat e shërbimeve të llogarive, tarifat e transferimit të fondeve, shitjet nga komisioni dhe tarifa për vendosje me afat në banka njihen me kryerjen e shërbimeve të lidhura me to. Kur një angazhim për kreditim nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e kredisë, komisionet e kredisë përkatëse, njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së angazhimit.

Shpenzimet e tjera për tarifa dhe komisione lidhen kryesisht me komisione për transaksione dhe shërbime, të cilat regjistrohen si shpenzim në momentin e pranimit të shërbimit.

Mbajtësit e policave të kontratës së sigurimit ngarkohen për shërbimet e administrimit të policave dhe tarifat e tjera të kontratës. Këto tarifa njihen si të ardhura gjatë periudhës në të cilën janë kryer shërbimet përkatëse.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(d) Të ardhura nga primet

Primet e përgjithshme të shkruara të biznesit përfshijnë primet e kontratave të lidhura në vitin financiar, pavarësisht nëse ato lidhen tërësisht ose pjesërisht me një periudhë kontabël të mëvonshme. Primet e shkruara shpalosen bruto të komisionit të pagueshëm ndaj ndërmjetësve. Pjesa e fituar e primeve të marra njihet si e ardhur. Primet fitohen nga data e lidhjes së rrezikut, gjatë periudhës së dëmshpërblimit, bazuar në modelin e rreziqeve të nënshkruara. Provizioni për primet e pafituara përfshin pjesën e primeve bruto të shkruara që vlerësohet të fitohen në vitin financiar vijues, duke përdorur bazën ditore proporcionale 1/365, e rregulluar, nëse është e nevojshme, për të pasqyruar çdo ndryshim në incidencën e rrezikut gjatë periudha e mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet në fuqi nga Grupi kanë rrezik linear dhe aktualisht nuk janë bërë rregullime për variacionin e rreziqeve.

(e) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshin tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose humbjet për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në lidhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të pasurive dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të pasurive ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk ndikon as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në datën e raportimit .

Pasuritë dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme ligjërish për të kompensuar detyrimet dhe pasuritë tatimore afatshkurtera dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor.

Taksat shtesë që lindin nga shpërndarja e dividendëve nga Grupi njihen në të njëjtën kohë me njohjen e detyrimit për të paguar dividendin përkatës.

(iii) Ekspozimet tatimore

Në përcaktimin e shumës së tatimit aktual dhe të shtyrë, Grupi merr parasysh ndikimin e pozicioneve tatimore të pasigurta dhe nëse tatimi apo interesat shtesë mund të jenë të pagueshme. Ky vlerësim mbështetet në vlerësime dhe supozime dhe mund të përfshijë një sërë gjykimesh në lidhje me ngjarjet e ardhshme. Informacione të reja mund të bëhen të disponueshme dhe të bëjnë që Banka të ndryshojë vendimin e saj në lidhje me përshtatshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime në detyrimet tatimore do të ndikojnë shpenzimet tatimore në periudhën në të cilën është bërë një përcaktim i tillë.

(f) Përfitimet dhe kërkesat

Përfitimet dhe dëmet bruto përbëhen nga përfitimet dhe dëmet e paguara ndaj të siguruarit, si dhe ndryshimet në vlerësimin bruto të sigurimit dhe të detyrimeve të kontratave të investimit, përveç ndryshimeve bruto në provizionet e primit të pa fituar të cilat regjistrohen në të ardhurat e primeve. Për më tepër përfshin dëmet e brendshme dhe të jashtme të trajtimit të dëmet që lidhen drejtpërdrejt me përpunimin dhe shlyerjen e dëmet. Dëmet e sigurimeve regjistrohen në bazë të njoftimeve të pranuar.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(g) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valuta të huaja regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet e shprehura në valutë të huaj përkthehen me kursin e këmbimit në datën e bilancit, përveç aktiveve dhe detyrimeve jomonetare të matura me koston historike, të cilat përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën fillestare të transaksionit.

(h) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Grupi fillimisht njihet huatë, depozitat, letrat me vlerë të borxhit të emetuara, huamarrjet dhe detyrimet e varura në datën në të cilën ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit, që është data në të cilën Grupi bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Pasuritë financiare

Në njohjen fillestare, një aktiv financiar klasifikohet si i matur në: koston e amortizuar, VDATGJ ose VDNFH. Një pasuri financiare matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja këto kushte dhe është nuk është caktuar si në VDNFH:

- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Një instrument borxhi matet në VDATGJ vetëm nëse plotëson të dy kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDNFH :

- pasuria mbahet brenda një modeli biznesi, objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e flukseve monetare kontraktuale ashtu edhe nga shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurisë financiare japin datat e përcaktuara në flukset e mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën kryesore të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për tregtim, Grupi mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet e mëvonshme në vlerën e drejtë në ATGJ. Këto zgjedhje bëhen në bazë të investim pas investimi.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me kosto të amortizuar ose në VDATGJ.

Grupi nuk zotëron pasuri financiare që mbahen për tregtim ose menaxhohen dhe performanca e të cilave vlerësohet mbi bazën e vlerës së drejtë, maten me VDATGJ.

Vlerësimi nëse flukset monetare kontraktuale janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit

Grupi mban një portofol kredish afatgjata me normë fikse për të cilat Grupi ka mundësinë të propozojë të rishikojë normën e interesit në datat periodike të rivendosjes. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një opsion ose të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë kredinë në vlerën nominale pa penalitet. Grupi ka përcaktuar se flukset monetare kontraktuale të këtyre kredive janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që merr parasysh vlerën në kohë të parasë, rrezikun e kredisë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumën kryesore e papaguar.

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

3. Politikat materiale kontabël (vazhdim)

(h) Financial assets and financial liabilities (continued)

Detyrimet financiare

Grupi klasifikon detyrimet e saj financiare matur me koston e amortizuar.

(iii) Çregjistrimi

Pasuritë financiare

Grupi çregjistron një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjen e parave nga pasuria financiare, ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Grupi as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes transferohet në pasuri financiare që kualifikohen për mosnjohje që krijohen ose mbahen nga Grupi njihen si një pasuri ose detyrim i veçantë.

Detyrimet financiare

Grupi ç'regjistron një pasuri financiare kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose mbarojnë.

(iv) Ndryshimet e pasurive financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare ndryshohen, Grupi vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare të pasurisë të modifikuar janë në thelb të ndryshme. Nëse flukset e mjeteve monetare janë substancialisht të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale në flukset e mjeteve monetare nga pasuria financiare fillestare, konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuritë financiare origjinale çregjistrohen dhe një aktiv financiar i ri njihet me vlerën e drejtë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Grupit janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Grupi, për të vendosur kufijtë dhe kontrollat e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Grupi synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv, në të cilin të gjithë punonjësit kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

28. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues (vazhdim)

Kuadri i menaxhimit të rrezikut (vazhdim)

Komiteti i Auditimit të Grupit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikën dhe procedurat për menaxhimin e rrezikut të Grupit dhe për të vlerësuar përshtatshmërinë e kuadrit për menaxhimin e rrezikut në raport me rreziqet me të cilat përballë Grupi. Komiteti i Auditimit të Grupit në këto funksione ndihmohet nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm. Auditimi i Brendshëm kryen rishikime në mënyrë të rregullta dhe spontane të kontrollit dhe procedurave për menaxhim e rrezikut, rezultati i të cilave raportohet tek Komiteti i Auditimit.

Grupi operon në kushtet e një krize globale financiare dhe ekonomike në zhvillim e sipër. Zgjerimi i saj i mëtejshëm mund të rezultojë në ndikime negative në pozicionin financiar të Grupit. Menaxhmenti i Grupit monitoron çdo ditë pozicionin e aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve financiare ndërkombëtare. Bazuar në këtë, menaxhmenti analizon përfitueshmërinë, likuiditetin dhe koston e fondeve dhe merr masat e përshtatshme në lidhje me rrezikun e kredisë, të tregut (normës primare të interesit) dhe likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet negative të mundshme nga kriza financiare dhe ekonomike globale. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet sfidave të tregut, duke mbajtur një pozicion të mjaftueshëm likuid dhe të kapitalit.

(b) Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të Grupit nëse një klient ose kundërparti e një instrumenti financiar dështon në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, dhe lidhet kryesisht me kredi ndaj klientëve dhe bankave të tjera. Për qëllime të raportimit financiar Grupi merr në konsideratë dhe konsolidon të gjithë elementët e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor (rreziku i mospagës të huamarrësit individual, rreziku i vendit dhe rreziku i sektorit).

Menaxhimi i rrezikut kreditor

Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë përgjegjësinë për monitorimin e rrezikut kreditor. Një departament të veçantë i Rrezikut kreditor është përgjegjës për administrimin e rrezikut të kredisë të Grupit. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut kreditor për huamarrësit nga Komiteti i Rrezikut kryhet nëpërmjet analizave të rregullta të besueshmërisë së huamarrësit. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor gjithashtu menaxhohet pjesërisht duke përfutuar kolateral dhe garanci

28. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë

Tabelat më poshtë paraqesin informacione mbi cilësinë e kreditorëve të asetit financiar dhe lejimet për zhvlerësim/humbje krijuar nga Grupi kundrejt këtyre pasurive. Tabelat më poshtë paraqet raste të keqe të ekspozimit ndaj rrezikut kreditor për Grupin më 31 dhjetor 2023 dhe 2022, pa marrë në konsideratë ndonjë kolateral të mbajtur ose mbrojtje të tjera ndaj rrezikut kreditor. Për pasuritë financiare, ekspozimet e mëposhtme paraqesin vlerën e mbartur ashtu siç është raportuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

	2023		2022		2023		2022		Gjendja me bankat dhe BQK	Garancitë financiare
	Kredi për klientët me vlerë	Investime në letra me vlerë	Depozitat me afat	Gjendja me bankat dhe BQK	Garancitë financiare	2023	2022	2023		
<i>Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor</i>	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	115,784	115,843	-	-
<i>Vlera e bartur</i>	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	115,784	115,843	-	-
<i>Me kosto të amortizuara</i>	451,567	391,754	15,692	30,189	5,363	7,164	115,813	115,874	-	-
<i>Lejimet për humbje</i>	(10,269)	(11,908)	(3)	(6)	-	-	(29)	(31)	-	-
<i>Vlera kontabel neto</i>	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	115,784	115,843	-	-
<i>Jashtë bilancit: ekspozimi maksimal</i>										
<i>Angazhimet kreditorë: Rrezik i ulët - i drejtë</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	-	-	12,807	9,838
<i>Gjithsej Angazhime/garanci</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	-	-	12,807	9,838
<i>Provizionet e njohura si detyrim</i>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>Gjithsej Ekspozimi</i>	23,811	31,181	-	-	-	-	-	-	12,807	9,676

28. Menaxhimi i riskut financiar dhe sigurues (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e cilësisë së kredisë (vazhdim)

	2023				2022			
	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kreditë	Individë	Mikro	Korporata	Gjithsej Kreditë
Kreditë për klientët								
Gjithsejt shuma bruto	144,336	142,246	164,986	451,567	125,644	117,694	148,416	391,754
Lejimet për humbje	(3,009)	(4,110)	(3,151)	(10,269)	(3,294)	(4,933)	(3,681)	(11,908)
Vlera kontabël neto	141,327	138,136	161,835	441,298	122,350	112,761	144,735	379,846
<i>Kreditë me kushte të rinegociuara</i>								
Vlera kontabël	405	2,365	447	3,217	310	2,219	1,261	3,790
Lejimet për humbje	(94)	(393)	(69)	(556)	(52)	(451)	(610)	(1,113)
Vlera kontabël neto	311	1,972	378	2,661	258	1,768	651	2,677
<i>Kreditë në vonesë</i>								
Jo në vonesë	130,546	123,563	152,315	406,424	119,359	107,344	143,942	370,645
Në vonesë 1-30 ditë	10,902	13,355	9,520	33,777	3,894	4,983	1,095	9,972
Në vonesë 31 - 90 ditë	893	1,242	306	2,441	900	1,496	168	2,564
Në vonesë 91 – 365 ditë	852	1,644	-	2,496	603	2,478	-	3,081
Në vonesë mbi 365 ditë	1,142	2,442	2,845	6,429	888	1,393	3,211	5,492
	144,335	142,246	164,986	451,567	125,644	117,694	148,416	391,754

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Zhvlerësime dhe provizionime

Provizionet gjithsej që kërkohen nga SNRF-të për “Menaxhimin e Rrezikut Kreditor” (shih 3. (f)(viii)) përfshijnë humbje të ndodhura/pësuara në datën e raportimit (modeli i humbjes së shkaktuar) dhe humbjet e pritshme.

Grupi vlerëson probabilitetin e dështimit në pagim të kundërpalëve, duke përdorur mjete të brendshme rangimi/renditje të përshtatshme për kategori të ndryshme kundërpalesh. Mjete të tilla kombinonë analizën dhe gjykimin dhe janë të vlefshme, kur është e përshtatshme, duke u krahasuar me të dhëna të jashtme të disponueshme.

Kundërpalët janë segmentuar në pesë kategori dhe klasifikimi i Grupit, i cili është treguar më poshtë, reflekton intervalin e probabilitetit të dështimit, të përcaktuar për çdo kategori. Ekspozimet lëvizin midis kategorive kur vlerësimi i probabilitetit të dështimit ndryshon. Mjetet e rankimit rishikohen në mënyrë të vazhdueshme, përmirësohen dhe validohen nga Grupit.

Kreditë janë ranguar nga A në E në sistemin e brendshëm të rangimit të rrezikut kreditor të Grupit:

- A Standarde
- B Vrojtuese
- C Nënstandarde
- D Të dyshimta
- E Të humbura

Grupi raporton klasifikimin e humarrësve të saj, tek BQK dhe Regjistri i Kredisë së Kosovës.

Politika e provizionimit për këto kredi është detajuar në shënimin 3. (h) (viii).

Vlerësimet individuale dhe kolektive të portofolit të kredisë

Për qëllime të manaxhimit të brendshëm, Grupi veçon kreditë në kredi që vlerësohen individualisht për zhvlerësim: këto janë kredi të klasifikuara si nënstandarte ose më ulët. Të gjitha kreditë e tjera analizohen kolektivisht/në grup për qëllime të vlerësimit për zhvlerësim.

Grupi vlerëson HPK (humbjet e pritshme të kredisë) mbi baza individuale për ekspozimet e papaguara më të mëdha se 100 mijë euro që klasifikohen në fazën 3 në bazë mujore, ndërsa me NEI diskonton fluksin e parashikuar të parave. Për më tepër, ekspozime të tilla monitorohen nga afër nga Grupi dhe raportohen për shkak të madhësisë së tyre dhe ndikimit të mundshëm në fitimin ose humbjen e Grupit. (2022: 100 mijë euro të paktën një herë në muaj kur rrethanat individuale e kërkojnë atë).

Kreditë në vonesë por të pazhvlerësuara

Kreditë dhe letrat me vlerë, ku interesat kontraktuale ose pagesat e principalit janë të skaduara, por Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm në bazë të nivelit të sigurisë/kolateralit të disponueshëm dhe/apo në stadin e mbledhjes së shumave që i detyrohen Grupit.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kredi me kushte të rinegociuara/ndryshuara janë kredi të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe ku Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar ajo mbetet në këtë kategori, pavarësisht performancës së kënaqshme pas ristrukturimit.

Politika e fshirjes

Grupi fshin një kredi (dhe çdo zbritje për zhvlerësim të lidhur me të) me vendimin e Bordit Drejtues, në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës. Vendimi i fshirjes merret pas marrjes në konsideratë të informacioneve të tilla si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në situatën financiare të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajnë më detyrimin ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin Gjithsej. Shuma gjithsej e fshirë gjatë vitit 2023, është 940 mijë euro (2022: 1,222 mijë euro).

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Depozita nga bankat

Ekspozimet ndërbankare monitorohen nga afër çdo ditë nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut dhe Departamenti i Thesarit. Gupi kufizon depozitat e saj dhe transaksionet e tjera bankare me bankat lokale të shëndetshme apo me bankat ndërkombëtare. Para se një marrëdhënie biznesi të nisë me një bankë të caktuar, Departamenti i Rrezikut dhe i menaxhmenti kryejnë një analizë të gjendjes financiare të institucionit. Performanca financiare e palëve të tjera monitorohet vazhdimisht. Për më tepër, të gjitha bankat korrespondente, si dhe emetuesit e obligacioneve në të cilat Banka ka ekspozime të investimeve, monitorohen vazhdimisht për renditjen e tyre nga agjencitë ndërkombëtare të vlerësimit si: Standard & Poor's (S & P), Fitch dhe Moody's.

Në përputhje me rregulloren e re mbi ekspozimet e mëdha të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, bankat nuk duhet të kenë ekspozim Gjithsej të rrezikut të kredisë ndaj palëve të lidhura që tejkalon 15% të kapitalit rregullator të klasit të parë. Kreditë ndaj bankave janë dhënë pa kolateral. Tabela më poshtë paraqet llogaritë rrjedhëse të bankave dhe depozitat me afat me bankat korrespondente sipas rankimit kreditor:

Me 31 dhjetor	2023	2022
AAA+ to BBB-	19,097	9,917
A+ to A-	781	1,790
BB+ to B-	-	-
BBB+ to B-	16,676	5,577
Të pa ranguara	3,082	1,912
Bankat vendore	1,466	1,125
	41,102	20,321

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë janë vetëm me Qeverinë e Kosovës. Këto letra me vlerë nuk janë të rankuara. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë paraqitet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Angazhimet për kredi dhe garancitë financiare

Ekspozimi maksimal nga garancitë financiare përfaqëson shumën maksimale që Grupi duhet të paguajë nëse garancia kërkohet, e cila mund të jetë në mënyrë të konsiderueshme më e madhe se shuma e njohur si detyrim. Ekspozimi maksimal i kredisë për angazhimet e kreditimit është shuma e plotë e angazhimit.

Kontrolli i limitit të rrezikut dhe politikat e zbutjes

Grupi menaxhon kufijtë dhe kontrollon përqendrimet e rrezikut të kredisë, kudo që këto janë identifikuar, në mënyrë të veçantë me palë individuale, me grupet dhe me degët.

Grupi strukturon nivelet e rrezikut kreditor që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime në shumën e pranuar në lidhje me një huamarrës, ose grup huamarrës, dhe për segmentet gjeografike dhe industriale. Rreziqe të tilla monitorohen rregullisht dhe i nënshtrohen një rishikimi vjetor, ose më të shpeshtë, nëse është e nevojshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor manaxhohet përmes një analize të rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur shlyerjen e detyrimeve të interesit dhe të principalit dhe duke ndryshuar këto limite kreditimi, kur është e përshtatshme. Kontrollat e tjera dhe masat reduktuese janë përshkruar më poshtë.

Kolaterali i mbajtur dhe përmirësime kreditore të tjera dhe efekti i tyre financiar

Grupi mban kolateral kundrejt kredive ndaj klientëve në formën e interesave hipotekore mbi prona dhe pengje mbi aktive të luajtshme. Vlerësimi i vlerës së drejtë bazohet në vlerën e kolateralit të vlerësuar në momentin e huadhënies. Zakonisht nuk mbahet kolateral për kredi ndaj bankave. Një vlerësim i vlerës së drejtë të kolateralit dhe mbrojtjeve të tjera kundrejt kredive paraqitet më poshtë:

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(b) Rreziku kreditor (vazhdim)**

	2023		2022	
	Loans to customers	FV of collateral	Loans to customers	FV of collateral
Hipoteka	177,919	599,103	136,681	444,897
Kolateral në mjete monetare	16,207	16,207	13,240	13,240
Pengje	159,949	328,180	156,685	305,249
Miks (hipoteke dhe peng)	58,412	300,904	64,392	294,756
Pa kolateral	39,080	-	20,756	-
Gjithsej	451,567	1,244,394	391,754	1,058,142

Përqendrimi i rrezikut kreditor

Më 31 Dhjetor 2023, Grupi ka pasur ekspozim që tejkalon 10% të kapitalit të nivelit të parë. Ekspozimi më i lartë ishte në: 14.65%, gjithsej ishin pesë ekspozime ndaj kredive që tejkalonin 10% të kapitalit të nivelit të parë (2022: 14.13%, dy ekspozime të kredive). Ekspozimi ndaj palëve të lidhura më 31 Dhjetor 2023, përfaqëson 18.37% (2022: 21.49%) të kapitalit të nivelit të parë. Pjesa më e madhe e ekspozimit me palët e lidhura mbulohet me kolateral në mjete monetare që përfaqëson 2.86% (2022: 5.43%) të kapitali të nivelit të parë.

Grupi monitoron përqendrimin e rrezikut kreditor sipas sektorëve dhe vendndodhjeve gjeografike. Një analizë e përqendrimin të rrezikut të kredisë në datën e raportimit është paraqitur më poshtë:

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(b) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e kualitetit kreditor (vazhdim)

Përqendrimi i rrezikut kreditor (vazhdim)

	Kredi për klientët		Investime në letra me vlerë		Gjendja me bankat dhe BQK		Garancitë financiare		Kredi për klientët	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022	2023	2022
	Përqendrimi sipas sektorëve									
Korporative	161,835	144,735	-	-	-	-	-	-	9,925	1,845
Qeveria	-	-	15,689	30,183	5,363	7,164	-	-	-	-
Bankat	-	-	-	-	-	-	115,784	115,843	-	-
Individët	141,327	122,350	-	-	-	-	-	-	-	-
Mikro entitete	138,136	112,761	-	-	-	-	-	-	2,882	7,993
Gjithsej	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	115,784	115,843	12,807	9,838
Përqendrimi sipas vendndodhjes										
vendet e BE-së	-	-	-	-	-	-	39,648	19,544	-	-
Rep. e Kosovës	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	76,136	96,299	12,807	9,838
Gjithsej	441,298	379,846	15,689	30,183	5,363	7,164	115,784	115,843	12,807	9,838

Pasojat e luftës Ukrainë-Rusi

Pushtimi i Ukrainës nga Federata Ruse dhe reagimi i mëpasshëm global ndaj këtyre veprimeve ushtarake mund të kenë efekte të rëndësishme financiare në shumë entitete dhe tregje financiare. Këto përfshijnë subjekte me operacione fizike në Ukrainë, Rusi dhe Bjellorusi, si dhe interesa indirekte. Grupi nuk ka ndonjë ekspozim të rëndësishëm të drejtpërdrejtë ndaj Ukrainës, Rosisë apo Bjellorusisë. Megjithatë, Grupi po monitoron vazhdimisht zhvillimet në lidhje me efektet e luftës Ukrainë-Rusi. Pozicioni financiar i Grupit vazhdon të jetë i qëndrueshëm dhe në rritje të qëndrueshme. Kjo rritje vihet re në rritjen e kredive dhe depozitave, si dhe në të ardhurat nga interesi dhe të ardhurat nga tarifat dhe komisionet.

(c) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, siç janë normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e këmbimit valutor dhe shpërndarjet e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në situatën kreditore të emetuesit / huamarrësti), do të ndikojnë në të ardhurat e Grupit ose në vlerën e investimeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimi të rrezikut të tregut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin ndaj rrezikut.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku që vlera e një instrumenti financiar do të luhetet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikut që maturimet e pasurive me interes të ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes të përdorura për financimin e këtyre pasurive. Prandaj, kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është rregulluar në një instrument financiar tregon se në çfarë mase ai është i ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat me afat të klientëve të Grupit kanë norma fikse interesi.

Operacionet e Grupit janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohe të ndryshme ose shuma të ndryshme. Grupi përpiket të zvogëlojë këtë rrezik duke monitoruar datat e rivlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Përveç kësaj, efekti aktual do të varet nga një numër faktorësh të tjerë, duke përfshirë masën në të cilën pagesat janë bërë me herët ose më vonë se data e kontraktuar dhe variacionet në ndjeshmërinë e normës së interesit brenda periudhave të rivlerësimit dhe ndërmjet monedhave.

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i normave të interesit (vazhdim)

Ekspozimet e Grupit janë të bazuara normat e interesit të shënuara të Kosovës dhe Grupi ballafaqohet vetëm me rrezik të rivënjes së çmimit.

Në baza tremujore mbahen takime të Menaxhimit të rrezikut operacional, ku diskutohen çështjet e mëposhtme:

- Raporti mbi Rrezikun Operacional që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e Likuiditetit dhe të Tregut që përgatitet nga Departamenti i Rrezikut
- Raporti mbi Rrezikun e normës së interesit - Raporti përgatitet nga Departamenti i Rrezikut. Raporti detajon normat e interesit të Grupit në krahasim me normat e interesit të tregut dhe jep detaje të ndryshimeve në normat e interesit në treg, çdo luhatje të pazakontë etj.

Departamenti i Thesarit monitoron në mënyrë konstante rrezikun e normave të interesit nëpërmjet monitorimit të kushteve të tregut dhe marrjen e vendimeve të nevojshme për riçmimin ose rialokimin me miratimin e Komisionit të Pasurive dhe Detyrimeve. Raporti lidhur me këtë monitorim është përgatitur dhe paraqitur në mbledhjen e Komisionit për Pasuri dhe Detyrime. Janë marrë masat e nevojshme nëse normat e interesit ndryshojnë negativisht. Raporti përfshin analiza për depozituesit kryesorë, ndikimin e tyre në normat e depozitave, investimet në analizën e letrave me vlerë, normat mesatare të interesit në llogaritë e klientëve, analizën e GAP-it mbi rrezikun e likuiditetit

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit

Operacionet e Grupit janë subjekt i rrezikut të luhatjeve të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes dhe detyrimet që mbartin interes maturohen ose rivlerësohen në kohë të ndryshme ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, Grupi është i ekspozuar edhe ndaj rrezikut bazë, që është diferenca në karakteristikat e riçmimit të indekseve të ndryshme të normave luhatëse, të tilla si norma e kursimit, LIBOR and EURIBOR dhe lloje të ndryshme të interesit. Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut në përputhje me strategjitë e biznesit të Grupit.

Aktivitetet e menaxhimit të rrezikut të pasurive dhe detyrimeve janë kryer në kontekst të ndjeshmërisë së Grupit ndaj ndryshimeve në normat e interesit. Në mjediset e rënies së normave të interesit, marzhi i fitimit do të ngushtohet, derisa normat e interesit në detyrime do të ulen me një përqindje më të ulët në krahasim me normat e interesit të aktiveve. Megjithatë, efekti aktual do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë edhe stabilitetin e ekonomisë, mjedisit dhe nivelin e inflacionit.

Normat e kthimit mesatare efektive të kategorive të rëndësishme të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit me 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si në vijim:

Pasuritë	USD		EUR		CHF	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Paraja në dorë dhe në banka	2.87%	0.22%	1.00%	(0.35%)	-	(1.13%)
Balancat me BQK-në	-	-	0.30%	(0.41%)	-	-
Kreditë për klientët	-	-	6.88%	6.49%	-	-
Investime në letra me vlerë në VDATGJ	-	-	3.15%	2.80%	-	-
Investime në letra me vlerë me kosto të amortizuar	-	-	2.39%	2.18%	-	-
Detyrimet	-	-	-	-	-	-
Depozitat e klientëve	0.58%	-	1.21%	0.85%	-	-

Menaxhimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limiteve të hendekut të normave të interesit plotësohet duke monitoruar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të Grupit ndaj disa skenareve standarde dhe jo-standarde të normave të interesit. Skenarët standardë përfshijnë një rënie dhe rritje paralele 1 % në lakoren e kthimit.

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj një rritje apo zbritje në tregun e normave të interesit (duke supozuar se nuk ka lëvizje asimetrike në lakoren e pëqindjeve dhe një pozitë financiare të qëndrueshme) është si vijon:

Efekti i vlerësuar i fitimit (humbjes)	Skenari deri në 1 vit		Skenari mbi 1 vit	
	100 bp Rritje	100 bp Ulje	100 bp Rritje	100 bp Ulje
2023	(45)	(240)	(292)	(315)
2022	(97)	(163)	(144)	(426)

Tabela në vijim tregon instrumentet financiare që sjellin dhe që nuk sjellin interes sipas datës së maturimit. Rritja / rënia nuk është simetrike, sepse llogaritë e kursimit kanë normat 0.25% dhe në rast të rritjes për 100pb ato arrijnë 1.25%, ndërsa në rast rënie për 100bp, ato arrijnë deri në 0%. E njëjta gjë është me depozitimet; norma e tyre është 0% dhe në rast të rritjes me 100bp arrijnë në 1.00%, dhe në rast rënie ato arrijnë në 0%. Këto asete janë afatshkurtra, prandaj ato kanë prekur vetëm pjesën deri në një vit. Nuk ka asete afatgjata, kështu që ato nuk ndikojnë në pjesën mbi një vit.

31 Dhjetor 2023	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	25,207	-	-	-	-	-	29,342	54,549
Gjendja me BQK	74,682	-	-	-	-	-	-	74,682
Depozitat me afat	-	-	-	1,739	3,624	-	-	5,363
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	15,689	-	-	15,689
Kredi klientëve – Norma fikse	9,015	11,390	24,186	40,378	224,685	131,644	-	441,298
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	945	945
Gjithsej	108,904	11,390	24,186	42,117	243,998	131,644	30,287	592,526
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	43,296	8,364	5,468	53,720	191,405	838	229,528	532,619
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	-	-	-	1,487
Detyrimet e provizioneve teknike	-	-	-	-	-	-	11,783	11,783
Detyrimet tjera	-	-	-	119	1,548	841	2,306	4,814
Gjithsej	44,783	8,364	5,468	53,839	192,953	1,679	243,617	550,703
Hendeku	64,121	3,026	18,718	(11,722)	51,045	129,965	(213,330)	41,823
Hendeku kumulativ	64,121	67,147	85,865	74,143	125,188	255,153	41,823	

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit (vazhdim)

31 Dhjetor 2022	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Mbi 5 vite	Jo interes bartëse	Gjithsej
Pasuritë								
Paraja e gatshme dhe në banka	7,066	-	-	-	-	-	25,466	32,532
Gjendja me BQK	95,522	-	-	-	-	-	-	95,522
Depozitat me afat	-	25	1,445	1,143	4,551	-	-	7,164
Investimet në letra me vlerë	-	-	5,023	-	25,160	-	-	30,183
Kredi klientëve – Norma fikse	2,864	14,245	21,541	37,026	164,224	139,946	-	379,846
Asetet tjera	-	-	-	-	-	-	609	609
Gjithsej	105,452	14,270	28,009	38,169	193,935	139,946	26,075	545,856
Detyrimet								
Detyrimet ndaj klientëve – Norma fikse	48,038	10,102	5,467	42,163	143,179	6	252,359	501,314
Detyrimet ndaj bankave	94	-	-	-	-	-	-	94
Detyrimet e provizioneve teknike	-	-	-	-	-	-	11,627	11,627
Detyrimet tjera	-	-	-	2	1,469	790	2,982	5,243
Gjithsej	48,132	10,102	5,467	42,165	144,648	796	266,968	518,278
Hendeku	57,320	4,168	22,542	(3,996)	49,287	139,150	(240,893)	27,578
Hendeku kumulativ	57,320	61,488	84,030	80,034	129,321	268,471	27,578	-

Rreziku valutor

Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut valutor nëpërmjet transaksioneve në valutë të huaj. Grupi sigurohet se ekspozimi neto mbahet në nivele të pranueshme duke shitur dhe blerë valuta të huaja me kursin “spot” kur është e nevojshme që të rregullohen balancat afatshkurtra.

Rreziku valuator nuk është signifikant, meqë pjesa më e madhe e transaksioneve të Grupit janë në valutën vendase. Valutat e huaja me të cilat Grupi operon janë Dollari Amerikan (USD), Franga Zvicerane (CHF) dhe GBP. Normat e përdorura për këmbim më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 janë si në vijim:

Valuta	2023	2022
	EUR	EUR
1 USD	1.1050	1.0666
1 CHF	0.9260	0.9847
1 GBP	0.8691	0.8869

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(c) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi i Grupit ndaj rrezikut të valutës së huaj, i shprehur në ekuivalentë në euro është si në vijim:

31 Dhjetor 2023	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	42,877	5,594	5,201	877	54,549
Gjendja me BQK	74,682	-	-	-	74,682
Depozitat me afat	5,363	-	-	-	5,363
Investimet në letra me vlerë	15,689	-	-	-	15,689
Kreditë për klientët	441,298	-	-	-	441,298
Pasuritë tjera	945	-	-	-	945
	580,854	5,594	5,201	877	592,526
Detyrimet					
Depozita nga klientët	521,410	5,138	5,196	875	532,619
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	1,487
Detyrimet e provizioneve teknike	11,783	-	-	-	11,783
Provizionit për primet e pafituara	5,168	-	-	-	5,168
Detyrime të tjera	4,814	-	-	-	4,814
	544,662	5,138	5,196	875	555,871
Pozicioni neto valutor	36,192	456	5	2	36,655

31 Dhjetor 2022	EUR	USD	CHF	GBP	Gjithsej
Pasuritë					
Paraja e gatshme dhe në banka	22,056	4,251	4,680	1,545	32,532
Gjendja me BQK	95,522	-	-	-	95,522
Depozitat me afat	7,164	-	-	-	7,164
Investimet në letra me vlerë	30,183	-	-	-	30,183
Kreditë për klientët	379,486	-	-	-	379,486
Pasuritë tjera	609	-	-	-	609
	535,020	4,251	4,680	1,545	545,496
Detyrimet					
Depozita nga klientët	493,858	2,037	4,665	754	501,314
Detyrimet ndaj bankave	304	-	-	-	304
Detyrimet e provizioneve teknike	11,627	-	-	-	11,627
Provizionit për primet e pafituara	4,835	-	-	-	4,835
Detyrime të tjera	5,243	-	-	-	5,243
	515,867	2,037	4,665	754	523,323
Pozicioni neto valutor	19,153	2,214	15	791	22,173

Një analizë e ndjeshmërisë së Grupit ndaj rritjes ose uljes së normave të valutës së huaj është si më poshtë:

	USD		CHF		GBP	
	2023	2022	2023	2022	2023	2022
Normat e ndjeshmërisë	5%	5%	5%	5%	5%	5%
Fitimi ose humbja						
+5% e Euro	22.80	110.70	0.25	0.75	0.10	39.55
- 5% e Euro	(22.80)	(110.70)	(0.25)	(0.75)	(0.10)	(39.55)

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është se Grupi do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve nga detyrimet financiare të saj.

Qasja e Grupit për administrimin e likuiditetit është që të sigurojë, sa më shumë që është e mundshme, që gjithmonë të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, në kushte normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të papranueshme apo pa rrezikuar të dëmtojë reputacionin e Grupit.

Grupi monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj kur janë të pagueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Fondet mbliidhen duke përdorur një segment instrumentesh që përfshijnë depozita të klientëve, borxhe të varura dhe kapital aksionar.

Grupi ka një rezervë likuiditeti në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës që është llogaritur në bazë të nevojave të likuiditetit të Grupit dhe që është në dispozicion në rastet e problemeve të likuiditetit. Shuma e rezervës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2023 arritën në 31,139 mijë euro (me 31 Dhjetor 2022: 32,474 mijë euro).

Fleksibiliteti kufizon varësinë ndaj secilit prej burimeve të financimit dhe zakonisht ul koston e financimit. Grupi përpiqet të ruaj një ekuilibër midis financimit të vazhdueshëm dhe fleksibiliteti nëpërmjet përdorimit të detyrimeve me maturitete të ndryshme. Grupi vazhdimisht vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshime në financime të nevojshme, të kërkuara për të arritur qëllimet e biznesit në terma të strategjisë së përgjithshme të Grupit. Për më tepër Grupi mban një portfol të pasurive likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Maturiteti kontraktual i mbetur i pasurive dhe detyrimeve financiare

Tabelat e mëposhtme tregojnë flukset monetare të pasurive dhe detyrimeve financiare të Grupit në bazë të maturimit më të hershëm kontraktual të mbetur. Flukset monetare të pritshme të Grupit për këto instrumente ndryshojnë ndjeshëm nga kjo analizë. Për shembull, depozitat në të parë pritet të kenë një gjendje të qëndrueshme ose një rritje të gjendjes.

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)****Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit (vazhdim)**

31 Dhjetor 2023	Deri 1 muaj	1-3 Muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Gjithsej
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	54,549	-	-	-	-	-	54,549
Gjendja me BQK	74,682	-	-	-	-	-	74,682
Depozitat me afat	-	-	-	1,739	3,624	-	5,363
Investimet në letra me vlerë	-	-	-	-	15,689	-	15,689
Kreditë për klientët	9,015	11,390	24,186	40,378	224,685	131,644	441,298
Pasuri të tjera	945	-	-	-	-	-	945
Gjithsej	139,191	11,390	24,186	42,117	243,998	131,644	592,526
Liabilities							
Depozitat nga klientët	272,824	8,364	5,468	53,720	191,405	838	532,619
Detyrimet ndaj bankave	1,487	-	-	-	-	-	1,487
Detyrimet e provizioneve teknike	11,783	-	-	-	-	-	11,783
Detyrime të tjera	643	457	574	136	2,523	481	4,814
Gjithsej	286,737	8,821	6,042	53,856	193,928	1,319	550,703
Hendeku	(147,546)	2,569	18,144	(11,739)	50,070	130,325	41,823
Hendeku kumulativ	(147,546)	(144,977)	(126,833)	(138,572)	(88,502)	41,823	

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)
(d) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

	Deri 1 muaj	1-3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj	1-5 vjet	Mbi 5 vjet	Total
Pasuritë							
Paraja e gatshme dhe në banka	32,532	-	-	-	-	-	32,532
Gjendja me BQK	95,522	-	-	-	-	-	95,522
Depozitat me afat	-	25	1,445	1,143	4,551	-	7,164
Investimet në letra me vlerë	-	-	5,023	-	25,160	-	30,183
Kreditë për klientët	2,864	14,245	21,541	37,026	164,224	139,946	379,846
Pasuri të tjera	609	-	-	-	-	-	609
Gjithsej	131,527	14,270	28,009	38,169	193,935	139,946	545,856
Liabilitet							
Depozitat nga klientët	300,646	10,102	5,467	42,163	142,930	6	501,314
Depozimet ndaj bankave	94	-	-	-	-	-	94
Depozimet e provizioneve teknike	11,627	-	-	-	-	-	11,627
Detymime të tjera	2,542	6	756	85	1,397	457	5,243
Gjithsej	314,909	10,108	6,223	42,248	144,327	463	517,716
Hendeku	(183,382)	4,162	21,786	(4,079)	49,608	139,483	27,578
Hendeku kumulativ	(183,382)	(179,220)	(157,434)	(161,513)	(111,905)	27,578	-

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(e) Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Grupi e menaxhon kapitalin e vet per tu siguruar se do të jetë në gjendje të vazhdojë sipas parimit të vijueshmërisë ndërsa maksimizon kthimin tek aksionarët përmes optimizimit të raportit të borxhit dhe kapitalit.

Struktura e kapitalit të Grupit përfshin kapitalin aksionar, rezervat dhe fitimin e pashpërndarë

Kapitali rregullator

Grupi monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit duke përdorur masa të tjera, rregullat dhe normat e vendosura nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK). Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është raporti i kapitalit rregullator ndaj aktiveve të peshuara me rrezik, zërave jashtë bilancit dhe rreziqeve të tjerë, i shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar i Raportit të Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 9% për Kapitalin e Klasit të Parë dhe 12% për Gjithsejin e fondeve të veta.

Leva financiare

Komiteti i menaxhimit të rrezikut të Grupit rishikon strukturën e kapitalit në baza të vazhdueshme. Si pjesë e këtij rishikimi, komiteti merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur me çdo klasë të kapitalit. Bazuar në rregulloren e BQK raporti minimal i levës është 3%.

Norma e levës financiare në fund të vitit ishte si në vijim:

	2023	2022
Gjithsej Pasuritë	622,168	577,157
Gjithsej Ekuiteti	65,234	52,871
Raporti i levës	10.48%	9.16%

28. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(f) Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Risku tjetër me të cilin përballet Grupi në bazë të kontratave të sigurimit është se kërkesat aktuale dhe pagesat e përfitimeve ose koha e tyre ndryshojnë nga pritjet. Kjo ndikohet nga shpeshësia e kërkesave, ashpërsia e kërkesave, përfitimet aktuale të paguara dhe zhvillimi i mëvonshëm i kërkesave afatgjata. Prandaj, qëllimi i Grupit është që të sigurojë që rezerva të mjaftueshme janë në dispozicion për të mbuluar këto detyrime.

Ekspozimi ndaj riskut zbutet nga diversifikimi në një portofol të madh të kontratave të sigurimit dhe zonave gjeografike. Ndryshueshmëria e risqeve është përmirësuar gjithashtu me përzgjedhjen e kujdesshme dhe zbatimin e udhëzimeve të strategjisë së sigurimit, si dhe me përdorimin e marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Grupi blen ri-sigurime si pjesë e programit të lehtësimit të risqeve të saj. Ri-sigurimi i dhënë është vendosur në bazë proporcionale dhe jo-proporcionale. Pjesa më e madhe e ri-sigurimit proporcional është tejkalimi i ri-sigurimit të humbjes që merret për të kufizuar ekspozimin e përgjithshëm të Grupit në disa kategori të biznesit. Ri-sigurimi jo-proporcional është kryesisht ri-sigurimi i humbjes së tepërt i projektuar për të zbutur ekspozimin neto të kompanisë ndaj humbjeve nga katastrofa. Kufijtë e mbajtjes për ri-sigurimin e humbjes së tepërt ndryshojnë sipas linjës dhe territorit të produktit.

Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit vlerësohen në një mënyrë që përputhet me kërkesat e provizioneve të paguara dhe janë në përputhje me kontratat e ri-sigurimit.

Megjithëse Grupi ka marrëveshje për ri-sigurim, nuk lirohet nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj të siguruarve të saj dhe kështu ekziston një ekspozim kredie në lidhje me sigurimet e dhëna, deri në masën që ndonjë ri-sigurues nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e marra sipas marrëveshjeve të ri-sigurimit.

Grupi kryesisht lëshon këto lloje të kontratave të sigurimit: sigurimi i përgjegjësive motorike ndaj palës së tretë, sigurimi shëndetësor, sigurimi i pronës, sigurimi profesional të dëmshpërblimit dhe kontratave të tjera të sigurimit. Për sigurimin e përgjegjësive motorike ndaj palës së tretë, risku më i rëndësishëm është dëmi material dhe jo material që shkaktohet nga aksidentet. Për sigurimin e pronës dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor risqet më të rëndësishme janë: katastrofa natyrore, zjarri, aktivitetet terroriste, epidemitë, shkencat mjekësore dhe përmirësimet në teknologji.

Qëllimi i këtyre strategjive të sigurimit dhe ri-sigurimit është të kufizojë ekspozimin ndaj katastrofave bazuar në oreksin e riskut të kompanisë siç vendoset nga menaxhmenti. Mbajtjet maksimale të sigurimit janë 10% e kapitalit rregullator minimal.

Tabela e mëposhtme përcakton përqendrimin e detyrimeve të kontratës së sigurimit jo të jetës sipas llojit të kontratës:

31 Dhjetor 2023	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësive Motorike			
ndaj Palëve të Treta	7,820	355	7,465
BKS	765	-	765
Fondi i Kompenzimit	910	-	910
Sigurimi i Pronës	752	503	249
Sigurimi shëndetësor	526	-	526
Produkte të tjera	1,010	105	905
Gjithsej	11,783	963	10,820
31 Dhjetor 2022	Detyrimet Bruto	Risigurimi i detyrimeve	Detyrimet Neto
Sigurimet e Përgjegjësive			
Motorike ndaj Palëve të Treta	7,348	457	6,891
BKS	636	-	636
Fondi i Kompenzimit	851	-	851
Sigurimi i Pronës	1,275	920	354
Sigurimi shëndetësor	569	-	569
Produkte të tjera	947	80	868
Gjithsej	11,627	1,457	10,170

29. Kombinimet e biznesit

Kombinimi i biznesit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 ishte blerja e Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a. ("Filiali"). Më 9 shtator 2022 (data e blerjes), shoqëria mëmë fitoi 100% të të drejtave të votës të Kompanisë së Sigurimeve Siguria Sh.a, një kompani e përfshirë në sigurimet e jo-jetës. Si rezultat, Kompania e Sigurimeve Siguria Sh.a. u bë një filial i shoqërisë mëmë pasi shoqëria mëmë mori kontrollin e Kompanisë së Sigurimit Siguria Sh.a. Detajet e vlerës së drejtë të pasurive të identifikueshme të blera dhe detyrimeve, shumata e blerjes dhe emri i mirë janë si më poshtë:

	Vlera kontabël Euro	Rregullimet Euro	Vlera e drejtë Euro
Pasuritë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	738,259	-	738,259
Investimet në depozita me afat	7,368,878	-	7,368,878
Investimet në Obligacione Qeveritare	1,953,564	-	1,953,564
Kërkesat ndaj debitorëve	1,212,361	-	1,212,361
Kërkesat e ceduara nga risigurimi	1,907,010	-	1,907,010
Kostoja e shtyrë e blerjes	411,943	-	411,943
Prona, Impiante & Pajisje	3,252,508	112,845	3,365,353
Prona investuese	894,517	-	894,517
Pasuritë e paprekshme	24,201	-	24,201
Pasuritë tatimore	-	14,201	14,201
Pasuritë tjera	317,860	(46,003)	271,857
Gjithsej Vlera e Drejtë e Pasurive	18,081,101	81,043	18,162,144
Detyrimet			
Primi i pafiturar	4,559,113	-	4,559,113
IBNR dhe RBNS	10,974,692	590,000	11,564,692
Detyrimet e Risigurimit	931,203	-	931,203
Detyrimet ndaj KIB	142,238	-	142,238
Detyrimet e qirasë – IFRS 16	50,995	-	50,995
Detyrimet e qirasë	148,931	-	148,931
Detyrimet tatimore	106,396	-	106,396
Paga dhe Kontributet Pensionale	54,711	-	54,711
Detyrimet ndaj aksionarëve	97,509	-	97,509
Detyrimet ndaj furnitorit	240,872	-	240,872
Detyrimet e tatimit në fitim	35,000	(35,000)	-
Detyrimet Kontigjente	-	-	-
Gjithsej Vlera e Drejtë e Detyrimeve	17,341,660	555,000	17,896,660
Vlera e Drejtë e Pasurive Neto të Fituara	739,441	(473,957)	265,484
Emri i mirë			
Konsiderata e transferuar			2,100
IJK			-
			2,100
Vlera e drejtë e pasurive të blera			18,162
Vlera e drejtë e detyrimeve të supozuara			(17,897)
Vlera e drejtë e pasurive neto të fituara			265
Emri i mirë në datën e blerjes			1,835

29. Kombinimet e biznesit (vazhdim)

Emri i mirë konsiston kryesisht në përfitime ekonomike të ardhshme dhe sinergji me operacionet ekzistuese dhe nuk është i zbritshëm për qëllime tatimore. Grupit i kërkohet të testojë, në baza vjetore, nëse emri i mirë ka pësuar ndonjë zhvlerësim. Shuma e rikuperueshme përcaktohet në bazë të llogaritjeve të vlerës në përdorim. Përdorimi i kësaj metode kërkon vlerësimin e rrjedhjeve monetare të ardhshme dhe përcaktimin e një norme skontimi për të llogaritur vlerën aktuale të rrjedhjeve monetare. Që nga data e raportimit, Emri i mirë nuk është zhvlerësuar.

Shumat e rikuperueshme të kompanisë së blerë janë përcaktuar nga llogaritjet e vlerës në përdorim bazuar në parashikimet e flukseve monetare nga buxhetet që mbulojnë një periudhë deri më 31 dhjetor 2027. Supozime të tjera kryesore janë si më poshtë:

Norma e skontimit: 15.65%

Norma e rritjes: 2.00%

Norma e rritjes dhe supozimi zbatohen vetëm për periudhën përtej periudhës së buxhetuar formale me llogaritjen e vlerës në përdorim.

30. Ngjarjet pas datës së raportimit

Përveç rasteve të shpalosura në pasqyrat financiare të konsoliduara, nuk ka ndonjë ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

KOMPANIA E SIGURIMEVE SIGURIA


Bilanci i gjendjes dhe pasqyra e të ardhurave


Pasqyrat financiare të audituara nga Grant Thornton të kompanisë sigurimeve Siguria. Për raport të detajuar të raportit vjetor ju lutem referohuni në webfaqen e www.ks-siguria.com.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR MË 31 DHJETOR 2023

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
PASURITË		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	469	393
Depozitat	9,914	11,264
Investimet ne letrat me vlere	5,084	1,959
Të arkëtueshmet nga sigurimet	1,538	1,304
Kostot e shtyra të përvetësimit	532	469
Prona, pajisjet dhe e drejta e përdorimit të pasurisë	3,462	3,421
Prona investuese	895	895
Pjesa e risiguruesit në detyrimet e provizioneve teknike	963	1,457
Pasuritë tjera	1,351	1,227
GJITHSEJ PASURITË	24,208	22,389
EKUITETI DHE DETYRIMET		
EKUITETI		
Kapitali aksionar	19,503	18,203
Rezerva e rivlerësimit	534	534
Humbjet e akumuluar	-13,604	-14,349
GJITHSEJ EKUITETI	6,433	4,388
DETYRIMET		
Detyrimet e provizioneve teknike	11,221	11,065
Provizioni për prime të pafituara	5,168	4,835
Detyrim ndaj tatimit në të ardhura	54	-
Detyrimet e Qirasë	445	211
Detyrimet nga sigurimi dhe detyrime të tjera	887	1,890
GJITHSEJ DETYRIMET	17,775	18,001
GJITHSEJ EKUITETI DHE DETYRIMET	24,208	22,389

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 04 Prill 2024 dhe janë nënshkruar në emër të:


Z. Fitim Rexhepaj
Drejtore Gjeneral


Z. Adhurim Kastrati
Drejtore Financiar

PASQYRA E FITIMIT DHE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2023

	2023	2022
	EUR '000	EUR '000
Primet e shkruara bruto	11,018	9,246
Minus: Primet e bartura tek risiguruesit	-813	-2,649
PRIMET E SHKRUARA NETO	10,206	6,597
Ndryshimi bruto në provizionin e primeve të pafituara	-337	-700
Ndryshimi në pjesën e risiguruesëve të rezervës së primit të pafituar	93	140
PRIMET E FITUARA NETO	9,961	6,037
Të ardhurat financiare neto	229	145
Të ardhura tjera	420	732
GJITHSEJ TË ARDHURAT	10,610	6,915
Shpenzimet e provizioneve teknike	-6,268	-6,959
Ndryshimi në kostot e shtyra të përvetësimit	63	129
Kontributi në BKS për shpenzimet administrative	-292	-174
Shpenzime tjera operative dhe administrative	-3,255	-2,909
GJITHSEJ SHPENZIMET	-9,751	-9,913
FITIMI/(HUMBJA) PARA TATIMIT	858	-2,998
Tatimi në të ardhura	-114	-66
FITIMI/(HUMBJA) PËR VITIN	744	-3,064
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse	-	202
GJITHSEJ FITIMI/(HUMBJA) GJITHËPËRFSHIRËSE PËR VITIN	744	-2,862